



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 63 regjistër (JR)
Datë 22.12.2020

Nr. 15 i vendimit
Datë 13.04.2023

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Natasha Mulaj	Anëtare
Ina Rama	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 13.04.2023, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Steven Kessler, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejdini, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 63/2020 (JR), datë 22.12.2020, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Neritan Cena, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 304, datë 06.10.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit Neritan Cena.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pikat 2, 3, 5 dhe 10 të Kushtetutës; nenet A, Ç, D, Dh, E dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; nenet 62, 63 e vijues dhe 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit Neritan Cena të paraqitura në ankim dhe në parashtrimet e dorëzuara në Kolegji, i cili kërkoi përfundimisht ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 304, datë 06.10.2020 dhe konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Neritan Cena ka ushtruar detyrën e gjyqtarit që prej vitit 2004 dhe, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, ai iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente, brenda afatit ligjor¹, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë², deklaratën për kontrollin e figurës³ dhe formularin për vetëvlerësimin profesional⁴.
3. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
 - (i) *Deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin.*
 - (ii) *Ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimet e pasurive.*
 - (iii) *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.*
 - (iv) *Nuk ka kryer deklaram të rremë.*
 - (v) *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK-ja) kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim

¹Afati ligjor prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë, kontrollit të figurës dhe formularit të vetëvlerësimit profesional, ka përfunduar më datë 31.01.2017.

²Dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 25.01.2017, sipas vërtetimit të ILDKPKI-së nr. {***} prot., datë 25.01.2017. Të njëjtën datë mban dhe deklarata e pasurisë në rubrikën përkatëse.

³Referuar “Deklaratës për kontrollin e figurës”, data e dorëzimit është 26.01.2017.

⁴Referuar raportit nr. {***} prot., datë 11.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor për “Analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Neritan Cena” për periudhën 08.10.2013 deri më 08.10.2016”, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar pranë KLGj-së formularin e vetëdeklarimit më datë 27.01.2017.

që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe dërgoi një raport të arsyetuar pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, me konstatimin për përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës.

5. Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.
6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLGj-ja, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Neritan Cena, bazuar në tri kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale).

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Komisioni, me vendimin nr. 304, datë 06.10.2020, vendosi: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Neritan Cena, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë [...]”.
8. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 61, pikat 3, 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme.
 - Në lidhje me kriterin e kontrollit të pasurisë: *Subjekti gjendet në kushtet e germave “a”, “b” dhe “ç” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin, ka mungesë dokumentacioni justifikues për të justifikuar pasuritë dhe ka kryer fshehje të pasurisë. Në përfundim, Komisioni çmon se konkluzionet në lidhje me vlerësimin e pasurisë, të marra së bashku, përbëjnë shkak për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, në kuptim të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*
 - Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: *Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka demonstruar mangësi të theksuara në mënyrë të përsëritur në një numër të konsiderueshëm çështjesh në aftësitë e tij organizative, duke u gjendur në parashikimet e nenit 74 të ligjit nr. 96/2016 [...]. Këto konkluzione, duke qenë se lidhen me kriteret e vlerësimit të magjistratëve sipas dispozitave të ligjit nr. 96/2016, kritere mbi të cilat bazohet Komisioni për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, sipas parashikimit të pikës 1 të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, të vlerësuara në harmoni me njëra-tjetrën, e çojnë Komisionin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, për shkak të këtyre mangësive në indikatorët e kriterit të aftësisë profesionale, sipas parashikimeve të pikës 4 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “c” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, gjatë ushtrimit të profesionit ka*

sjellë shkelje të të drejtave të palëve në proceset gjyqësore të trajtuara prej tij, në nivel të tillë që shihen të pamundura të riparohen nëpërmjet programit trajnues në Shkollën e Magjistraturës. Për të gjitha sa arsyetohet më lart, subjekti konsiderohet se është i papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës së gjyqtarit dhe se ndaj tij duhet të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, sipas parashikimit të pikës 4 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

▪ *Në vlerësimin tërësor, në kuptim të nenit 4, paragrafi 2 i ligjit nr. 84/2016, të kriterit të kontrollit të pasurisë e kontrollit të aftësive profesionale, Komisioni arrin në përfundimin se problematikat e konstatuara në vlerësimin e pasurisë në lidhje me transaksione financiare shumë të diskutueshme dhe paaftësia profesionale për të kryer detyrat tij brenda një standardi të pritshëm, krijojnë dyshimin e arsyeshëm te çdo qytetar se gjyqtari, me sjelljet e tij, ka vendosur interesin personal mbi atë të shoqërisë/publikut dhe sundimit të paanshëm të ligjit, duke cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, dhe duke bërë që subjekti të ndodhet në kushtet e pamundësisë për të plotësuar këto mangësi nëpërmjet programit të trajnimit, i gjendur në kushtet e parashikimeve të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

III. Shkaqet e ankimit

9. Subjekti i rivlerësimit iu drejtua Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”) me ankim kundër vendimit të Komisionit nr. 304, datë 06.10.2020, me pretendimin se vendimi është në kundërshtim me përcaktimet e nenit D, nenit E dhe nenit Ë të Aneksit të Kushtetutës, dispozitat e ligjit nr. 84/2016, veçanërisht në kundërshtim me përcaktimet e neneve 32, 33, 40, 41, 42, 43, 44, 59 dhe 61 të këtij ligji, si dhe në kundërshtim me praktikën e konsoliduar të Kolegjit⁵. Subjekti i rivlerësimit pretendoi gjithashtu se vendimi i Komisionit vjen në kundërshtim me përcaktimet e nenit 6 të KEDNj-së në drejtim të mosrespektimit të parimit të procesit të rregullt ligjor, si dhe se nga ana e Komisionit janë cenuar rëndë parimet e përgjithshme, si: parimi i arsyetimit të vendimit, parimi i aksesit, parimi i kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, parimi i pavarësisë dhe paanësisë, parimi i barazisë para ligjit, parimi i ligjshmërisë dhe parimi i përgjithshëm se ligji nuk ka fuqi prapavepruese.
10. Subjekti i rivlerësimit, së bashku me ankimin, ka depozituar edhe disa akte në cilësinë e provave të reja. Bazuar në nenin 66 të ligjit nr. 84/2016 dhe dispozitave të ligjit nr. 49/2012, subjekti i rivlerësimit Neritan Cena kërkoi që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe të vendosë:
 - *Marrjen në shqyrtim të provave të paraqitura nga ana ime si subjekt, prova këto të cilat ndodhen bashkëlidhur ankimit referuar për këtë qëllim shkaqeve të cilat unë kam paraqitur në ankim dhe konkretisht marrjen me cilësinë e provës të këtyre akteve:*
 - *vendimin nr. {***}, datë 17.06.2011, të Gjykatës së Brescia-s, Itali, gjithsej 14 fletë;*
 - *artikullin e botuar në portalin In-Front.org më datë 01.12.2020, gjithsej 4 fletë;*
 - *procesverbalin e mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë të datës 11.06.2016, gjithsej 17 fletë.*

⁵ *Subjekti referon shprehimisht në vendimet e Kolegjit (JR) nr. 15, datë 17.07.2019; (JR) nr. 20, datë 31.07.2019; (JR) nr. 7, datë 24.06.2020; nr. 8, datë 25.06.2020; (JR) nr. 8, datë 25.06.2020; (JR) nr. 20, datë 08.09.2020 etj.*

- *Prishjen e vendimit nr. 304, datë 06.10.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe përsëritjen e hetimit administrativ nga ana juaj si Kolegj i Posaçëm i Apelimit ose në alternativë ndryshimin e vendimit nr. 304, datë 06.10.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe përfundimisht duke vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Neritan Cena, si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.*
- *Në referim të përcaktimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në prani të palëve.*

11. Shkaqet e ankimit lidhur me aspektet procedurale të procesit të zhvilluar në Komision, si dhe ato të zbatimit të ligjit material, parashtrohen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

11.1. *Subjekti pretendoi se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në kuadër të parashikimeve të nenit 6 të KEDNj-së, duke qenë se, sipas tij, vendimi është dhënë nga një trup gjykues i zgjedhur në kundërshtim me përcaktimet ligjore të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe me praktikën gjyqësore të GjEDNj-së⁶.*

11.2. *Subjekti i rivlerësimit pretendoi se nga ana e Komisionit janë shkelur rëndë përcaktimet ligjore lidhur me hedhjen e shortit. Sipas tij, në këtë mënyrë është shkelur në mënyrë flagrante parimi i barazisë së subjekteve para ligjit.*

11.3. *Subjekti i rivlerësimit pretendoi se i është cenuar e drejta për proces të rregullt sipas parashikimeve të nenit 6 të KEDNj-së, si pasojë e cenimit të parimit të aksesit në gjykatë dhe cenimit të parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, duke qenë se nuk i është vënë në dispozicion apo nuk i është komunikuar ndonjë analizë e re financiare pas paraqitjes prej tij të provave të reja në kuadër të kalimit të barrës së provës, as para apo gjatë seancës dëgjimore, as me vendimin përfundimtar.*

11.4. *Subjekti pretendoi se Komisioni ka cenuar standardin e arsytimit të vendimit, duke qenë se, sipas tij, nuk ka arsyetuar shkaqet për të cilat ka arritur në përfundimet se “transaksionet financiare janë të diskutueshme” dhe se “gjyqtari me sjelljen e tij ka vendosur interesin personal mbi atë të shoqërisë/publikut dhe sundimit të paanshëm të ligjit, duke cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe duke bërë që subjekti të ndodhet në kushtet e pamundësisë për të plotësuar këto mangësi nëpërmjet programit të trajnimit”. Subjekti pretendoi se, për rrjedhojë, është cenuar edhe parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit, duke qenë se Komisioni nuk ka treguar faktet mbi të cilat i bazon këto konkluzione, duke shkelur edhe nenin 51 të ligjit nr. 84/2016.*

12. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

12.1. *Subjekti i rivlerësimit pretendoi se konkluzioni i ILDKPKI-së për deklaram të pasaktë në përputhje me ligjin dhe mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimet e pasurisë, është i gabuar.*

⁶ *Subjekti referon vendimin e GjEDNj-së në çështjen Guðmundur Andri Ástráðsson v. Iceland.*

*i. Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “apartament banimi” me sipërfaqe 101,42 m², blerë në vitin 2016 në vlerën e 5.400.000 lekëve, me vendndodhje në {***}, Tiranë:*

12.2. Konkluzioni i Komisionit lidhur me vlerësimin e kësaj pasurie, sipas subjektit të rivlerësimit, është abuziv, subjektiv, tregues i qartë i njëanshmërisë, si dhe dëshmi e nivelit të ulët profesional të anëtarëve të Komisionit në lidhje me logjikën e përdorur në arsyetimin e vendimit lidhur me këtë pasuri, pasi bie ndesh me dispozitat e ligjit nr. 84/2016, me praktikën e konsoliduar gjyqësore të Kolegjit, si dhe me përcaktimet kushtetuese që garantojnë të drejtën e lëvizjes së lirë të personave, si dhe të drejtën e tyre për të disponuar lirisht dhe sipas vullnetit të tyre të ardhurat.

ii. Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “banesë”, blerë në vitin 2016, në Bremen, Gjermani, me vlerë 48.500 euro:

12.3. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar në fakte dhe rrjedhojë e vlerësimeve subjektive, konkluzionet e Komisionit në drejtim të vlerësimit të burimeve të deklaruara për financimin e blerjes së kësaj pasurie, si të pajustificuara me të ardhura të ligjshme, më konkretisht:

- (i) lidhur me burimin e deklaruar prej 20.000 eurosh, si të ardhura të përfituara nga shitja e automjetit me targa {***}, në pronësi të subjektit të rivlerësimit;
- (ii) lidhur me burimin e deklaruar prej 16.150 eurosh, si dhuratë nga motra e subjektit, znj. E. C. (G.);
- (iii) lidhur me burimin e deklaruar prej 9.000 eurosh, si të ardhura të përfituara nga huaja e marrë kumatës, znj. E. Sh..

*iii. Lidhur me pasurinë e luajtshme të llojit “automjet” të tipit “Citroen Elyse”, me targa {***}, të blerë në vitin 2013:*

12.4. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit lidhur me pamundësinë e kumatës së tij, znj. M. Sh., dhe bashkëshortit të saj për të justifikuar me burime të ligjshme dhënien e huasë znj. S. C., në vlerën e 5.000 eurove, të deklaruar si një ndër burimet për blerjen e automjetit të tipit “Citroen Elyse”.

iv. Lidhur me kursimet në gjendje “cash” jashtë sistemit bankar, të deklaruara në deklaratat periodike vjetore:

12.5. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar dhe abuzive mospërfshirjen e kursimeve në formën e likuiditetit gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, të deklaruara ndër vite, si burim për blerjen e automjetit me targa {***} dhe automjetit me targa {***}, si dhe një pjesë e tyre të përdorur ndër vite.

v. Lidhur me të ardhurat e deklaruara si të realizuara nga dhënia me qira e pasurive të paluajtshme në Bremen, Gjermani:

12.6. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar në fakte dhe në ligj konkluzionin e Komisionit për mospërfshirjen në analizën financiare të kryer për vitin 2016, të të ardhurave të deklaruara si të realizuara nga dhënia me qira e apartamentit në Bremen, Gjermani, në periudhën

08.10.2016 - 31.12.2016, në vlerën e 222.064 lekëve, si dhe të shumës së garancisë prej 1.330 eurosh të lënë nga qiramarrësi.

*vi. Lidhur me pasurinë e luajtshme të llojit automjet të tipit “Mercedes Benz”, vit prodhimi 1990, me targa {***}, të deklaruar në DIPPV-në e vitit 2004 si të dhuruar:*

12.7. Subjekti kundërshtoi si të pabazuar dhe në kundërshtim me përcaktimet kushtetuese dhe ato ligjore, konkluzionin e Komisionit për deklarim të pasaktë, lidhur me krijimin e kësaj pasurie, me pretendimin se referuar legjislacionit të zbatueshëm për procesin e rivlerësimit kalimtar, ai nuk ka pasur detyrim të deklarojë automjetin me targa {***}, në kushtet kur ky automjet në momentin e plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, nuk ishte në pronësinë e tij, duke qenë se i ishte vjedhur më datë 17.02.2016.

*vii. Lidhur me shumën prej 150.000 lekësh të përfituar nga shitja në vitin 2011 e automjetit me targa {***}, të deklaruar si burim për pagesën e një pjese të çmimit të blerjes së automjetit me targa {***} ({***}) po në vitin 2011:*

12.8. Subjekti kundërshtoi si të pabazuar mospërfshirjen e kësaj vlere monetare si të ardhur të ligjshme në analizën financiare të vitit 2011, me pretendimin se kjo diferencë nga çmimi i blerjes në atë të shitjes nuk është fitim pasi subjekti ka investuar në këtë automjet vlerën e 350.000 lekëve në vitet 2006 dhe 2007, duke e rritur vlerën e automjetit në 600.000 lekë, i cili në vitin 2011 është shitur në vlerën e 400.000 lekëve.

viii. Lidhur me shpenzimet e mobilimit për apartamentet e blera në Bremen, Gjermani:

12.9. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit lidhur me çështjen e mobilimit të apartamenteve të blera në Bremen dhe vlerës përkatëse, me pretendimin se nuk ka kryer ndonjë përpjekje për të fshehur ndonjë shpenzim lidhur me mobilimin e apartamenteve të ndodhura në Bremen dhe se ky përfundim nuk rezultoi të jetë arritur si rezultat i vlerësimit të fakteve në përputhje me provat e paraqitura prej tij gjatë hetimit administrativ.

ix. Lidhur me shpenzimet e jetesës:

12.10. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të padrejtë dhe të pabazuar përllogaritjet e Komisionit lidhur me përcaktimin e shpenzimeve të jetesës për njësinë ekonomiko-familjare të subjektit të rivlerësimit.

13. Shkaqet e ankimit në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale parashtrohen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

13.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi konkluzionin e Komisionit lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale si konkluzion abuziv, që nuk përputhet me vetë konstatimet e Komisionit, me parashikimet kushtetuese dhe ato ligjore, dhe si konkluzion që është arritur në cenim të parimit të paanësisë, objektivitetit dhe proporcionalitetit.

14. Në datën 17.03.2023, pas njoftimit të marrë për caktimin e datës së gjyqimit të çështjes në dhomë këshillimi, subjekti i rivlerësimit dorëzoi pranë Kolegjit një material shkresor, të titulluar "Parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe depozitim provash shtesë", dhe bashkëlidhur tij ka dorëzuar edhe disa akte shkresore, të cilat i referon: 1. vërtetim me nr. {***} prot., datë 13.12.2022, të lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit Social dhe Kujdesit Shoqëror të Bashkisë Kukës; 2. vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të lëshuar nga Bashkia Kukës për motrën time E. C. për periudhën shtator 2009 - dhjetor 2012; 3. akt ekspertimi financiar i realizuar nga Studio "{***}"; 4. deklaratë mbi standardet minimale për përfitimin e të ardhurave minimale, bazuar në nevojat për vitet 2010-2016, të lëshuar nga Landi Burgenland, Austri, shoqëruar me vulë apostille, e përkthyer dhe e noterizuar; 5. deklaratë e lëshuar nga avokat G. M., me profesion avokat në Brescia, Itali, që prej vitit 1991; 6. akt ekspertimi shtesë, i realizuar nga eksperti kontabël italian Dr. G. P., "Përditësim dhe integrim i mendimit të datës 15.09.2020", shoqëruar me të gjithë kuadrin ligjor në shtetin italian, lidhur me deklarinimin e të ardhurave nga subjektet që kanë vendbanim apo vendqëndrim të përhershëm në Republikën e Italisë, përkthyer dhe noterizuar; 7. konfirmë bankare, lëshuar nga Raiffeisen Bank ShA që mban datën 11.05.2018, bashkëlidhur së cilës ndodhet urdhërpagesa për tatimin mbi të ardhurat individuale, e noterizuar; për të cilat ka kërkuar administrimin e tyre si prova të reja në proces.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjyqimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

15. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit Neritan Cena, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimitimi i ankuesit

16. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh⁷ nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

⁷ Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 304, datë 06.10.2020, për rivlerësimin e subjektit Neritan Cena, i është njoftuar këtij të fundit me shkresën nr. {***} prot., datë 24.11.2020, konfirmuar marrja dijani nga subjekti i rivlerësimit më datë 25.11.2020, sipas lajmërimarrjes së shërbimit postar.

c) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

17. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012, i ndryshuar”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 304, datë 06.10.2020, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.
18. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit të rivlerësimit për çelje të hetimit gjyqësor dhe marrjen e provave të reja, konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.
19. Sa u takon akteve shkresore që subjekti i ka bashkëlidhur ankimit të tij, analiza për pranueshmërinë e tyre u krye në kuadër të parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, vlerësuar në harmoni me nenin 51, pika 1, shkronja “a” e të njëjtit ligj, sipas të cilave subjekti i rivlerësimit nuk mund të paraqesë në ankim fakte të reja apo të kërkojë prova të reja, përveçse kur provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose të kërkojë marrjen e këtyre provave gjatë shqyrtimit në Komision. Gjithashtu, në vendimmarrjen e trupit gjykues mbi kërkesat e subjektit të rivlerësimit për marrjen e provave të reja, u mbajtën në konsideratë edhe parashikimet e nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016. Në kuadër të analizës së mësipërme, trupi gjykues çmoi se aktet e dorëzuara së bashku me ankimin, si dhe ato të depozituara në Kolegji, bashkëlidhur parashkrimeve me shkrim të subjektit të rivlerësimit, nuk përmbushën kriteret e pranueshmërisë si prova të reja në proces, referuar dispozitave të sipërcituara ligjore dhe, për rrjedhojë, nuk u administruan në cilësinë e provës nga trupi gjykues.
20. Në përfundim, trupi gjykues pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike me praninë e subjektit të rivlerësimit, kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, si dhe vlerësoi dokumentacionin e fashikullit të administruar gjatë hetimit në Komision, bazuar edhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, nuk konstatoi shkelje procedurale, të tilla që të kërkojnë korigjimin e tyre sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve. Në referencë të dispozitës së sipërcituar, trupi gjykues çmoi gjithashtu se debati gjyqësor në seancë gjyqësore me praninë e subjektit të rivlerësimit nuk është i nevojshëm dhe se lidhur me këtë çështje mund të arrihej në vendimmarrje nga shqyrtimi mbi bazën e dokumenteve të administruara në fashikullin e Komisionit. Trupi gjykues arriti në këtë konkluzion edhe për faktin se si më sipër evidentuar, aktet e dorëzuara në cilësinë e provave të reja, nuk

*Kurse ankimi i subjektit rezulton të jetë depozituar në Komision në datën 09.12.2020, konfirmuar sipas të dhënave të vulës së protokollit të Komisionit, nr. {***}, datë 09.12.2020, që rezulton të jetë dita e 14 nga data e marrjes dijeni për vendimin e Komisionit, sipas njoftimit të këtij të fundit.*

përmbushën kriteret e pranueshmërisë si prova të reja në proces. Për rrjedhojë, në përfundim edhe të analizës së mësipërme, trupi gjykues vendosi të vijojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me aspekte procedurale të procesit të rivlerësimit të kryer nga Komisioni

21. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në kuadër të parashikimeve të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNJ”), duke qenë se, sipas tij, vendimi është dhënë nga një trup gjykues i zgjedhur në kundërshtim me përcaktimet ligjore të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe me praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së⁸. Në mbështetje të këtij shkak, subjekti i rivlerësimit parashitri se, referuar të dhënave të publikuara në media, i ka rezultuar që kryesuesi i trupit gjykues që ka kryer rivlerësimin e tij, z. R. I., të jetë zgjedhur si komisioner në kundërshtim me parashikimet e nenit 6 të ligjit nr. 84/2016, duke qenë se në momentin e zgjedhjes, ndaj tij kishte nisur një hetim penal. Subjekti i rivlerësimit pretendoi të ketë ardhur në dijeni të këtij fakti më datë 01.12.2020, sipas lajmit të publikuar nga portali *In-Front.org*, të cilin e ka paraqitur në cilësinë e provës, së bashku me ankimin.
22. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, trupi gjykues konstatoi se cenimi i parimeve të procesit të rregullt adresohet nga subjekti i rivlerësimit në drejtim të pretendimit se njëri prej anëtarëve të trupit gjykues nuk plotësonte kriteret ligjore të parashikuara nga neni 6 i ligjit nr. 84/2016, për të qenë komisioner i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Trupi gjykues, në përputhje dhe me jurisprudencën e Kolegjit lidhur me kërkesa të ngjashme në çështje të mëparshme⁹, çmoi se, për sa kohë pretendimi i ngritur lidhur me mospërmbushjen e kriterëve ligjore për zgjedhshmërinë në detyrë të komisionerit, nuk bën pjesë në kompetencën juridiksionale të Kolegjit dhe në kushtet kur nuk u pretenduan nga subjekti dhe as u konstatuan kryesisht nga Kolegji, fakte apo rrethana të tjera në drejtim të mosformimit të rregullt të trupit gjykues, që do ta bënin vendimmarrjen e Komisionit të cënueshme në drejtim të pavarësisë apo paanësisë së saj, vlerësuar kjo në kuadër të rregullave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi dhe jurisprudenca e GjEDNJ-së, ky shkak ankimi gjendet i pabazuar. Në vijim të sa më sipër, edhe lajmi i publikuar në portalin *In-Front.org*, për të cilin subjekti i rivlerësimit kërkoi të merret në cilësinë e provës së re në proces, edhe nëse do të plotësonte kriteret formale të pranueshmërisë së përcaktuar në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, vlerësohet nga trupi gjykues si provë e panevojshme dhe, për rrjedhojë, kjo kërkesë e subjektit të rivlerësimit u refuzua nga Kolegji, bazuar në parashikimin e nenit 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.
23. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se nga ana e Komisionit janë shkelur rëndë përcaktimet ligjore lidhur me hedhjen e shortit. Sipas tij, në këtë mënyrë është shkelur në mënyrë flagrante parimi i

⁸ Subjekti referoi vendimin e GjEDNJ-së në çështjen *Guðmundur Andri Ástráðsson v. Iceland*.

⁹ *Shih vendimin e Kolegjit nr. 3(JR), datë 06.02.2023.*

barazisë së subjekteve para ligjit. Këtë shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit e mbështeti në pretendimin se ai i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar jo për shkak të funksionit të tij si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, por për shkak të cilësisë si anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Sipas subjektit, kjo mënyrë të vepruari nga ana e Komisionit, bie ndesh me përcaktimet e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit përcaktohet se procesi bazohet në kushtin e të qenit gjyqtar dhe jo në pasjen e ndonjë cilësie të mëparshme. Subjekti pretendoi se kjo procedurë është kryer pa një vendimmarrje të arsyetuar dhe në kundërshtim me radhën e përcaktuar në ligjin nr. 84/2016, pasi ai nuk ka pasur as cilësinë e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, anëtarit të Gjykatës së Lartë, gjyqtarit të Gjykatës së Apelit apo cilësinë e kryetarit të ndonjë gjykate, sikundër as të ketë aplikuar për anëtar të Gjykatës Kushtetuese, anëtar të Gjykatës së Lartë, anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor, apo për pozicionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Subjekti pretendoi se përfshirja e tij në procedurën e shortit në kundërshtim me përcaktimet ligjore si më sipër, është bërë në shenjë hakmarrjeje ndaj veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në drejtim të mbrojtjes së gjyqtarëve ndaj sulmeve të pushtetit ekzekutiv, me qëllim kontrollimin apo kapjen prej këtij të fundit të pushtetit gjyqësor. Në kuadër të sa më sipër, subjekti ka dorëzuar në cilësinë e provës së re edhe procesverbalin e mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të datës 11.06.2016. Për rrjedhojë, subjekti ka kërkuar nga Kolegji që në përputhje me parashikimet e nenit 17 të ligjit nr. 84/2016, të nisë procedimin disiplinor ndaj anëtarëve të Komisionit, të cilët kanë pranuar të shqyrtojnë çështjen e tij, në shkelje të dispozitave përkatëse ligjore që rregullojnë radhën e shqyrtimit të çështjeve.

24. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi si vijon.

24.1. Në vendimin nr. {***}, datë 26.11.2018, të trupit gjykues nr. 3 të Komisionit, në pjesën hyrëse, shkruhet: *Referuar mbledhjes së KPK-së për hedhjen e shortit për pjesën tjetër të subjekteve të listës së përparësive për shkak të ligjit, zhvilluar më datë 15.11.2018, u shortua trupa gjyqësore nr. 03, e përbërë nga [...].* Një nga çështjet e shortuara, referuar kësaj vendimmarrjeje, rezultoi të ketë qenë edhe çështja që i përket subjektit të rivlerësimit Neritan Cena.

24.2. Në datën 19.02.2019, në një komunikim drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor, Komisioni është shprehur¹⁰: *Në mbështetje të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka nisur procedurat e rivlerësimit të subjektit Neritan Cena, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ky subjekt është kandidat për anëtar të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe, bazuar në rregulloren “Për procedurat e shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, është shortuar nga Komisioni. Për këtë arsye, lutemi na dërgoni brenda një kohe sa më të shpejtë raportin e vlerësimit profesional të këtij subjekti.*

24.3. Në pjesën hyrëse të relacionit mbi “Rezultatet e hetimit kryesisht”, të përcjellë subjektit nëpërmjet e-mail-it të datës 09.09.2020, dokument ky sipas të cilit i ka kaluar barra e provës subjektit të rivlerësimit, Komisioni rezultoi të jetë shprehur: *Z. Neritan Cena, sipas ligjit 84/2016*

¹⁰ Shih shkresën e Komisionit nr. {***} prot., datë 19.02.2019.

“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në funksionin e tij si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë [...].

24.4. Në vendimin objekt ankimi nr. 304, datë 06.10.2020, në paraqitjen e rrethanave të çështjes, Komisioni shprehet: *Z. Neritan Cena, është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në momentin e shortimit, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin [...].*

25. Në analizë të fakteve të konstatuara më sipër, trupi gjykues vëren se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se ai i është nënshtuar procedurës së shortit për shkak të cilësisë si anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe jo për shkak të funksionit të tij si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk u arrit të provohet, pasi nga verifikimi i ushtruar procedurave të ndjekura nga Komisioni, referuar akteve të administruara në fashikullin e çështjes, nuk u gjet asnjë e dhënë e cila të mund të përbënte qoftë edhe indicie në drejtim të këtij fakti të pretenduar nga ana e subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues konstatoi se përfshirja e subjektit të rivlerësimit në shortin e datës 15.11.2018, në listën e përparësive sipas ligjit, është bërë për shkak të cilësisë së tij si kandidat për anëtar të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, çka, vlerësuar në kuadër të parashikimeve të nenit 284, pika 9 e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në të cilën përcaktohet se anëtarët e Këshillit të Përkohshëm të Emërimeve në Drejtësi i nënshtrohen rivlerësimit me përparësi, arrihet në konkluzionin se Komisioni ka vepruar në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi. Në përfundim, trupi gjykues e gjen të pabazuar në fakte dhe në ligj këtë shkak të ankimit të subjektit të rivlerësimit dhe, rrjedhimisht, vlerësoi të panevojshme marrjen në cilësinë e provës së re në proces të procesverbalit të mbledhjes së KLD-së, të datës 11.06.2016, bazuar në parashikimin e nenit 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.
26. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se i është cenuar e drejta për proces të rregullt sipas parashikimeve të nenit 6 të KEDNj-së, si pasojë e cenimit të parimit të aksesit në gjykatë dhe cenimit të parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, duke qenë se nuk i është vënë në dispozicion apo nuk i është komunikuar ndonjë analizë e re financiare pas paraqitjes prej tij të provave të reja në kuadër të kalimit të barrës së provës, as para apo gjatë seancës dëgjimore, as me vendimin përfundimtar. Edhe në këtë rast, subjekti kërkoi nga Kolegji fillimin e procedimit disiplinor për anëtarët e trupit gjykues, duke qenë se mosshoqërimi i vendimit përfundimtar me analizën e re financiare, e bën vendimin e Komisionit të paplotë dhe, si rrjedhojë, të pavlefshëm.
27. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, trupi gjykues konstatoi se sikundër pretendoi edhe subjekti i rivlerësimit, Komisioni nuk ka përpiluar një analizë të re financiare përmbledhëse në formë tabelare (përveç asaj të përcjellë me rezultatet e hetimit) për periudhën e vlerësimit dhe t’ia ketë vënë në dispozicion subjektit të rivlerësimit me vendimin përfundimtar. Në këto kushte, trupi gjykues çmoi se mosvënia në dispozicion të subjektit të rivlerësimit nga ana e Komisionit të një analize përfundimtare financiare, pas paraqitjes prej tij të provave të reja në kuadër të kalimit të barrës së provës, nuk mund të përbëjë *apriori* shkak për cenim të procesit të rregullt, në kuptim të

cenimit të parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve apo parimit për akses në gjykatë, për aq kohë sa Komisioni, në arsyetimin e konkluzioneve të arritura prej tij në vendim, rezultoi të ketë marrë në analizë provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe, në përfundim, të ketë pasqyruar efektin e tyre në analizën financiare të vënë në dispozicion subjektit të rivlerësimit me rezultatet e hetimit, duke i krijuar këtij të fundit qartësi në drejtim jo vetëm të rezultatit final të kësaj analize, por edhe të rezultatit të elementeve të kundërshtuara të analizës financiare fillestare.

28. Në çdo rast, në vlerësim të trupit gjykues, shqyrtimi i këtij shkakut është pjesë e analizës së shkaqeve të ngritura në lidhje me vlerësimin e kriterit të pasurisë dhe kundërshtimit nga ana e subjektit të rivlerësimit të konkluzioneve të Komisionit, të cilat kanë çuar në vendimmarrjen objekt kontrolli. Trupi gjykues pati të njëjtin vlerësim edhe përkundrejt pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për cenim të standardit të arsyetimit të vendimit si pasojë e mosarsyetimit të konkluzioneve të Komisionit për "transaksione financiare të diskutueshme" dhe se "gjyqtari, me sjelljen e tij, ka vendosur interesin personal mbi atë të shoqërisë/publikut dhe sundimit të paanshëm të ligjit duke cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë", pretendime këto të cilat u mbajtën në konsideratë nga trupi gjykues, duke u çmuar në mënyrë të integruar me vlerësimin e shkaqeve të tjera të ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit lidhur me këto dy çështje.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material

29. Në lidhje me shkakun e ngritur në ankim nga subjekti i rivlerësimit për konkluzion të gabuar të ILDKPKI-së për deklarim të pasaktë dhe mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimet e pasurisë, me pretendimin se ky konkluzion mbështetet vetëm në deklaratimet periodike të subjektit përpara ILDKPKI-së dhe konkretisht në deklaratën për herë të parë në vitin 2004, lidhur me deklarin e kryer për pasurinë në pronësi të babait, pa pasur detyrim ligjor për një deklarim të tillë dhe se, sa i takon konkluzionit për mungesë dokumentacioni justifikues lidhur me burimet e krijimit të pasurisë, ai i atribuohet faktit që në momentin fillestar të dorëzimit të deklaratës së pasurisë, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur të gjitha provat, të cilat i ka depozituar në vijim pranë Komisionit gjatë procedurës së hetimit administrativ, trupi gjykues konstatoi se procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, i cili kryhet nga Komisioni në bazë dhe për zbatim të parashikimeve të nenit 179/b të Kushtetutës, neneve të Aneksit të saj dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016, ndonëse e ka pikënisjen nga raportet e përpiluara nga organet ndihmëse të përcaktuara me ligj (ILDKPKI, DSIK dhe Inspektorati i KLD-së/KLGj/KLP) për të bërë vlerësimin e secilit prej tri kriterëve të rivlerësimit, i nënshtrohet një procesi të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi nga Komisioni, i cili, referuar edhe qëndrimit të Gjykatës Kushtetuese në vendimin e saj nr. 2/2017, nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet ndihmëse si më sipër cituar. Në kontekst të sa më sipër, shkakun e ngritur nga subjekti i rivlerësimit për kundërshtimin si të gabuar të konkluzioneve të një prej organeve ndihmëse, çmohet pa relevancë në zgjidhjen e çështjes, sa kohë objekt i kontrollit të Kolegjit janë konkluzionet përfundimtare të arritura nga Komisioni dhe të kundërshtuara nëpërmjet ankimit nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me kriteret e rivlerësimit të tij.

30. Lidhur me shkakun e ankimit për kundërshtimin nga subjekti i rivlerësimit si arsyetim abuziv dhe subjektiv nga ana e Komisionit, sa i takon vlerësimit si pasuri e fshehur të pasurisë së paluajtshme të llojit “apartament banimi”, me sipërfaqe 101,42 m², blerë në vitin 2016, në vlerën e 5.400.000 lekëve, me vendndodhje në {***}, Tiranë, trupi gjykues konstatoi si vijon.
31. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, ka arsyetuar në vendimin e tij lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklaramit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë:
- [...] Komisioni vlerëson se ekzistojnë disa fakte dhe rrethana në lidhje me këtë transaksion të shitblerjes midis babait të subjektit dhe subjektit, të cilat nuk janë plotësisht të besueshme [...] Në vijim të kësaj analize, Komisioni konstaton se shpjegimet që subjekti i rivlerësimit ka dhënë në lidhje me marrëdhënien me këtë pasuri, janë kontradiktore, nuk bindin për vërtetësinë e deklaramit të tij se ka pasur vetëm të drejta përdorimi nga viti 2012 – 2016 mbi këtë apartament, por ngrenë dyshime të forta për paraqitjen e rrethanave të rreme, të cilat tentojnë të fshehin nga kontrolli apo verifikimi një marrëdhënie të një natyre tjetër, që është ajo e pronësisë me këtë pasuri që nga momenti i porositjes dhe, më tej, blerjes nga babai i subjektit. [...] Në përfundim të analizës së sipërpërmendur, duke pasur parasysh: mospërputhjen e deklaramive të subjektit me provën e administruar nga notere E. A., për sa i përket jetesës së përbashkët me prindërit në këtë apartament; deklaramet kontradiktore mbi kohën e porositjes së këtij apartamenti nga ana e babait; mosdeklarimin e përdorimit të këtij apartamenti në DPV-të vjetore 2012, 2013, 2014 dhe 2015; subjekti ka filluar të jetojë bashkë me familjen e tij në këtë apartament në të njëjtën kohë me pronarët e këtij apartamenti (prindërit e tij); faktin që babai i subjektit banonte dhe punonte në Kukës sipas dokumentacionit të administruar, por dhe vetë deklaramive të subjektit; kishte pasuri tjetër në Tiranë dhe duket se nuk ka pasur nevojë për blerjen e këtij apartamenti; mungesën e burimeve financiare të ligjshme të babait për të blerë këtë apartament nga të ardhurat e tij 1994 – 2011, në një balancë negative prej 4.924.958 lekësh. Komisioni, bazuar në sa më lart dhe në bindjen e brendshme, në zbatim të rregullit të parashikuar në nenin 51 të ligjit nr. 84/2016, arrin në përfundimin se kjo pasuri është një pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit dhe se është përpiqur të ndryshojë faktet që tregojnë natyrën e marrëdhënies së tij me këtë pasuri, duke u gjendur në këtë mënyrë para parashikimeve të pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016. [...] Lidhur me analizimin e burimit të blerjes së apartamentit nga subjekti i rivlerësimit, në dokumentacionin e administruar nga “Raiffeisen Bank” konfirmohet se në datën 10.8.2016, është transferuar shuma prej 5.400.000 lekësh nga znj. M. Sh. te bashkëshortja e subjektit, me përshkrim: “dhënie hua motrës”. [...] Komisioni, referuar provave dhe shpjegimeve të dërguara deri më tani, nuk krijon bindjen se personi tjetër i lidhur ndodhej në kushtet e favorshme ekonomike për të dhënë hua pa interes, referuar vërtetimeve të të ardhurave për vitin 2015 dhe 2016, nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, duke përfshirë të ardhurat neto, shpenzimet jetike sipas standardit të varfërisë në Austri, personat e tjerë të lidhur, M. dhe A. Sh., dalin me balancë pozitive minimale për vitin 2015, në shumën 5.286,35 euro, vit në të cilin i kanë dhënë edhe një hua tjetër subjektit për blerje makine dhe për vitin 2016 me balancë pozitive, në shumën 11.961,73 euro. [...] Në përfundim të sa më sipër, Komisioni përllogariti të ardhurat dhe shpenzimet e personave të tjerë të lidhur, A. dhe M. Sh., nga ku rezultoi: (1) për vitin

2013, rezulton një balancë pozitive prej 866,1 eurosh; (2) për vitin 2014, rezulton një balancë negative prej 637.61 eurosh; (3) për vitin 2015, rezulton një balancë pozitive prej 5.902,75 eurosh; (4) për vitin 2016, rezulton një balancë pozitive prej 16.668,13 eurosh. Për sa i përket ligjshmërisë së huasë prej 5.400.000 lekësh, Komisioni vlerëson se në këtë rast është i panevojshëm arsyetimi lidhur me mundësitë financiare të personave të tjerë të lidhur, A. dhe M. Sh., referuar konkluzionit në paragrafin 2.52¹¹.

32. Subjekti i rivlerësimit, shkakun e ngritur në ankimin e tij për kundërshtimin si abuziv dhe subjektiv, sa i takon arsyetimit të mësipërm të Komisionit në vendim dhe vlerësimit të pasurisë objekt kontrolli si pasuri të fshehur, e mbështeti në pretendimet e mëposhtme.

32.1. Konkluzioni i Komisionit lidhur me këtë pasuri bie ndesh jo vetëm me dispozitat e ligjit nr. 84/2016, konkretisht me nenet 32 dhe 51 të tij, por edhe me praktikën e konsoliduar gjyqësore të Kolegjit dhe konkretisht me vendimet (JR) nr. 15/2019, (JR) nr. 20/2019, (JR) nr. 7/2020, (JR) nr. 8/2020 dhe (JR) nr. 20/2020.

32.2. Konkluzioni i Komisionit në vlerësimin e pasurisë objekt kontrolli bie ndesh edhe me përcaktimet kushtetuese që garantojnë të drejtën e lëvizjes së lirë të personave, të drejtën e tyre për të disponuar lirisht dhe sipas vullnetit të tyre, të ardhurat e tyre.

32.3. Sipas subjektit të rivlerësimit, në rastin objekt gjykimi nuk rezulton të jenë të pranishme as ndonjë provë, madje as ekzistenca e ndonjë dyshimi të arsyeshëm për të arritur në përfundimin se bëhet fjalë për ndonjë pasuri të fshehur, por sipas tij, jemi përpara vlerësimeve subjektive të cilat cenojnë jo vetëm parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit, por rezulton që të vijnë ndesh edhe me parashikimet kushtetuese të të drejtave të njeriut.

33. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, si dhe mori në analizë rezultatet e hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, konstatoi fillimisht se konkluzioni për pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit parashtrohet nga Komisioni për herë të parë në vendimin objekt ankimi, duke qenë se me relacionin e “Rezultateve të hetimit kryesisht”, subjektit të rivlerësimit i ka kaluar barra e provës vetëm lidhur me (i) pamundësinë e prindërve të subjektit të rivlerësimit¹² (të cilët kanë cilësinë e palës shitëse në marrëdhënien juridike që ka shërbyer si origjinë për krijimin e pasurisë objekt kontrolli) për të justifikuar me burime të ligjshme blerjen e apartamentit që i është shitur subjektit të rivlerësimit; si dhe (ii) dyshimet mbi aftësinë financiare të huadhënësve, personave të tjerë të lidhur, z. A. dhe znj. M. Sh., për të dhënë hua vlerën e 5.400.000 lekëve¹³, shumë kjo e deklaruar nga subjekti i

¹¹ I referohet pjesës së nënvizuar më sipër në këtë paragraf të vendimit.

¹² Lidhur me analizimin e burimit të blerjes së apartamentit nga ana e personit tjetër të lidhur/babait të subjektit të rivlerësimit, Komisioni është shprehur: “Nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, duket se: Nga analiza financiare duket se prindërit e subjektit nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e apartamentit të {***}, pasurive të tjera të cituara më lart, si dhe kryerjen e shpenzimeve, me një balancë negative në shumën -4.924.958 lekë”.

¹³ Lidhur me analizimin e burimit të blerjes së apartamentit nga ana e subjektit të rivlerësimit, Komisioni është shprehur: “Ka dyshime mbi aftësitë financiare të personave të tjerë të lidhur për të dhënë hua shumën prej 5.400.000 lekësh, pasi: (i) personat e tjerë të lidhur/M. dhe A. Sh., sipas analizës financiare, rezultojnë me balancë pozitive

rivlerësimi si burim për blerjen e apartamentit të shitur nga prindërit e tij. Në përfundim, Komisioni ka vënë shënimin: *Pavarësisht paqartësive dhe dyshimeve të Komisionit lidhur me ligjshmërinë e burimit të huasë në vlerë 5.400.000 lekë, kjo shumë është përfshirë në analizën financiare deri në paraqitjen e shpjegimeve dhe provave të subjektit – duke lënë të nënkuptohet që problematika mbetet në drejtim të të provuarit të mundësisë së personave të tjerë të lidhur për të justifikuar me të ardhura të ligjshme shumën e dhënë hua.*

34. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakui ankimi, trupi gjykues, pasi kontrolloi arsyetimin e Komisionit lidhur me pasurinë objekt vlerësimi, konstatoi se ky i fundit, konkluzionin e arritur lidhur me këtë pasuri, e cila është deklaruar si e krijuar nëpërmjet huasë së marrë nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, motrës së saj, znj. M. Sh., në vlerën e 5.400.000 lekëve, e ka bazuar në vlerësimin që i ka bërë marrëdhënies së subjektit të rivlerësimit me prindërit e tij, në lidhje me shitblerjen e pasurisë objekt kontrolli dhe më gjerë, ndërkohë që sa i takon marrëdhënies së huasë, e cila është deklaruar si burim për krijimin e saj, Komisioni duket sikur nuk ka mbajtur një qëndrim përfundimtar lidhur me këtë fakt juridik, për sa kohë rezultoi të jetë shprehur: *Komisioni vlerëson se në këtë rast është i panevojshëm arsyetimi lidhur me mundësitë financiare të personave të tjerë të lidhur, A. dhe M. Sh., referuar konkluzionit në paragrafin 2.52.*
35. Në vlerësimin e trupit gjykues, Komisioni, në përfundim të procesit të kontrollit lidhur me krijimin e pasurisë “apartament banimi” me sipërfaqe 101,42 m², me vendndodhje në {***}, Tiranë, blerë nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2016, nëpërmjet një huaje në vlerën e 5.400.000 lekëve, do duhet të kishte arritur në një konkluzion sa i takon përmbushjes apo jo nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e tjerë të lidhur të detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, pavarësisht nëse do t’i jepte apo jo vlerë këtij konkluzioni në lidhje me vlerësimin përfundimtar të kësaj pasurie.
36. Në kuadër të sa më sipër, referuar konstatimeve të vetë Komisionit në lidhje me transaksionin e huasë së dhënë nga znj. M. Sh., motrës së saj, znj. S. C., njëkohësisht bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, sipas të cilave shuma e dhënë hua, në vlerën 5.400.000 lekë, e ka burimin nga shlyerja pjesore në datën 08.08.2016, në vlerën e 6.586.072 lekëve, e fondit të investimit të krijuar prej huadhënëses në “Raiffeisen Prestige”, në vlerën e 15.200.000 lekëve, me burim, ndër të tjera: (i) transfertën në vlerën 49.940 euro, datë 25.8.2015, nga shitja e apartamentit në Austri; (ii) transfertën e datës 12.8.2015, në vlerën e 41.694 eurove, nga shtetasja A.V., motra e znj. M. Sh., me përshkrimin: “kalim motrës, kthim detyrimi”; (iii) depozitimit *cash* në shumën 3.300.000 lekë në datë 31.8.2015, më përshkrimin: “të ardhura nga emigrimi në Austri”, trupi gjykues arriti në përfundimin se personat e tjerë të lidhur mund të justifikojnë me burime të ligjshme huanë e dhënë. Trupi gjykues, në arritjen e këtij përfundimi, mbajti në konsideratë faktin se fondet e dhëna hua jo

minimale për vitin 2015, në shumën 5.286,35 € (vit në të cilin i kanë dhënë dhe një hua tjetër subjektit në shumën 5.000 euro për blerje makine) dhe për vitin 2016 me balancë pozitive në shumën 11.961,73 €; (ii) mungon dokumentacion justifikues ligjor në lidhje me të ardhurat e ligjshme të personave të tjerë të lidhur/M. dhe A. Sh., për të ardhurat (përveç viteve 2015 dhe 2016), llogaritë bankare dhe shpenzime të tjera për periudhën 2010 – 2016”.

vetëm kanë kaluar nga huadhënësi te huamarrësi me anë të një transferte të rregullt bankare, por ato u provuan të kenë qenë fonde gjendje, të depozituara në bankën e huadhënëses, për rreth 1 vit më parë nga data e kalimit të huasë bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit (duke shuar dyshimet eventuale mbi origjinën e këtyre shumave), si dhe mbi të gjitha, vlera e dhënë hua mund të justifikohet me burime të ligjshme të identifikuara nga shitblerja e pasurisë së paluajtshme të personave të tjerë të lidhur në Austri. Në këto kushte, në vlerësimin e trupit gjykues ishte e panevojshme analiza e kryer nga Komisioni për verifikimin e mundësisë së personave të tjerë të lidhur për të krijuar kursime në atë masë që të mund të justifikonin dhënien e huasë, ndonëse, sikundër rezultoi edhe nga verifikimi i akteve të fashikullit dhe rezultateve të hetimit të Komisionit, ky i fundit është shprehur në vendim për moskrijimin e bindjes lidhur me mundësinë e personave të tjerë të lidhur për të dhënë një hua pa interes dhe jo lidhur me mundësinë e krijimit të shumës së dhënë hua¹⁴. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues e gjen të drejtë pretendimin e subjektit të rivlerësimit se konkluzioni i Komisionit në këtë rast nuk është në përputhje me parashikimet e nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, si dhe me praktikën e konsoliduar të Kolegjit në lidhje me kufijtë e shtrirjes së hetimit në kuadër të analizës financiare për efekt të verifikimit të burimeve të ligjshme në rastet e huadhënëve të deklaruara si burim për krijimin e pasurive objekt kontrolli.

37. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues, duke mbajtur në konsideratë parashikimin e neneve 3, pika 14 dhe 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, si dhe jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit në drejtim të kufijve të hetimit mbi burimet e ligjshme të personave të tjerë të lidhur në kuadër të parashikimeve të nenit 32, pika 4 mbi transaksionet objekt kontrolli të cilat janë deklaruar dhe kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurive të subjekteve të rivlerësimit (dhurime/huadhënie/huamarrje), çmoi se mungesa e evidentuar nga Komisioni e të ardhurave të ligjshme sipas standardit të përcaktuar nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nga prindërit e subjektit të rivlerësimit për të blerë apartamentin objekt kontrolli të shitur në vitin 2016 subjektit të rivlerësimit, edhe në eventualitetin e konfirmimit nga shqyrtimi gjyqësor i çështjes në Kolegji, nuk mund t'i atribuohet subjektit të rivlerësimit si i vetmi fakt determinues në favor të një konkluzioni për fshehje të pasurisë, në mungesë të gjetjeve për një marrëdhënie të subjektit të rivlerësimit me pasurinë objekt kontrolli, të atillë që të mund ta vendoste atë në pozitën e pronarit *de facto* për periudhën nga viti 2004-2016, pavarësisht se pronari *de jure* ishte babai i subjektit të rivlerësimit. Për sa më sipër, trupi gjykues, në analizë të tërësisë dhe specifikave të situatës faktike të këtij rasti, e gjeti pa efekt për vendimmarrjen, analizën financiare të kryer lidhur me mundësinë e prindërve të subjektit të rivlerësimit (shitësve të pasurisë objekt kontrolli) për blerjen e apartamentit me burime të ligjshme.
38. Në arritjen e këtij konkluzioni, nga trupi gjykues u mbajt në konsideratë se, pas marrjes në shqyrtim të fakteve dhe rrethanave të evidentuara nga ana e Komisionit në vendim, të cilat i kanë krijuar bindjen këtij të fundit se pasuria në fjalë është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, ato u

¹⁴ Komisioni rezultoi të jetë shprehur: “Komisioni, referuar provave dhe shpjegimeve të dërguara deri më tani, nuk krijon bindjen se personi tjetër i lidhur të ndodhej në kushtet e favorshme ekonomike për të dhënë hua pa interes, referuar vërtetimeve të të ardhurave për vitet 2015 dhe 2016 nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, duke përfshirë të ardhurat neto, shpenzimet jetike sipas standardit të varfërisë në Austri, personat e tjerë të lidhur, M. dhe A. Sh., dalin me balancë pozitive minimale për vitin 2015, në shumën 5.286,35 euro, vit në të cilin i kanë dhënë edhe një hua tjetër subjektit për blerje makine dhe për vitin 2016 me balancë pozitive, në shumën 11.961,73 euro.

gjetën objektivisht të pamjaftueshme për të arritur në përfundimin se, për pasurinë e blerë në vitin 2016 (e cila për shkak të deklarimit të kryer në deklaratën e pasurisë *vetting*, nuk mund të konsiderohet pasuri e fshehur, pasi kjo pasuri në datën e dorëzimit të deklaratës, ishte në pronësi të subjektit të rivlerësimit), subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehë faktin se ka qenë pronar *de facto* i këtij apartamenti përpara se të fitonte titullin e ligjshëm me kontratën e shitblerjes në vitin 2016. Më konkretisht:

38.1. Në lidhje me konstatimin e Komisionit për mospërputhje të deklarimeve të subjektit me provën e administruar nga notere E. A., për sa i përket jetesës së përbashkët me prindërit në këtë apartament, ku referuar përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit në pyetësin nr. 4, ai ka deklaruar se gjatë periudhës 2004-2012, prindërit kanë jetuar në apartamentin e tyre në Kukës dhe gjatë periudhës 01.05.2012 - 01.11.2016, kanë jetuar me subjektin e rivlerësimit dhe familjen e tij dhe, nga data 01.11.2016 e në vazhdim, jetojnë me shtetasin M. C. (vëllai i subjektit të rivlerësimit) në apartamentin e porositur në Tiranë, pranë shoqërisë “{***}” ShPK, ndërkohë që në dokumentacionin e përcjellë nga notere E. A., është konstatuar se në pjesën hyrëse të kontratës së shitblerjes së apartamentit objekt kontrolli, të lidhur në datën 18.10.2016, referohet se shitësit (babai dhe nëna e subjektit të rivlerësimit) banojnë në adresën: rruga “{***}”, {***}. Trupi gjykues edhe pse vërejtë se nga verifikimi i akteve të fashikullit, faktet e mësipërme janë evidentuar në mënyrë të saktë nga ana e Komisionit, çmoi se relevanca e tyre në drejtim të krijimit të bindjes të Komisionit për pasuri të fshehur, duhet të ishte vlerësuar edhe në raport me faktin se apartamenti i blerë nga babai dhe vëllai i subjektit të rivlerësimit, është porositur në dhjetor të vitit 2014, në një objekt që do të ndërtohej nga shoqëria “{***}” ShPK, sipas një leje ndërtimi të datës 09.09.2014, çka krijoi bindjen të trupi gjykues se pavarësisht mospërputhjeve të konstatuara në lidhje me vendqëndrimin e prindërve gjatë muajit tetor 2016, ato nuk mund të justifikojnë në mënyrë të arsyeshme lindjen e dyshimit për pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit në drejtim të vlerësimit si jo të besueshme të deklarimeve të tij për bashkëjetesë me prindërit, për periudhën 01.05.2012 - 01.11.2016.

38.2. Gjithashtu, edhe në lidhje me konstatimin tjetër të Komisionit mbi *mosdeklarimin nga subjekti i rivlerësimit të përdorimit të këtij apartamenti në DPV-të vjetore 2012, 2013, 2014 dhe 2015*, trupi gjykues, pasi verifikoi përmbajtjet e këtyre deklaratave periodike, ndryshe nga Komisioni, konstatoi se në deklaratat periodike të viteve 2013, 2014 dhe 2015, subjekti i rivlerësimit, adresën e apartamentit të prindërve, e ka deklaruar si adresë banimi. Trupi gjykues vërejtë se sa më sipër, dëshmon për transparencë të fakteve lidhur me përdorimin e apartamentit të prindërve dhe bashkëjetesën e tij me ta, marrë në konsideratë edhe arsyet për një bashkëjetesë të tillë, për faktin që e ëma e subjektit të rivlerësimit kishte nevojë të vazhdueshme për përkujdesje, si pasojë e statusit të saj si invalide e grupit të parë¹⁵ dhe faktit se babai i subjektit të rivlerësimit ushtronte profesionin e mjekut endokrinolog në rrethin e Kukësit (larg bashkëshortes).

39. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe të bazuar shkakun e mësipërm të ankimit të subjektit të rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit për vlerësimin si

¹⁵ Referuar shkresës së Bashkisë Kukës me nr. {***} prot., datë 23.01.2019.

pasuri e fshehur të pasurisë së paluajtshme të llojit “apartament banimi”, me sipërfaqe 101,42 m², të blerë nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2016, në vlerën e 5.400.000 lekëve, me vendndodhje në {***}, Tiranë, çmohet i gabuar pasi nuk mbështetet në fakte.

40. Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “banesë”, të blerë në vitin 2016, në Bremen, Gjermani, me vlerë 48.500 euro, për të cilën subjekti i rivlerësimit pretendoi se konkluzioni i Komisionit lidhur me krijimin e kësaj pasurie, është i pabazuar në fakte dhe rrjedhojë e vlerësimeve subjektive sa i takon vlerësimit si të pajustificuara me të ardhura të ligjshme të burimeve të deklaruara prej tij për financimin e blerjes së saj, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.
41. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, ka arsyetuar në vendimin e tij lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklarimit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, ndër të tjera, si vijon: *Vlerësimi në lidhje me burimin e parë – Komisioni çmon se tatimet e paguara gjatë procesit të rivlerësimit, për të ardhurat e realizuara nga shitja e automjetit, nuk e bindin trupin gjykues për ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, pasi duket qartë që kjo pagesë është bërë për efekt të procesit të rivlerësimit. Gjithashtu, referuar jurisprudencës së Kolegjit⁸⁸, është vlerësuar se pagesa e detyrimeve tatimore pas dorëzimit të deklaratës “vetting” në janar të vitit 2017, është e papranueshme dhe nuk e shmang subjektin nga përgjegjësia ligjore, pasi nuk mund të zhbëjë qasjen e subjektit të rivlerësimit në kundërshtim me ligjin, ndër vite, që u karakterizua nga mospagimi i detyrimeve tatimore në momentin dhe vitin përkatës kur ato duhej të shlyheshin. Si konkluzion, shuma prej 6.000 eurosh, që përbën diferencën mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes, nuk u konsiderua si e ardhur në analizën financiare, pasi nuk konsiderohet si e ardhur e ligjshme në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, subjekti ka mungesë të të ardhurave të ligjshme, në shumën 6.000 euro, sipas germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. [...] Vlerësimi në lidhje me burimin e tretë – Në përfundim të analizës së mësipërme, Komisioni vlerëson që është e pabesueshme që një familje me vetëm një të punësuar, familje e cila hipotetikisht ka jetuar në nivelin e varfërisë dhe që gjatë dy viteve që i paraprijnë vitit 2016, rezulton të kenë pasur të ardhura të papërfillshme, të përdorë të gjitha kursimet e siguruara në 15 vjet punë, për t’ia dhuruar subjektit të rivlerësimit, dhuratë e cila nuk rezulton të jetë përdorur për shkollimin e vajzave të tij, por për të blerë pasurinë e dytë të paluajtshme në shtetin gjerman. Si konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimin e krijimit të të ardhurave të ligjshme të personit tjetër të lidhur E. C., dhe nuk provoi se kishte të ardhura të mjaftueshme për t’i dhuruar subjektit shumën prej 16.150 eurosh, për blerjen e apartamentit në Bremen, Gjermani, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga germa “b”, pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Vlerësimi në lidhje me burimin e katërt – [...] Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij në përgjigje të barrës së provës, nuk arriti të bindë Komisionin se personi tjetër i lidhur E. Sh., ka pasur mundësi t’i jepte hua shumën prej 9.000 eurosh subjektit, për shkak se: (i) nga analiza e të ardhurave në raport me shpenzimet jetike, për një person, me kosto në pragun e varfërisë dhe shpenzime për blerje automjeti, nuk arrin të mbulojë shumën e dhënë hua; (ii) shuma e dhënë hua përfaqëson 60% të të ardhurave të huadhënësës në një periudhë 4-vjeçare; (iii) huadhënësja i jep hua shumën 9.000 euro subjektit dhe një vit më vonë merr hua nga “Raiffeisen Bank”, shumën 316.200 lekë; (iv) provat e reja të paraqitura në prapësimet e*

subjektit shtonin një burim tjetër krijimi nga ana e personit tjetër të lidhur, të ardhurat e bashkëjetuesit nga viti 2013, bashkëjetesë e cila nuk provohej para vitit 2018. Si konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme nga personi tjetër i lidhur, për shumën prej 9.000 eurosh hua, për pagimin nga ky burim, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga germa “b”, pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. [...] Në vlerësimin e përgjithshëm të burimeve të krijimit që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit në Bremen, Gjermani, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit për blerjen e kësaj pasurie, ka mungesë të burimeve të ligjshme, shoqëruara me dokumentacion justifikues, në shumën 31.150 euro, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga germa “b” e pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

42. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit lidhur me krijimin e kësaj pasurie si konkluzion të pabazuar në fakte dhe rrjedhojë e vlerësimeve subjektive. Në mbështetje të këtij shkaku ankimi, subjekti i rivlerësimit, lidhur me burimet e deklaruar prej tij për financimin e blerjes së kësaj pasurie, ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur si vijon.

42.1. *Lidhur me burimin e deklaruar prej 20.000 eurosh, si të ardhura të përfituara nga shitja e automjetit me targa {***}, në pronësi të subjektit të rivlerësimit:*

(i) Sipas subjektit të rivlerësimit konkluzioni i Komisionit, sipas të cilit tatimet e paguara gjatë procesit të rivlerësimit, për të ardhurat e deklaruar nga shitja e automjetit nuk e bindin Komisionin për ligjshmërinë e tyre, pasi duket qartë se kjo pagesë është bërë për efekt të procesit të rivlerësimit, është i gabuar dhe bie ndesh me provat e paraqitura prej tij gjatë procesit, si dhe rezulton të jetë në kundërshtim me parashikimet ligjore të ligjit nr. 84/2016 dhe legjislacionin e zbatueshëm lidhur me pagimin e tatimeve në Republikën e Shqipërisë. Subjekti i rivlerësimit pretendon se ky konkluzion i arritur nga Komisioni në këtë rast bie ndesh edhe me vetë praktikën e ndjekur nga ana e tij në raste të tjera rivlerësimi të ngjashme me rastin objekt ankimi.

(ii) Subjekti i rivlerësimit argumenton se legjislacioni i zbatueshëm lidhur me fushën e tatimeve nuk e pengon tatimpaguesin të shlyejë detyrimet tatimore dhe me vonesë, por për këtë ai është i detyruar të paguajë gjobën përkatëse. Sipas subjektit, nëpërmjet pagimit të tatimit për diferencën prej 6.000 eurosh si fitim të realizuar nga shitja, është përmbushur detyrimi ndaj buxhetit të shtetit, duke u ligjëruar kështu burimi i këtyre të ardhurave.

(iii) Subjekti i rivlerësimit pretendon se ai nuk ka pasur për qëllim të shmangë pagimin e detyrimeve tatimore dhe, sipas tij, ky fakt provohet nga dokumentacioni i lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, në të cilën përshkruhet se ai paguan në mënyrë të rregullt tatimin mbi të ardhurat e realizuara nga qiraja e banesave të ndodhura në Bremen të Gjermanisë. Subjekti gjithashtu pretendon se Komisioni duhet të kishte marrë parasysh në këtë drejtim sjelljen e tij në vazhdimësi, për të vlerësuar nëse ishte përpara një rasti pakujdesie apo përpara një veprimi të qëllimshëm.

(iv) Subjekti i rivlerësimit pretendon se mospagimi i detyrimit tatimor në kohë ka ardhur edhe për shkak se ai ka vlerësuar se nuk ka pasur një detyrim të tillë pasi diferencën prej 6.000 eurosh nga çmimi i blerjes së automjetit në vitin 2015 me atë të shitjes në vitin 2016, nuk e ka konsideruar si fitim, pasi, sipas tij, vlera e automjetit në blerje është e njëjtë me atë në shitje, por për shkak të marrëdhënies së posaçme dhe lidhjes së afërt gjinore me shitësin, z. F. C. (kushëririn e tij), ai e ka

blerë atë me një çmim më të ulët se vlera reale e automjetit. Sipas subjektit të rivlerësimit, në këto rrethana rezulton që diferenca nga vlera reale prej 6.000 eurosh, duhet të konsiderohet si dhurim për të cilin detyrimet tatimore ishin paguar më parë nga z. F. C..

(v) Në kuadër të parashtrimeve me shkrim të dorëzuara në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se, referuar legjislacionit në fuqi për tatimin mbi të ardhurat, sa u takon të ardhurave nga shitja e pasurive të luajtshme automjet, nuk ka përcaktim të shprehur në ligj apo në Deklaratën Individuale Vjetore të të Ardhurave, lidhur me faktin që këto të ardhura i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat personale, situatë kjo që, sipas tij, i ka ndikuar në paqartësinë lidhur me ekzistencën e një detyrimi tatimor mbi këtë lloj të ardhure.

42.2. *Lidhur me burimin e deklaruar prej 16.150 eurosh, si dhuratë nga motra e subjektit, znj. E. C. (G.):*

(i) Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni, në kundërshtim me provat e administruara dhe në mënyrë abuzive, e ka vlerësuar shumë më prej 1500 eurosh të depozituar në vitin 2016 në Bankën Raiffeisen, si kursim të krijuar në tre muajt e parë të vitit 2016, ndonëse vetë Komisioni ka pranuar, sipas aktit të ekspertit italian të Studio {***}, se shuma e kursyer deri në fund të vitit 2015 ka qenë 16.407 euro, sikundër dhe se ajo nuk kishte asnjë ndalim ligjor që t'i mbante kursimet e saj në gjendje *cash*, jashtë sistemit bankar.

(ii) Subjekti i rivlerësimit pretendoi se në zbatim të parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe interpretimit që i ka bërë Kolegji kësaj dispozite, ai ka paraqitur atë prova sa ishin të mjaftueshme për të provuar burimin e ligjshëm të shumës së dhuruar, duke shpjeguar se referuar jurisprudencës së Kolegjit, barra e provës për subjektin e rivlerësimit kufizohet deri në vlerën e shumës së përfituar dhuratë apo hua.

(iii) Subjekti pretendoi se Komisioni nuk e ka mbështetur vendimin e tij në provat e administruara gjatë procesit, pasi, sipas subjektit, ndonëse ai ka dorëzuar dokumentacion provues lidhur me të ardhurat e kumatit të tij, z. G. G., që nga viti 1979 kur ai ka filluar punë, analiza e Komisionit është shtrirë vetëm në harkun kohor 2001-2015, ndonëse vullneti për të bërë këtë dhurim nuk ka qenë vetëm i motrës së tij, por edhe i kumatit, referuar deklaratës noteriale të dhënë prej tij. Gjithashtu, subjekti pretendoi se periudha e analizës nuk përkon as me fillimin e bashkëjetesës së motrës së subjektit të rivlerësimit me z. G. në vitin 1997, as me datën e martesës së tyre, në datë 11.11.2000. Sipas subjektit të rivlerësimit, bashkëjetesa rezultoi e provuar edhe nga deklarata noteriale e dorëzuar nga kunati i tij, si dhe se mosekzistenca e parashikimeve ligjore lidhur me regjistrimin e bashkëjetesës, nuk mund të përdorej si rrethanë rënduese ndaj subjektit të rivlerësimit.

(iv) Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi qëndrimin e Komisionit lidhur me qëllimin e këtij dhurimi dhe përdorimin e kësaj shume nga subjekti i rivlerësimit, me pretendimin se nuk është në funksion apo kompetencë të Komisionit të bëjë vlerësime subjektive lidhur me përdorimin e një të ardhure të ligjshme nga ana e subjektit të rivlerësimit. Në këtë kontekst, ai shpjegoi se në çdo rast, shuma e dhuruar është përdorur në interes të fëmijëve të tij, duke u investuar për këtë qëllim në blerjen e një pasurie të paluajtshme, e cila është dhënë me qira dhe me të ardhurat nga qiraja po financohet shkollimi i fëmijëve. Subjekti pretendoi se e drejta e disponimit lirshëm të kësaj shume i ka kaluar atij, të drejtë të cilën, sipas tij, e ka ushtruar në mënyrën më të mirë të mundshme gjithmonë në interes të fëmijëve të tij.

(v) Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni nuk ka marrë në konsideratë dhe, për rrjedhojë, nuk ka përfshirë në analizën financiare një vendim të gjykatës italiane, sipas së cilës motrës së tij i është njohur e drejta për dëmshpërblim në vlerën e 4.014,64 euro, referuar ky fakt edhe në aktin e ekspertimit të dorëzuar për këtë qëllim. Subjekti pretendoi se nga ana e Komisionit nuk i është bërë e njohur nëse kjo provë nuk ishte në formën e kërkuar nga ligji dhe t'i lihej kohë për t'i depozituar ato. Subjekti kërkoi nga Kolegji administrativ e këtij vendimi gjyqësor, të përcjellë bashkëlidhur ankimit në cilësinë e provës, ndonëse ky akt është pjesë e fashikullit të çështjes, si pasojë e depozitimit nga ana e subjektit pranë Komisionit gjatë fazës së hetimit administrativ dhe, si i tillë, nuk përbën provë të re në proces.

42.3. *Lidhur me burimin e deklaruar prej 9.000 eurosh, si të ardhura të përfituara nga huaja e marrë kumatës, znj. E. Sh.:*

(i) Subjekti i rivlerësimit pretendoi se ka paraqitur të gjitha provat e nevojshme për të provuar mundësinë e kumatës së tij, për t'i dhënë hua shumë prej 9.000 eurosh, të cilën subjekti shprehet se e ka shlyer plotësisht në vitin 2019, si dhe se arsyetimi i Komisionit nuk bazohet në provat e paraqitura gjatë procesit, por në vlerësime subjektive.

(ii) Subjekti pretendoi se me provat e dorëzuara gjatë procesit, ka provuar faktin e bashkëjetesës së kumatës së tij me z. E. H. që nga viti 2013 dhe se mosekzistenca e parashikimeve ligjore lidhur me regjistrimin e bashkëjetesës, nuk mund të përdorej si rrethanë rënduese ndaj tij nga ana e Komisionit.

(iii) Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si abuziv dhe subjektiv konkluzionin e Komisionit, sipas të cilit tërheqjet që kunata e tij ka bërë nga llogaria e saj bankare, krijojnë bindjen se janë përdorur për shpenzimet e përditshmërisë dhe argumentoi se, referuar kuadrit ligjor në Republikën e Shqipërisë, për shtetasit shqiptarë nuk ka pasur kufizim ligjor për mbajtjen e shumave *cash* jashtë sistemit bankar, kufizim ky i vendosur vetëm për një kategori personash, subjekte deklaruese pranë ILDKPKI-së, sipas ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar.

(iv) Sipas subjektit të rivlerësimit, abuziv dhe subjektiv paraqitet edhe arsyetimi tjetër i Komisionit, se fakti i marrjes kredi nga znj. E. Sh. një vit pas dhënies hua të shumë prej 9.000 eurosh subjektit të rivlerësimit, të çon në përfundimin se ajo nuk ka pasur mundësi për dhënien e huasë. Në këtë kontekst, subjekti i rivlerësimit parashtrroi se nevoja e njerëzve për mjete monetare në një moment të caktuar kohor, nuk mund të vërë në dyshim marrëdhëniet e mëparshme financiare të tyre.

43. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, sa u takon pretendimeve të ngritura nga subjekti i rivlerësimit lidhur me automjetin e tipit “Daimler Chrysler”, nga verifikimi i akteve të fashikullit të çështjes, u konstatua që automjeti është blerë nga subjekti i rivlerësimit në vlerën e 14.000 eurove, sipas kontratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.05.2015, para noterës E. H., dhe i është shitur në vijim z. I. S., në vlerën e 20.000 eurove, me anë të kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.07.2016, para noterit S. M., në të cilën citohet se çmimi i shitjes së automjetit është likuiduar tërësisht nga pala blerëse në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit, me nr. {***} pranë Bankës Raiffeisen. Nga verifikimi i transaksioneve të kryera në lëvizjet bankare të llogarisë së sipërcituar, rezultoi se pagesa e çmimit të shitjes së automjetit ishte kryer nga z. I. H. S. në datën 25.07.2016, në vlerën e cituar në kontratë.

44. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues, duke mbajtur në konsideratë faktin se nga Komisioni nuk janë ngritur dyshime mbi fiktivitetin e çmimit të shitjes së automjetit dhe ai u provua të jetë paguar rregullisht në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit nga blerësi i automjetit dhe se, si pasojë, në këtë rast përjashtohet mundësia e deklarimit të një burimi fiktiv të ardhurash, në kuadër të nevojave për të justifikuar krijimin e pasurisë objekt kontrolli, në kushtet kur referuar legjislacionit të zbatueshëm në fuqi, nuk ka një orientim të qartë të tatimpaguesve lidhur me mënyrën e deklarimit dhe pagimit të detyrimit tatimor që buron sipas parashikimeve ligjore të zbatueshme mbi të ardhurat e krijuara nga këto transaksione, trupi gjykues e pranoi si bindës pretendimin e subjektit të rivlerësimit se pagesa me vonesë e këtij detyrimi tatimor, pasi ka marrë dijeni mbi rezultatet e hetimit të Komisionit, duke e lidhur këtë me marrjen dijeni të ekzistencës së detyrimit ligjor për këtë pagesë, është pasojë e paqartësisë së subjektit lidhur me ekzistencën e detyrimit ligjor dhe jo një veprim i qëllimshëm, ndonëse periudha e pagimit të tatimit përkoi me periudhën pas nisjes së procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ky fakt, në vlerësimin e trupit gjykues, vjen si pasojë e pashmangshme e faktit se në rastin konkret, të ardhurat e marra në analizë në drejtim të pagesës së detyrimit tatimor, janë krijuar gjatë vitit 2016 dhe pagesa e tatimeve, në çdo rast, do të përkonte në periudhën e kryerjes së procesit të rivlerësimit, duke qenë se pagesa do të kryhej në kuadër të plotësimit të DIVA-s për vitin 2016, brenda datës 30 prill 2017.
45. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues e gjen të drejtë shkakun e ngritur në ankim lidhur me të ardhurat e krijuara nga shitja në vitin 2016 të automjetit në pronësi të subjektit të rivlerësimit, me targa {***}, në vlerën 20.000 euro, duke e vlerësuar të ardhurën e krijuar nga shitja në tërësinë e saj, si burim të ligjshëm për krijimin e pasurisë “apartament banimi” në Bremen, Gjermani. Të njëjtin qëndrim me sa më sipër mbajti trupi gjykues edhe në drejtim të të ardhurave të krijuara nga shitja në vitin 2011 e automjetit me targa {***}, duke e vlerësuar shumë prej 400.000 lekësh si burim të ligjshëm për pagesën e një pjese të çmimit të blerjes së automjetit me targa {***} ({***}) po në vitin 2011, për arsye të vlerës së vogël të diferencës mes çmimit të blerjes dhe atij të shitjes.
46. Në kuadër të shqyrtimit të shkaqeve të ngritura nga subjekti i rivlerësimit mbi kundërshtimin e konkluzionit të Komisionit sa i takon dhurimit të motrës së subjektit të rivlerësimit, znj. E. C., në vlerën e 16.150 eurove, trupi gjykues, pasi kontrolloi analizën e kryer nga ana e Komisionit mbi verifikimin e burimeve të ligjshme të personit tjetër të lidhur, znj. E. C., dhe arsyetimin e tij në vendim, si dhe analizoi aktet e fashikullit të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.
47. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për vlerësim të gabuar nga ana e Komisionit, lidhur me verifikimin e burimeve të ligjshme për krijimin e shumës prej 1500 eurosh, të depozituar *cash* prej znj. E. C. në llogarinë personale pranë Raiffeisen Bank, përkatësisht 1.000 euro në datën 07.04.2016 dhe 500 euro në datën 22.04.2016, trupi gjykues, pasi kontrolloi analizën financiare të kryer nga Komisioni lidhur me verifikimin e burimeve të ligjshme të personit tjetër të lidhur, znj. E. C., për dhurimin e vlerës prej 16.150 eurosh, konstatoi se vetë Komisioni ka arritur në përfundimin se duke u bazuar në raportin nga Studio {***}, të dorëzuar nga subjekti gjatë hetimit administrativ, shuma e mundshme për kursim nga E. C. dhe bashkëshorti i saj G. G., për periudhën

2001-2015, ishte përlllogaritur në vlerën e 16.407 eurove. Kjo shumë e mundshme për kursim¹⁶, shpjegohet se ka rezultuar nga përlllogaritja e të ardhurave neto nga punësimi i bashkëshortit të znj. E. C. për periudhën 2001-2015, në shumën 179.825,47 euro, duke shtuar edhe dëmshpërblimin për aksidentin e znj. E. C., në vlerën 4.094,64 euro, si dhe duke zbritur në vijim shpenzimet e jetesës në shumën e 167.512,20 eurove (179.825,47 euro + 4.094,64 euro - 167.512,20 euro = 16.407 euro).

48. Në kuadër të përfundimit të mësipërm të vetë Komisionit, trupi gjykues e gjen të drejtë pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni në mënyrë të gabuar, ka përlllogaritur shumën prej 1500 eurosh të depozituar *cash* nga znj. E. C. në vitin 2016 në llogarinë e saj në Bankën Raiffeisen, si kursim të krijuar prej saj në tre muajt e parë të vitit 2016, për sa kohë Komisioni nuk ka konstatuar asnjë gjetje në drejtim të faktit se e gjithë vlera prej 16.407 eurosh, që përfaqëson kursimin e mundshëm të znj. E. C. deri më 31.12.2015, ndodhej e depozituar në bankë apo ishte përdorur në çfarëdolloj forme, duke justifikuar në këtë kuptim qasjen e Komisionit për verifikimin e krijimit të shumës së depozituar *cash*, prej 1.500 eurosh, gjatë periudhës së 3-mujorit të parë të vitit 2016.
49. Përveç sa më sipër, trupi gjykues konstatoi se edhe nëpërmjet një analize për verifikimin e mundësisë së krijimit të kursimit në vlerë prej 1.500 eurosh nga të ardhurat e personave të tjerë të lidhur gjatë 3-mujorit të parë, Komisioni duhet të kishte arritur në një rezultat pozitiv pasi, bazuar në diferencën mes të ardhurave neto të përlllogaritura në mënyrë përpjesëtimore për 3 muaj, në shumën prej 4.565,57 eurosh, dhe shpenzimeve jetike të përlllogaritura në mënyrë përpjesëtimore për 3 muaj, në shumën prej 3.179,37 eurosh, vlera e mundshme për kursim do të rezultonte në shumën prej 1.386 eurosh, me një diferencë prej 114 eurosh, e cila çmohet e paefektshme në kuadër të një analize të tillë mbi bazë prezumimi. Për më tepër që në total, në fund të 3-mujorit të parë të vitit 2016, sipas analizës së kryer si më sipër, rezultoi që znj. E. C. mund të justifikonte me burime të ligjshme një vlerë kursimi prej 17.793 eurosh, që e tejkalonte vlerën e dhurimit prej 16.150 eurosh.
50. Sa më sipër, trupi gjykues konstatoi se në momentin e dhurimit në favor të subjektit të rivlerësimit të vlerës prej 16.150 eurosh, nga znj. E. C., kjo e fundit dhe subjekti i rivlerësimit përmbushin detyrimin ligjor të përcaktuar në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për justifikimin me burime të ligjshme të shumës së dhuruar. Bazuar në rezultatet e kësaj analize, duke mbajtur në konsideratë faktin se ky dhurim është kryer nëpërmjet transaksionit bankar, si dhe rezultoi që fondet e kaluara nga znj. E. C. te vëllai i saj kanë historik të dhënash të transaksioneve bankare të urdhëruara nga znj. E. C. që nga viti 2012¹⁷ dhe se vlerat e tyre në vite tejkalojnë vlerën e dhuruar, duke mbështetur

¹⁶ Poshtëshënimi nr. 89 në faqen 45 të vendimit të Komisionit.

¹⁷ Referuar shkresës së datës 04.05.2020, nr. {***} prot., të Raiffeisen Bank (protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 06.05.2020), nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë rrjedhëse të znj. E. C. pranë kësaj banke dhe lëvizjeve të kryera në fondin e investimeve të saj pranë Raiffeisen Invest, kanë rezultuar transaksionet e mëposhtme: Më datë 24.08.2012, rezultojnë gjendje likuiditetesh në shumën prej 27.800 eurosh në llogarinë rrjedhëse. Më datë 28.02.2013, është depozituar "cash" nga znj. E. C., shuma prej 200 eurosh në llogarinë rrjedhëse. Po më datë 28.02.2013, gjendja totale prej 28.000 eurosh, është kaluar nga llogaria rrjedhëse pranë kësaj banke, në fondin e investimeve pranë Raiffeisen Invest, të cilat janë investuar nga kjo e fundit në datën 04.03.2013 për blerje kuotash. Në datën 27.08.2014, është bërë transferimi i shumës prej 9.956 eurosh nga Intesa Sanpaolo Bank në llogarinë rrjedhëse të znj. E. C. pranë Raiffesien Bank. Këto likuiditete kanë kaluar më datë 01.09.2014, nga llogaria rrjedhëse pranë kësaj banke, në fondin

në këtë mënyrë edhe pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit se këto nuk janë të vetmet të ardhura që kanë krijuar/pasur dhuruesit, por ai ka paraqitur aq prova sa ishin të mjaftueshme për të provuar burimin e ligjshëm të shumës së dhuruar, trupi gjykues krijoi bindjen mbi besueshmërinë e këtij dhurimi dhe, si rrjedhojë, vlerësoi se vlera e këtij dhurimi duhet të përfshihet si e hyrë në analizën e Komisionit mbi verifikimin e burimeve të ligjshme të pasurisë objekt kontrolli. Trupi gjykues i vlerësoi si qëndrime të pambështetura në të dhënat e hetimit administrativ, konkluzionet e Komisionit mbi vullnetin/diskrecionin e dhuruesve.

51. Në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me verifikimin e ligjshmërisë së burimeve të personit tjetër të lidhur, znj. E. Sh., për krijimin e shumës së dhënë hua në vlerën e 9.000 eurove, trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të Komisionit, kontrolloi analizën e kryer prej tij dhe arsyetimin lidhur me këtë burim të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit për krijimin e pasurisë objekt kontrolli, konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.
52. Nga kontrolli i ushtruar nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, u konstatua se analiza e kryer nga Komisioni mbi verifikimin e burimeve të ligjshme për krijimin nga znj. E. Sh., të shumës prej 9.000 eurosh, të dhënë hua subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet transfertës bankare në Raiffeisen Bank, në datën 30.08.2016, në llogarinë e subjektit, me përshkrimin: *dhënë borxh me të drejtë kthimi*, është e saktë dhe, si pasojë, personi tjetër i lidhur rezultoi me mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar huanë e dhënë, në shumën prej 197.521¹⁸ lekësh.
53. Në kuptim të rezultatit të mësipërm të analizës së Komisionit, trupi gjykues e gjen të pabazuar vlerësimin përfundimtar që i ka bërë Komisioni këtij burimi për krijimin e pasurisë objekt kontrolli nga ana e subjektit të rivlerësimit, duke mos e konsideruar atë si të tillë në tërësi, pavarësisht rezultatit të analizës financiare për mungesë të burimeve të ligjshme për justifikimin vetëm të vlerës prej 197.521 lekësh. Trupi gjykues çmoi gjithashtu si të pabazuar arsyetimin e Komisionit se fakti i marrjes kredi nga znj. E. Sh. një vit pas dhënies hua të shumës prej 9.000 eurosh subjektit të rivlerësimit, sjell si pasojë arritjen e përfundimit se ajo nuk ka pasur mundësi për dhënien e huasë, duke qenë se referuar parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, analiza e Komisionit në vlerësimin e ligjshmërisë së burimit të krijimit të shumës së dhënë hua, duhet të ishte fokusuar në fakte dhe rrethana që lidheshin me marrëdhënien objekt kontrolli dhe që kanë ndodhur përpara momentit të dhënies së huasë. Për rrjedhojë, arsyetimi i Komisionit në këtë rast, se ky fakt i ndodhur pas dhënies së huasë, mund të shërbejë si shkak për prezumimin e pamundësisë së personit tjetër të lidhur për dhënien e huasë, u vlerësua nga trupi gjykues si i pabazuar, për rrjedhojë, një konkluzion i tillë i Komisionit u çmua nga trupi gjykues si një vlerësim subjektiv.

e investimeve pranë Raiffeisen Invest, të cilat janë investuar nga kjo e fundit në datën 03.09.2014, për blerje kuotash. Në datën 15.09.2014, fondet e investuara pranë Raiffeisen Invest, prej 31.099 eurosh, kanë kaluar në llogarinë rrjedhëse pranë Raiffesien Bank dhe, më datë 18.09.2014, likuiditetet në shumën 30.895 euro, janë tërhequr nga llogaria rrjedhëse pranë kësaj banke, nga znj. E. C.. Më datë 27.01.2016, znj. E. C. ka depozituar "cash" shumën prej 1.680 eurosh në llogarinë rrjedhëse pranë Raiffesien Bank dhe, më datë 28.01.2016, i ka kaluar këto likuiditete në fondin e investimeve pranë Raiffeisen Invest. Më datë 12.04.2016, kalon shuma prej 9.771 eurosh nga Raiffeisen Invest në llogarinë rrjedhëse të znj. E. C. pranë Raiffesien Bank, të cilat, së bashku me depozitimin "cash" prej 1.000 eurosh më datë 07.04.2016 dhe depozitimin "cash" prej 500 eurosh më datë 22.04.2016, i ka kaluar në llogarinë rrjedhëse pranë së njëjtës bankë, në favor të subjektit, në shumën 11.260 euro.

¹⁸ Konvertuar në shumën e 1460 eurove, sipas kursit të këmbimit të përdorur nga Komisioni: 1 euro = 135,27 lekë.

54. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues arriti në përfundimin se huaja e hënë nga znj. E. Sh. duhet të merret në konsideratë si burim i ligjshëm për krijimin e pasurisë së deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, vetëm në vlerën e justifikuar me burime të ligjshme, prej 7.540 eurosh, dhe të përfshihet si e tillë në analizën financiare për verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve për krijimin e pasurisë objekt kontrolli.
55. Në përfundim të analizës ligjore lidhur me shqyrtimin e shkaqeve të ankimit që lidhen me vlerësimin nga Komisioni të pasurisë së paluajtshme të llojit “banesë”, të blerë në vitin 2016, në Bremen, Gjermani, bazuar në konkluzionet e arritura për secilin prej burimeve të krijimit të kësaj pasurie të marra në shqyrtim, trupi gjykues, pasi reflektoi sa më sipër në analizën e kryer nga Komisioni lidhur me verifikimin e mundësisë së krijimit nga subjekti i rivlerësimit të pasurisë objekt kontrolli, konstatoi se ky i fundit rezultoi me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e saj, në vlerën prej 1460 eurosh. Në këto kushte, trupi gjykues e gjeti të drejtë konkluzionin e Komisionit lidhur me vlerësimin e kësaj pasurie, si të krijuar në mungesë të burimeve të ligjshme. Për rrjedhojë, trupi gjykues çmoi se për pasurinë e paluajtshme të llojit “banesë”, të blerë në vitin 2016, në Bremen, Gjermani, me vlerë 48.500 euro, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
56. *Lidhur me pasurinë e luajtshme automjet të tipit “Citroen Elyse”, me targa {***}, të blerë në vitin 2013, për të cilën subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.*
57. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, në kuadër të kontrollit të kësaj pasurie, ka arritur në këto konkluzione: *Referuar arsyetimit në paragrafët 2.87 - 2.99¹⁹ dhe konkluzionit të arritur në paragrafin 2.100, ku në analizë të të ardhurave dhe shpenzimeve jetike të personave të tjerë të lidhur, A. dhe M. Sh., për vitin 2013, rezulton një balancë pozitive prej 866,1 eurosh, e cila është e pamjaftueshme për dhënien hua të shumës prej 5.000 eurosh, në kushtet kur subjekti nuk dorëzoi dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e këtyre shtetasve përpara vitit 2013. Si konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme nga personat e tjerë të lidhur për shumën prej 5.000 eurosh, e përdorur për blerjen e automjetit, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga germa “b” e pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.*
58. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar në ligj konkluzionin e Komisionit lidhur me pamundësinë e kumatës së tij, znj. M. Sh., dhe të bashkëshortit të saj për të justifikuar me burime të ligjshme dhënien e huasë znj. S. C., në vlerën e 5.000 eurove, të deklaruar si një ndër burimet për blerjen e automjetit të tipit *Citroen Elyse*. Këtë shkak të ankimit, subjekti i rivlerësimit e mbështeti në pretendimet se:
- (i) Ligjshmëria e të ardhurave të huasë së dhënë në vitin 2013 nga kunata e tij, znj. M. Sh., nëpërmjet transfertës bankare, referuar legjislacionit të Bashkimit Evropian, si dhe parashikimeve

¹⁹ Shih këta paragrafë në vendimin e Komisionit në faqet 29-32.

të ligjeve nr. 4/2020 “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare” dhe nr. 146/2013 “Për ratifikimin e Konventës për ndihmën administrative të ndërsjellë në çështjet tatimore”, nuk mund të vihet në dyshim.

(ii) Komisioni ka përllogaritur në mënyrë të gabuar shpenzimet jetike të familjes së kumatës në Austri. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit parashtroi se të dhënat zyrtare të dërguara nga ana e autoriteteve kompetente austriake, rezultojnë haptazi të ndryshme nga konstatimet dhe referimet e Komisionit dhe, si rrjedhojë, përfundimet e Komisionit lidhur me koston minimale të jetesës në Austri për vitet 2015 dhe 2016, janë në kundërshtim me të dhënat zyrtare që disponohen nga ana e Institutit të Statistikave të Austrisë. Subjekti argumentoi gjithashtu se nëse shifrat e përdorura nga Komisioni lidhur me koston minimale të jetesës do të ishin të sakta, kunata e tij nuk do kishte pasur mundësi që në vitin 2015 të transferonte nga Raiffeisen Bank Austri drejt Raiffeisen Bank Shqipëri, shumën prej 91.744,39 eurosh, nga të cilat rreth 31.000 euro rezultojnë të jenë kursime. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi shifrat e përdorura nga ana e Komisionit lidhur me koston e jetesës, me pretendimin se është cenuar parimi i transparencës, për sa kohë nuk është bërë e njohur cilat janë elementet përbërëse të këtyre shifrave dhe çfarë përqindjesh zënë shpenzimet për strehim të cilat, sipas subjektit, duhet të zbriten, në kushtet kur kunata e tij dhe bashkëshorti i saj jetojnë në shtëpinë në pronësi të tyre dhe nuk kanë shpenzime qiraje.

(iii) Kërkimi nga ana e Komisionit i të gjitha lëvizjeve bankare të kumatës dhe bashkëshortit të saj nga viti 1994 e në vazhdim, është kërkesë e cila bie ndesh me përcaktimet e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, bie ndesh me parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit në gjykim, si dhe është kërkesë abuzive duke qenë se kostot e paraqitjes së një informacioni të tillë do të ishin të jashtëzakonshme.

(iv) Sipas subjektit të rivlerësimit, arsyetimi i Komisionit lidhur me pamundësinë e kumatës së tij për të dhënë huanë në vitin 2013, në vlerën e 5.000 eurove, bie ndesh me vetë provat e administruara nga Komisioni. Në kuadër të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit parashtroi se, për sa kohë referuar edhe komunikimit të Komisionit me Bankën Raiffeisen, znj. M. Sh. ka investuar në fondin “Raiffeisen Prestige”, në vitin 2015, shumën 15.200.000 lekë, nuk mund të vihet në diskutim mundësia e saj për të dhënë hua në datën 21.11.2013, shumën prej 5.000 eurosh, që përfaqëson as 5% të shumës së sipërcituar.

59. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se marrja e huasë në vitin 2013 nga znj. M. Sh., në vlerën e 5000 eurove, nëpërmjet transfertës bankare nga një vend i Bashkimit Evropian dhe në kontekstin e parashikimeve të ligjeve nr. 4/2020 “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare” dhe nr. 146/2013 “Për ratifikimin e Konventës për ndihmën administrative të ndërsjellë në çështjet tatimore”, nuk mund të vërë në diskutim ligjshmërinë e shumës së dhënë hua, trupi gjykues, pasi shqyrtoi përmbajtjen e akteve ligjore të sipërcituara, arriti në përfundimin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk është i bazuar, për shkak se ndonëse Konventa e Këshillit të Evropës “Për ndihmën administrative të ndërsjellë në çështjet tatimore” është një instrument ndërkombëtar, i miratuar me qëllim shkëmbimin e informacionit dhe rritjen e bashkëpunimit në çështjet tatimore mes vendeve

nënshkruese në kuadër të luftës kundër evazionit fiskal²⁰, kjo nuk nënkupton që çdo transfertë bankare i nënshtrohet një kontrolli të imtësishëm në drejtim të verifikimit të burimeve të ligjshme të krijimit të shumave të transferuara. Për më tepër, pavarësisht se kjo konventë është ratifikuar në vitin 2013, konstatohet se zbatimi i saj, si dhe i marrëveshjes shumëpalëshe të Autoritetit Kompetent për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare, për shmangien e mashtrimit tatimor dhe të evazionit fiskal, si dhe përmirësimin e pajtueshmërisë tatimore kombëtare e ndërkombëtare, është synuar të garantohet me ligjin 4/2020 “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”, i cili i shtrin efektet e tij nga momenti i hyrjes në fuqi në vitin 2020, pas kryerjes së transfertës bankare objekt kontrolli. Për rrjedhojë, trupi gjykues arriti në përfundimin se verifikimi i kryer nga Komisioni, në përputhje me standardin e vendosur sipas parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nëpërmjet verifikimit të mundësisë së huadhënësës për të krijuar me burime të ligjshme vlerën e dhënë hua, është në përputhje me ligjin dhe jurisprudencën e Kolegjit. Në këtë kuptim, subjekti i rivlerësimit, së bashku me huadhënësen kanë pasur për detyrim ligjor justifikimin e burimeve të ligjshme të shumës së dhënë hua dhe, për rrjedhojë, të depozitonin për efekt të kësaj analize, të dhënat financiare lidhur me burimet e të ardhurave të huadhënësës, në masën e nevojshme për të përmbushur barrën e provës për justifikimin e vlerës prej 5000 eurosh, referuar edhe standardit tashmë të konsoliduar të Kolegjit në drejtim të sa më sipër.

60. Në kuadër të analizës mbi vlerësimin e pretendimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me verifikimin e mundësisë së huadhënësve për krijimin me burime të ligjshme të shumës së dhënë hua, prej 5.000 eurosh, në vitin 2013, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si vijon.
61. Trupi gjykues fillimisht konstatoi se Komisioni, edhe pse në analizën e kryer mbi verifikimin e burimeve të ligjshme të huasë ka përlllogaritur mundësinë e kursimit të huadhënësve gjatë vitit 2013 në vlerë prej 866,1 eurosh, në rezultatit financiar të paraqitur në vendim sipas analizës së kryer e ka konsideruar të gjithë shumën prej 5.000 eurosh me mungesë të burimeve të ligjshme, duke mos e marrë në konsideratë vlerën e rezultuar si të justifikuar me burime të ligjshme dhe rrjedhimisht, duke vepruar në këtë mënyrë në kundërshtim me standardin e zbatuar nga Kolegji në raste të ngjashme.
62. Sa u takon pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në lidhje me mënyrën e përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës së huadhënësve në Landin Burgenland, Austri, trupi gjykues, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, kontrolloi të dhënat e përdorura nga Komisioni nëpërmjet aksesimit të faqes zyrtare në internet të Komisionit Evropian mbi të dhënat zyrtare për Austrinë, mbi këtë

²⁰ Në nenin 1 të kësaj Konvente parashikohet:

1. Palët, në pajtim me dispozitat e kapitullit IV, i japin njëra-tjetrës ndihmë administrative të ndërsjellë në çështjet tatimore. Kjo ndihmë mund të përfshijë, sipas rastit, masat e marra nga organet gjyqësore.

2. Kjo ndihmë administrative përbëhet nga:

a) shkëmbimi i informacionit, duke përfshirë ekzaminime të njëkohshme tatimore, dhe pjesëmarrja në ekzaminimet tatimore jashtë shtetit;

b) ndihmën në kompensimin, duke përfshirë masat e ruajtjes; dhe

c) dorëzimin e dokumenteve.

3. Një palë jep ndihmë administrative nëse personi i prekur është rezident apo shtetas i një Pale apo i çdo shteti tjetër.

Iloj shpenzimi, nga ku rezultoi se për periudhën 2013-2016, shpenzimet e jetesës për minimumin jetik në Austri, për një familje të përbërë prej dy personash të rritur dhe dy fëmijë (deri në moshën 14 vjeç), janë përkatësisht në vlerën 27.812 euro për vitin 2013, 29.245 euro për vitin 2014, 29.308 euro për vitin 2015 dhe 29.855 euro për vitin 2016, të dhëna këto të cilat përputhen me të dhënat e përfshira në analizën e Komisionit. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se për vitin 2013 nuk disponohen të dhëna të publikuara nga Komisioni Evropian dhe se, duke krahasuar të dhënat për vitin 2019, rezulton, sipas tij, se shumatat e shpenzimeve të jetesës për këtë vit, për familjen e huadhënësve, me rezidencë në Austri, janë më të ulëta se ato të marra në konsideratë nga Komisioni, pas verifikimeve të kryera²¹, u gjet i pabazuar në fakte.

63. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Instituti i Statistikave të Austrisë është organi kompetent për përcaktimin e minimumit jetik në Austri²², dhe se nuk disponohen të dhëna për vitet 2015 dhe 2016, por vetëm për vitet 2017-2019, trupi gjykues konstatoi se nga verifikimi i faqes zyrtare në internet të Institutit të Statistikave të Austrisë, u evidentuan të dhëna të publikuara në këtë faqe, lidhur me shpenzimet e jetesës, ku për periudhën 2014-2015, për një tipologji familjeje mesatare, të përbërë prej 2,23 personash, shpenzimet paraqiteshin në vlerën e 2.990 eurove në muaj, ose në 35.880 euro në vit, vlerë kjo që rezultoi të jetë më e lartë sesa përllogaritur në analizën e Komisionit për këtë periudhë kohore, konkretisht 29.245 euro për vitin 2014 dhe 29.308 euro për vitin 2015. Në këto kushte, qasja e Komisionit në drejtim të përllogaritjes së shpenzimeve të jetesës së familjes së huadhënësve, për efekt të analizës së kryer lidhur me verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e shumës së dhënë hua në vlerën e 5.000 eurove, rezulton të ketë qenë në favor të subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, pretendimet e tij në drejtim të kundërshtimit të rezultatit të analizës financiare si pasojë e përllogaritjes së gabuar dhe të padrejtë të shpenzimeve të jetesës, u çmuan të pabazuara.
64. Në vijim të konkluzionit të mësipërm, trupi gjykues vlerësoi të pabazuara pretendimet për reduktim të komponentëve të caktuar të shpenzimeve të jetesës dhe në mënyrë të posaçme, ato lidhur me strehimin, duke qenë se referuar metodologjisë²³ së përdorur në lidhje me përcaktimin e vlerës së këtyre shpenzimeve, u vu re se shifrat e publikuara janë rezultat i një anketimi të një popullate të përzgjedhur në të cilin janë përfshirë të gjitha familjet private/njësitë familjare dhe anëtarët e tyre aktualë që banojnë në territorin e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian në kohën e mbledhjes së të dhënave, përjashtuar këtu familjet kolektive dhe institucionet (si p.sh., spitalet, shtëpitë e të moshuarve, burgjet, kazermat ushtarake, institucionet fetare, konviktet etj.), por jo atë grupim të familjeve që strehimin e ka të siguruar sipas një banese në pronësi. Për rrjedhojë, për sa kohë rezultoi që të dhënat e publikuara kanë marrë në konsideratë dhe përfaqësojnë një komponent shpenzimesh strehimi për çdo tipologji familjeje, pavarësisht zgjidhjes së tyre lidhur me strehimin

²¹ Shih linkun e mëposhtëm:

https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/ILC_LI01/default/table?lang=en&category=livcon.ilc.ilc_ip.ilc_li

²²<https://www.statistik.at/en/statistics/population-and-society/consumption-expenditure-and-consumer-durables-in-private-households/consumption-expenditure>

https://www.statistik.at/web_de/statistiken/menschen_und_gesellschaft/soziales/verbrauchsausgaben/konsumerhebu ng_20_14_2015/index.html

²³https://ec.europa.eu/eurostat/cache/metadata/en/ilc_esms.htm

(nëpërmjet qiramarrjes apo në banesa në pronësi), trupi gjykues e vlerësoi të pabazuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit për reduktimin me 25% të shpenzimeve të jetesës.

65. Gjithashtu, trupi gjykues vlerësoi të pabazuar në ligj edhe pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit se, për sa kohë znj. M. Sh. ka investuar në fondin “Raiffeisen Prestige”, në vitin 2015, shumën 15.200.000 lekë, nuk mund të vihet në diskutim mundësia e saj për të dhënë hua në datën 21.11.2013, shumën prej 5.000 eurosh, që përfaqëson as 5% të shumës së sipërcituar. Në arritjen e këtij përfundimi, trupi gjykues, referuar parashikimit ligjor të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, vlerësoi se pavarësisht nivelit të provuar të kursimeve gjendje të huadhënësve, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës që së bashku me huadhënësit, të provojë ligjshmërinë e burimeve të shumës së dhënë hua, e cila nuk mund të prezumohet nga ekzistenca e fakteve që kanë ndodhur më pas në kohë.
66. Në vijim të konkluzioneve të mësipërme, trupi gjykues, pasi kontrolloi analizën financiare të kryer nga Komisioni lidhur me krijimin e kësaj pasurie, konstatoi se ndryshe nga ky i fundit, rezultati përfundimtar i analizës së kryer mbi verifikimin e ligjshmërisë së shumës së dhënë hua, paraqitet me një mundësi kursimi me burime të ligjshme në vlerën e 1007 eurove, e cila edhe pse u përfshi si e hyrë në analizën e burimeve të krijimit të pasurisë objekt kontrolli, përsëri nuk mund të justifikojë vlerën e huadhënies prej 5.000 eurosh. Në këto kushte, trupi gjykues arriti në përfundimin se për pasurinë e luajtshme të llojit automjet të tipit “Citroen Elyse”, me targa {***}, të krijuar sipas kontratës noteriale të “Qirasë financiare”, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.11.2013 dhe në vijim kontratës noteriale të shitblerjes së automjetit, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.11.2018, në vlerën e 10.000 eurove, subjekti i rivlerësimit rezultoi me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për shpenzimin e kryer lidhur me krijimin e kësaj pasurie në vitin 2013, në vlerën e 3.993 eurove, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
67. *Lidhur me kursimet në gjendje “cash” jashtë sistemit bankar, të deklaruara në deklaratat periodike vjetore dhe të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit si të përdorura si burim për blerjen e automjetit me targa {***} dhe automjetit me targa {***}, si dhe një pjesë e tyre të shpenzuara ndër vite, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.*
68. Në përfundim të procesit të rivlerësimit lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklaramit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive të luajtshme të llojit “automjet”: (i) të tipit “Mercedes Benz”, me targa {***} ({***}), të blerë në vitin 2011 në vlerën e 8.000 eurove; dhe (ii) të tipit “Daimler Crysler AG”, me targa {***}, të blerë në vitin 2015 në vlerën e 14.000 eurove, Komisioni është shprehur në vendim, respektivisht si vijon: (i) [...] Në lidhje me pikën (ii), Komisioni vlerëson që gjendja e likuiditeteve “cash” në fund të çdo viti mbetet e pandryshuar sipas arsyetimit në paragrafët 3.87 - 3.89²⁴. Në përfundim, Komisioni

²⁴ Referuar vendimit të Komisionit, përmbajtja e paragrafëve të cituar më sipër është:

“3.87 Duke analizuar deklaratat periodike vjetore, Komisioni konstaton se në asnjë rast, subjekti i rivlerësimit apo bashkëshortja nuk kanë deklaruar pakësim të gjendjes “cash” dhe, për rrjedhojë, në rast se do të konsiderohej pretendimi i tij për t’i konsideruar shumat e deklaruara çdo vit nga subjekti dhe bashkëshortja, si shtesa të gjendjes

vlerëson se subjekti dhe personat e lidhur kanë mungesë financiare burimesh të ligjshme në shumën -570.648 lekë, për përbalimin e shpenzimeve në vitin 2011, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga germa “b” e pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

(ii) [...] Lidhur me pretendimin e subjektit sipas pikës (ii), Komisioni vlerëson që gjendja e likuiditeteve “cash” në fund të çdo viti, mbetet e pandryshuar sipas arsytimit në paragrafët 3.87 - 3.89. [...] Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti dhe personat e lidhur kanë mungesë financiare burimesh të ligjshme në shumën -672.213 lekë, për përbalimin e shpenzimeve dhe blerjen në vitin 2015, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga germa “b” e pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

69. Subjekti kundërshtoi si të pabazuar dhe abuzive mospërfshirjen e kursimeve në formën e likuiditetit gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, të deklaruara ndër vite, si burim për blerjen e automjetit me targa {***} dhe të automjetit me targa {***}, si dhe të pjesës tjetër të përdorur ndër vite. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni në mënyrë të gabuar nuk i është referuar përmbajtjes së deklaratës së pasurisë *vetting*, në të cilën është deklaruar përdorimi i kursimeve *cash* të deklaruara ndër vite si burim për blerjen e pasurive të sipërcituara, por u është referuar deklaratave periodike, ku sipas subjektit, në deklarimin e këtyre pasurive, ai gabimisht nuk ka deklaruar burimin e krijimit. Subjekti i rivlerësimit prapësoi se paqartësitë në deklaratimet periodike nuk përbëjnë shkak për mospërfshirjen e kursimeve në analizën financiare, sikundër as paqartësia e tij si subjekt në deklaratimet që mund të ketë dhënë në ILDKPKI, nuk mund të përbëjë shkak për mospërfshirjen e kursimeve në gjendje *cash* në analizën e verifikimit të burimeve të ligjshme për blerjen e këtyre pasurive, kur përdorimi i tyre si burim për krijimin e pasurive, është deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*. Subjekti i rivlerësimit pretendoi gjithashtu se referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit, rezultoi që ai dhe bashkëshortja e tij të kenë deklaruar kursime në deklaratat periodike vjetore të dorëzuara në referim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, si dhe në deklaratën e dorëzuar në referim të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016, rezultoi që të kenë deklaruar se si janë përdorur këto kursime. Sipas subjektit të rivlerësimit, deklaratat periodike vjetore duhet të vlerësohen si provë vetëm sa i përket faktit nëse ai dhe bashkëshortja e tij kanë deklaruar apo jo kursime nga paga.
70. Subjekti pretendoi edhe se Komisioni fillimisht në analizën financiare që i ka komunikuar së bashku me raportin përfundimtar, lidhur me rezultatet e hetimit administrativ, i ka përfshirë në përlogaritjet e tij kursimet e deklaruara për vitet 2012 dhe 2013, ndërsa në vendimin objekt ankimi, sipas subjektit, në mënyrë abuzive nuk i ka përfshirë ato. Në përfundim, subjekti pretendoi se nëse do të përfshiheshin në analizën financiare të viteve 2011, 2015 dhe 2016 edhe kursimet e deklaruara në gjendje *cash*, do të rezultonte që ai nuk kishte mungesë burimesh financiare në këto vite. Gjithashtu, ai kundërshtoi si abuziv dhe jo në mbështetje të provave të administruara gjatë

së likuiditeteve, balancat negative vjetore do të shtoheshin dhe do të duhej të shpjegonte gjendjen prej 2.830.000 lekësh të akumuluar në fund të vitit 2016 e të padeklaruara në deklaratën “vetting”.

3.88 Gjithashtu në procesverbalin e ILDKPKI-së, datë 24.10.2014, subjekti ka deklaruar se gjendja “cash” deri më 31.12.2013, ka qenë rreth 200.000 lekë, ndërkohë që në analizën financiare të dorëzuar prej tij, kjo gjendje paraqitet 1.120.000 lekë. Kjo diferencë e theksuar midis dy deklaratimeve të subjektit, e bën jo të besueshme llogaritjen e tij lidhur me gjendjen e likuiditeteve “cash” në fund të vitit, pas kalimit të barrës së provës.

3.89 Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se gjendja e likuiditeteve “cash” në fund të çdo viti mbetet e pandryshuar”.

procesit dhe përmbajtjes së deklaratës *vetting*, konkluzionin e Komisionit lidhur me vlerësimin e likuiditeteve gjendje *cash* në banesë, sipas të cilit: *Në rast se do të konsiderohej pretendimi i subjektit për t'u konsideruar shumë e deklaruar çdo vit nga subjekti dhe bashkëshortja e tij si shtesa të gjendjes së likuiditeteve, balancat negative vjetore do të shtoheshin dhe do të duhej të shpjegonte gjendjen prej 2.830.000 lekësh, të akumuluar në fund të vitit 2016, të padeklaruara në deklaratën "vetting".* Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit shprehet se nuk kishte sesi të ishin gjendje kursimet e deklaruar *cash* ndër vite në momentin e plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, duke qenë se ato, sipas tij, ishin përdorur në vitet 2011, 2015 dhe 2016, sikundër deklaruar prej tij edhe në deklaratën *vetting*. Për këtë qëllim, subjekti kërkoi nga Kolegji përsëritjen e hetimit administrativ, duke përfshirë në analizën financiare edhe kursimet e deklaruar ndër vite dhe përdorimin e tyre si më sipër referuar.

71. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, në vlerësimin e pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në drejtim të efektit që ka pasjellë vlerësimi nga Komisioni i likuiditetit gjendje *cash* në analizën financiare të viteve 2011 dhe 2015, kur janë krijuar edhe dy pasuritë e luajtshme të llojit "automjet", me të dhëna si më sipër referuar, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të Komisionit, konstatoi se në deklaratimet periodike para ILDKPKI-së, përkatësisht në vitet 2011 dhe 2015, subjekti i rivlerësimit nuk kishte deklaruar burimin e krijimit të këtyre dy pasurive të luajtshme. Përveç mosdeklarimit të burimit të krijimit të dy automjeteve objekt kontrolli, subjekti i rivlerësimit nuk rezultoi të kishte deklaruar në këto deklarata periodike, në rubrikën përkatëse të ndryshimeve të pasurisë, as pakësimin e gjendjes së likuiditetit *cash* në banesë. Për më tepër, u konstatua që në rubrikën e ndryshimeve të pasurive dhe interesave privatë të DIPPV-së së vitit 2011, subjekti kishte deklaruar "kursyer nga të ardhurat e përfituara nga paga", vlerën prej 350.000 lekësh. Të njëjtin deklaram (në përshkrim) rezultoi të kishte bërë edhe bashkëshortja e tij në rubrikën përkatëse, duke deklaruar vlerën prej 200.000 lekësh.
72. Referuar relacionit të rezultateve të hetimit administrativ, lidhur me analizën financiare të vitit 2011, Komisioni rezultoi se i kishte kaluar subjektit barrën e provës për gjetjen: *Nga analiza financiare e vitit 2011, duket se subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive, me një balancë negative në shumën -570.648 lekë.* Bazuar në tabelën e analizës financiare për këtë vit, Komisioni duket se ndryshimet e gjendjeve të likuiditetit *cash* i ka pasqyruar në vlerën + 50.000 lekë (d.m.th., ka vlerësuar shtim të likuiditetit gjendje *cash* në banesë nga deklarimi i mëparshëm vetëm vlerën prej 50.000 lekësh, ndonëse referuar deklaratimit të subjektit dhe bashkëshortes së tij në DIPPV-në e vitit 2011, si referuar më sipër, shtesa e likuiditetit *cash* u vu re të ketë qenë në vlerën e 550.000 lekëve). Nga krahasimi i kryer mes rezultatit të analizës së paraqitur në rezultatet e hetimit administrativ dhe asaj të pasqyruar në vendimin objekt ankimi, konstatohet se rezultati përfundimtar i kësaj analize është i njëjtë, çka logjikisht konfirmon faktin se analiza fillestare e Komisionit nuk ka pësuar ndryshime zërash.
73. Ndërkohë, në shpjegimet e dhëna me shkrim në kundërshtim të rezultateve të hetimit administrativ, si dhe personalisht gjatë seancës dëgjimore të datës 02.10.2020, duke marrë shkas nga rezultatet e analizës financiare me pamjaftueshmëri burimesh për vitet 2011 dhe 2015, subjekti në analizën që

u ka bërë deklarimeve lidhur me gjendjet e likuiditetit *cash* në banesë, është shprehur: *Referuar Deklaratës së Interesave Privatë Periodikë Vjetorë të vitit 2011, të dorëzuar nga unë si subjekt, rezulton [...] të kem deklaruar: “Kursyer nga të ardhurat e përfituara nga paga, shumën 350.000 lekë, ndërsa bashkëshortja ime rezulton që të ketë deklaruar si kursime të përfituara nga paga, shumën 200.000, pra në vitin 2011, unë dhe bashkëshortja kemi deklaruar si kursime nga pagat e përfituara shumën prej 550.000 lekësh. Në total, gjendja “cash” rezulton që të jetë në vlerën 550.000 lekë, për shkak se nga kursimet e viteve të kaluara, në shumën e përgjithshme 980.000 lekë, rezulton që të jetë shpenzuar shuma 430.000 gjatë vitit 2011 dhe, për rrjedhojë, gjendja e “cash-it” mbetet në shumën 550.000 lekë. [...] Sikurse është parashtruar edhe më lart, rezulton që në fund të vitit 2014, unë dhe bashkëshortja ime të kemi pasur kursime në gjendje “cash”, shumën 1.020.000 lekë, nga të cilat rezulton që unë me qëllim blerjen e automjetit të sipërcituar, kam shpenzuar shumën 730.000 lekë, duke mbërritur në këtë mënyrë gjendja “cash” në shumën 290.000 lekë. [...] Nga ana juaj, në analizën financiare të vitit 2016, nuk është përfshirë edhe shuma prej 290.000 lekësh, si shumë kursimesh “cash” të akumuluar nga puna ime dhe e bashkëshortes ndër vite.*

74. Në analizë të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues vlerëson fillimisht se në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratat periodike të viteve në të cilat janë krijuar këto dy pasuri objekt kontrolli (automjete), përdorimin e kursimeve gjendje *cash* në banesë, as në formën e burimit të krijimit të këtyre pasurive, as në formën e pakësimit të gjendjes së këtij lloji likuiditeti, Komisioni me të drejtë nuk e ka vlerësuar likuiditetin gjendje *cash* si burim për krijimin e këtyre dy automjeteve në vitet 2011 dhe 2015. Kjo mënyrë të vlerësuarit e Komisionit në analizat financiare të këtyre dy viteve, parimisht vlerësohet në përputhje me standardin tashmë të konsoliduar edhe nga vendimmarrjet e deritanishme të Kolegjit lidhur me rastet dhe mënyrën e përdorimit të kursimeve gjendje *cash* në banesë, në kuadër të analizës për kontrollin e burimeve të krijimit të pasurive. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit, sipas të cilave deklarimi i përdorimit të kursimeve gjendje *cash*, si burim për krijimin e pasurisë në deklaratën e pasurisë *vetting*, së bashku me deklarimin e kursimeve *cash* në banesë në deklaratat periodike përmbushin standardin e Kolegjit lidhur me përdorimin e kursimeve gjendje *cash*, pavarësisht se në deklaratën periodike të vitit në të cilin është krijuar pasuria, nuk është deklaruar as pakësimi i gjendjes *cash*, as përdorimi i kursimeve *cash* si burim për krijimin e pasurisë, vlerësohen të pabazuara. Kjo për shkak se jo vetëm konstatohet se standardi i vendosur nga Kolegji, sipas vendimit orientues në çështjen e rivlerësimit të subjektit E.S., është keqinterpretuar nga subjekti i rivlerësimit, por edhe për faktin se një interpretim/zbatim i tillë i orientimit të dhënë nga Kolegji në çështjen e sipërcituar, lidhur me mënyrën e vlerësimit të kursimeve *cash* në raport me burimet e krijimit të pasurive, do të binte ndesh me parashikimet e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, duke justifikuar pa shkak të ligjshëm dhe në mungesë të rrethanave të veçanta që mund të çonin në një vlerësim të ndryshëm të situatës faktike, shkeljen e dispozitave të këtij ligji, lidhur me detyrimin ligjor për deklarimin e shtesave dhe pakësimeve të likuiditetit të llojit *cash* në banesë, si dhe të detyrimit ligjor për deklarimin e burimeve të krijimit të pasurive objekt deklarimi.
75. Pavarësisht sa më sipër analizuar dhe konkluduar në raport me konkluzionin e Komisionit për moskonsiderimin në parim të kursimeve *cash*, si burim për krijimin e këtyre dy pasurive, trupi

gjykues vlerëson se të paktën për vitin 2011, kur rezultojn që subjekti dhe personi i lidhur me të kanë deklaruar kursime të krijuara nga të ardhurat nga paga, në vlerën totale prej 550.000 lekësh, ndërkohë që Komisioni ka vlerësuar se shtesa e likuiditetit gjendje *cash* është vetëm 50.000 lekë, ka sjellë në fakt të njëjtin rezultat në analizën financiare të këtij viti me pretendimin e subjektit të rivlerësimit – duke qenë se vlerën e kursimit vjetor prej 500.000 lekësh, Komisioni nuk ia ka nënshtruar kontrollit lidhur me burimet e krijimit – pretendim që parimisht Komisioni, si më sipër trajtuar, nuk e ka pranuar. Trupi gjykues, nga kontrolli i analizës financiare të kryer në Komision lidhur me periudhën e rivlerësimit 2003-2016, konstatoi se Komisioni, vlerat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të (bashkëshortja e tij) në deklaratat periodike pranë ILDKPKI-së, i ka përlogaritur në analizën e tij si gjendje totale e këtij likuiditeti në fund të çdo viti dhe jo si shtesa likuiditeti, duke prodhuar si pasojë në analizë, sa pretenduar nga vetë subjekti i rivlerësimit, se në analizën e vitit 2013 Komisioni i ka marrë në konsideratë përdorimin e likuiditetit gjendje *cash* (për shkak se sipas qasjes që ka pasur Komisioni në vlerësimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me likuiditetet e llojit *cash*, duke i vlerësuar ato si gjendje në fund të çdo viti, është krijuar artificialisht rezultati i pakësimit të këtij likuiditeti në vitin 2013, me 150.000 lekë).

76. Duke mbajtur në konsideratë parashikimet ligjore lidhur me mënyrën e deklarimit të likuiditeteve, si dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit lidhur me deklaratat e tij periodike mbi kursimet e likuiditetit në formë *cash-i*, trupi gjykues e gjen të pabazuar në fakte dhe në ligj mënyrën e rivlerësimit nga Komisioni të deklarimeve të subjektit lidhur me këto likuiditete dhe, rrjedhimisht, përlogaritjen e tij në analizën financiare të kryer për vitet 2007-2013, në të cilat rezultojn që subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë deklaruar kursime nga pagat në gjendje *cash* jashtë sistemit bankar. Pavarësisht sa më sipër, në kuadër të mospërkeqësimit të situatës financiare të subjektit të rivlerësimit, Kolegji vlerësoi pretendimet e ngritura në këtë shkak të ankimit sipas analizës së kryer nga Komisioni dhe rezultetit të saj financiar, duke arritur në konkluzionin se pretendimet e subjektit të rivlerësimit për mosmarrjen në konsideratë të pakësimit të gjendjes *cash*, janë të pabazuara në fakte dhe në çdo rast nuk do të sillnin asnjë efekt të shtuar në favor të subjektit të rivlerësimit.
77. *Lidhur me të ardhurat e deklaruara si të realizuara nga dhënia me qira e pasurive të paluajtshme në Bremen, Gjermani, për të cilat subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar në ligj konkluzionin e Komisionit për mospërfshirjen e tyre në analizën financiare të kryer për vitin 2016, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.*
78. Në përfundim të procesit të rivlerësimit lidhur me krijimin e këtyre të ardhurave, Komisioni është shprehur në vendim si vijon: *Për sa i përket pretendimit të subjektit se duhet përfshirë qiraja që subjekti ka përfutur për periudhën 8.10.2016 – 31.12.2016, nga shtetasi sirian A.H., në shumën 222.064 lekë, Komisioni konstaton se pavarësisht se bazuar në nenin 4 të kontratës së qirasë, marrëdhënia e qirasë parashikohet të fillojë në datën 15.10.2016, subjekti nuk ka deklaruar të ardhura nga qiraja për vitin 2016, as në deklaratën periodike/vjetore dhe as në deklaratën “vetting” dhe nuk provoi me dokumentacion ligjor datën e arkëtimit/transferimit të këtyre të ardhurave në llogarinë bankare të shtetasit E. M. dhe, më tej, marrjen e tyre nga subjekti. Vetëm*

pas kalimit të barrës së provës, subjekti i deklaroi këto të ardhura dhe kreu pagesën e detyrimeve tatimore dhe, për këtë arsye, nuk mund të konsiderohen në analizën financiare. Lidhur me pretendimin e subjektit se në vitin 2016 duhet përfshirë edhe garancia prej 1.330 eurosh, e lënë nga qiramarrësi A. H., në zbatim kjo të kontratës së qirasë së datës 8.10.2016, Komisioni konstaton se pavarësisht se bazuar në nenin 5 të kontratës së qirasë është parashikuar se qiramarrësi është i detyruar që me fillimin e marrëdhënies së qirasë t'i paguajë qiradhënësit një shumë prej 1.330 eurosh, subjekti nuk e ka deklaruar marrjen e kësaj garancie në vitin 2016, as në deklaratën periodike/vjetore dhe as në deklaratën "vetting". Për më tepër, nuk u provua me dokumentacion ligjor data e arkëtimit/transferimit të këtyre të ardhurave në llogarinë bankare të shtetasit E. M. dhe, më tej, marrja e tyre nga subjekti.

79. Në mbështetje të shkakut të ankimit për konkluzion të gabuar të Komisionit lidhur me vlerësimin e të ardhurave të deklaruara si të realizuara nga dhënia me qira e apartamentit në Bremen, Gjermani, në periudhën 08.10.2016 - 31.12.2016, në vlerën e 222.064 lekëve, si dhe të shumës së garancisë prej 1.330 eurosh, të lënë nga qiramarrësi, subjekti pretendoi se konkluzioni i Komisionit, sipas të cilit ai i ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga qiraja dhe nga garancia e qiramarrësit vetëm pas kalimit të barrës së provës, është abuziv dhe nuk përputhet me gjendjen e faktit. Sipas subjektit, fakti që ai ka harruar të deklarojë të ardhurat e përfituara nga qiraja për vitin 2016, në vlerën e 222.064 lekëve, nuk e bën këtë të ardhur të paligjshme. Sipas subjektit të rivlerësimit, marrja e të ardhurave të qirasë për periudhën e sipërcituar provohet nga përmbajtja e kërkesës së drejtuar në janar të vitit 2017, qiramarrësit nga ana e përfaqësuesit të subjektit të rivlerësimit. Subjekti pretendoi se kontrata e qirasë e lidhur mes tij dhe z. A. H. më datë 08.10.2016, është depozituar në përputhje me ligjin edhe pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë dhe është paguar edhe tatimi përkatës. Sipas tij, pagimi me vonesë i detyrimeve tatimore lidhur me qiranë e përfituar për periudhën 08.10.2016 deri më datë 31.12.2016, ka ardhur si rezultat i paqartësisë se ku duhej të paguhej detyrimi tatimor për qiranë e përfituar, në Republikën Federale të Gjermanisë, ku realizoheshin të ardhurat, apo në Shqipëri, ku kishte vendbanimin subjekti i rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se nuk ka pasur qëllim t'i shmanget pagimit të detyrimit përkatës, referuar edhe faktit që në vitet e mëpasshme i ka paguar rregullisht detyrimet tatimore lidhur me të ardhurat e realizuara nga dhënia me qira e pasurive të paluajtshme në Bremen të Gjermanisë.
80. Në lidhje me konkluzionin e Komisionit lidhur me shumën e garancisë prej 1.330 eurosh, subjekti i rivlerësimit pretendoi se nuk ka pasur detyrim për ta deklaruar këtë vlerë, e cila, sipas kontratës së qirasë, ishte lënë nga qiramarrësi si garanci për dëmet e mundshme, si dhe duhej të kthehej prej subjektit në cilësinë e qiradhënësit, në mbarim të kontratës së qirasë. Subjekti pretendoi gjithashtu se në kontratën e qirasë nuk parashikohej ndonjë ndalim për të si qiradhënësi për ta përdorur shumën e dhënë si garanci, por vetëm që ta kthente këtë shumë në përfundim të kontratës së qirasë, nëse sendit të dhënë me qira nuk i ishin shkaktuar dëme.
81. Në shqyrtim të këtij shkakut ankimi, nga verifikimi i akteve të fashikullit të çështjes, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si vijon.

82. Më datë 08.10.2016, subjekti i rivlerësimit, i përfaqësuar nga z. E. M., ka lidhur një kontratë qiraje për apartamentin e blerë në Bremen, Gjermani, në vitin 2015, me z. H. A., me datë fillimi të marrëdhënies së qirasë dt. 15.10.2016. Referuar kësaj kontrate, çmimi bruto i qirasë ishte 665 euro në muaj, shumë e cila sipas nenit 3 të kontratës ishte parashikuar të paguhej në llogarinë bankare të z. M.. Në nenin 5 të së njëjtës kontratë, është përcaktuar: *Qiramarrësi është i detyruar, me fillimin e marrëdhënies së qirasë, t'i paguajë qiradhënësit një garanci mbi qiranë në shumën 1330 euro. Kjo mund të realizohet duke hapur një depozitë, duke lënë një garanci bankare ose duke bërë pagesë “cash” apo transferim në llogarinë e qiradhënësit.*
83. Në datën 27.02.2019, në përgjigjet e dhëna për pyetësorin shtesë të dërguar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit është shprehur: *Pasurinë e përshkruar në pikën nr. (i), të ndodhur në {***}, Bremen, Gjermani, ia kam dhënë me qira shtetasit A. H., në shumën 970 (nëntëqind e shtatëdhjetë) euro në muaj, nga të cilat 665 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë) euro përbëjnë qiranë mujore bazë, ndërsa [...]. Për shkak se unë nuk kam llogari bankare në shtetin gjerman, qiraja e sipërcituar fillimisht është kaluar në llogarinë bankare të shtetasit E. M., i cili ka qenë në pozitën e përfaqësuesit tim në lidhjen e kontratës dhe konkretisht në IBAN {***}, si dhe më pas dhe aktualisht kalohet në llogarinë bankare të shtetasit S. M., që ky i fundit ka në Postbank Gjermani, me nr. {***}. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga qiraja e sipërcituar gjatë vitit 2017, kam paguar tatimin pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë në vitin 2018, në shumën 159.141 (njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e dyzet e një) lekë në zërin: “Pagim i tatimit në burim për të ardhura të krijuara jashtë territorit të Shqipërisë”. PAGESA nga ana ime pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë është bërë në respektim të: “Marrëveshjes për shmangien e tatimit të dyfishtë të lidhur ndërmjet Shqipërisë dhe Gjermanisë”.*
84. Në kuadër të përgjigjeve të dhëna në pyetësorin nr. 2 të Komisionit, në datën 11.05.2020, subjekti i rivlerësimit është shprehur: *Sikurse kam deklaruar edhe në përgjigjet e pyetësorit shtesë nr. 1, të sjellë nga ana juaj lidhur me të ardhurat që unë kam përfituar nga dhënia me qira e banesave të ndodhura në Bremen, Gjermani, në referim të “Marrëveshjes për shmangien e tatimit të dyfishtë të lidhur ndërmjet Shqipërisë dhe Gjermanisë” kam paguar, për vitet 2016, 2017, 2018 dhe 2019, tatimin pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, në shumën 159.141 (njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e dyzet e një) lekë, 254.369 (dyqind e pesëdhjetë e katër mijë e treqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë, si dhe 256.150 (dyqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e pesëdhjetë) lekë. PAGESAT e sipërcituara janë përshkruar në zërin : “Pagim i tatimit në burim për të ardhura të krijuara jashtë territorit të Shqipërisë”. [...] Në funksion të asaj që ju parashtrova më lart, po ju paraqes me cilësinë e provës këto dokumente:*
- a) Vërtetim me nr. {***} prot., datë 21.06.2018, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, në të cilin përshkruhet qartë se vlera e tatimit të paguar nga ana ime, është në shumën 159.141 (njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e dyzet e një) lekë.
- b) Vërtetim me nr. {***} prot., datë 10.06.2019, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, në të cilin përshkruhet qartë se vlera e tatimit të paguar nga ana ime, është në shumën 254.369 (dyqind e pesëdhjetë e katër mijë e treqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë.

c) Vërtetim me nr. {***} prot., datë 30.04.2020, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, në të cilin përshkruhet qartë se vlera e tatimit të paguar nga ana ime, është në shumën 256.150 (dyqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e pesëdhjetë) lekë.

85. Në kuadër të përgjigjeve të dhëna në pyetësorin nr. 5, lidhur me mbledhjen e të ardhurave nga kjo marrëdhënie qiraje, subjekti ka dorëzuar në cilësinë e provës edhe një deklaratë noteriale të dhënë nga z. S. M. me nr. {***} rep., nr. {***} kol, datë 17.08.2020, sipas së cilës ky i fundit deklaroi, ndër të tjera: *Meqenëse shtetasi Neritan Cena nuk kishte të drejtë të hapte llogari në shtetin Gjerman, në kushtet që nuk ishte rezident, më ka kërkuar që qiraja që ai përfutonte nga shtetasi A. H., të derdhej në llogarinë time bankare në shtetin gjerman për shkak se unë jam rezident në këtë shtet si dhe kam të drejtë të kem llogari bankare. Deklaroj nën përgjegjësinë time, se gjatë vitit 2017, qiraja nga shtetasi A. H. është derdhur në llogarinë time bankare që unë kam në Gjermani pranë Postbank [...]. Në funksion të vërtetësisë së këtij deklarimi, kësaj deklarate i bashkëlidhet: Shkresa e datës 06.01.2017 drejtuar shtetasit A. H.. Referuar përmbajtjes së kësaj shkrese të thjeshtë, nënshkruar nga z. S. M., si përfaqësues i subjektit të rivlerësimit, konstatohet se z. A. H. i është kërkuar që qiraja e cila deri në atë moment i paguhej z. E. M., në vazhdim t'i paguhej z. S. M. në llogarinë e tij bankare në Postbank.*
86. Në kuadër të hetimit të kryer nga Komisioni, janë administruar nga organet tatimore sa më poshtë:
- (i) Shkresa nr. {***} prot., datë 27.02.2019, me anë të së cilës Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve bën me dije se subjekti i rivlerësimit figuron i regjistruar si individ privat për përgjegjësinë tatimore “tatimi mbi të ardhurat individuale (DIVA)” dhe se të dhënat e kërkuara nga Komisioni do të dërgohen nga DRT-ja përkatëse.
- (ii) Shkresa nr. {***} prot., datë 05.03.2019, e Drejtorisë së Analizës dhe Informatikës, me anë të së cilës kjo e fundit informon: *Neritan B. Cena [...] është i regjistruar në organin tatimor për përgjegjësinë tatimore tatim mbi të ardhurat individuale (DIVA). Nga ana e këtij individi, është kryer deklarimi individual për vitin 2017. Bashkëlidhur shkresës, është përcjellë edhe DIVA e vitit 2017, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura bruto me burim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe ka paguar edhe tatimin përkatës.*
- (iii) Shkresa nr. {***} prot., datë 19.08.2020, e Drejtorisë së Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave, me anë të së cilës konfirmohet: *Shtetasi Neritan B. C. është i regjistruar për përgjegjësinë tatimore DIVA, ka kryer deklaratimet për vitet 2017, 2018, 2019. Bashkëlidhur shkresës janë përcjellë edhe DIVA-t e viteve përkatëse, nga ku konstatohet deklarimi i të ardhurave të krijuara nga qiratë për këto vite dhe pagesa e tatimeve përkatëse, të cilat përputhen në vlerë me sa treguar edhe nga shkresat e përcjella nga vetë subjekti i rivlerësimit.*
87. Në kuadër të shpjegimeve të dhëna lidhur me rezultatet e hetimit të kryer nga Komisioni, më datë 22.09.2020, subjekti i rivlerësimit rezultoi të ketë dorëzuar për herë të parë një shkresë të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, e cila konstatohet të jetë nxjerrë në përgjigje të kërkesës së subjektit të rivlerësimit të datës 14.09.2020. Sipas kësaj shkrese, me nr. {***} prot., datë 14.09.2020, organi tatimor shprehet: *Ju konfirmojmë se z./znj. Neritan Cena me numër Unik Identifikimi [...] ka deklaruar dhe paguar nëpërmjet Deklaratës Individuale Vjetore të të Ardhurave detyrimet tatimore për vitin kalendarik 2016, Tatimin në Burim për të Ardhura të krijuara jashtë territorit*

të Republikës së Shqipërisë, sipas kontratës “Dhënie me qira” në Gjermani [...]. Në këtë vërtetim, sikundër me të drejtë ka konstatuar Komisioni, nuk është deklaruar koha në të cilën është kryer pagesa e konfirmuar e tatimit për të ardhurat nga qiraja për vitin 2016, në vlerën e tyre bruto prej 222.064 lekësh.

88. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues vëren se me të drejtë është konstatuar nga Komisioni se nga ana e subjektit të rivlerësimit, nuk është provuar nëpërmjet dokumentacionit justifikues marrja e të ardhurave të qirasë për periudhën tetor - dhjetor 2016, sipas përcaktimit kontraktual, sikundër dhe se këto të ardhura as janë deklaruar përkatësisht në deklaratën periodike të vitit 2016 dhe atë të pasurisë *vetting*. Referuar fakteve të konstatuara dhe rrethanave në të cilat kanë ndodhur, nisur nga arsyetimi mbi bazën e mungesës së indicieve në drejtim të mospërbushjes së detyrimeve kontraktuale vetëm për periudhën tetor – dhjetor 2016, edhe në eventualitetin që do të pranohej krijimi i këtyre të ardhurave, duke vërejtur se kontrata është zbatuar rregullisht për vitet në vazhdim, në drejtim të vlerësimit të ligjshmërisë së këtyre të ardhurave sipas standardit të përcaktuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues çmoi se subjekti i rivlerësimit ka dështuar të provojë me dokumentacion justifikues pagesën e tatimit për këto të ardhura. Vërehet se subjekti i rivlerësimit edhe pse ka deklaruar në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, se ka paguar tatimin për të ardhurat e krijuara nga qiraja për vitet 2016, 2017, 2018 dhe 2019, bashkëlidhur këtyre përgjigjeve, ka dorëzuar vetëm pagesat e tatimeve për të ardhurat nga qiratë e viteve 2017, 2018 dhe 2019.
89. Në analizë të dinamikës së komunikimeve me organin tatimor jo vetëm në kuadër të hetimeve të kryera nga Komisioni, por edhe nga dokumentacioni i mbledhur nga vetë subjekti i rivlerësimit, arrihet në përfundimin se tatimi për të ardhurat e pretenduara për vitin 2016, rezulton të jetë paguar në intervalin kohor 19.08.2020 - 14.09.2020, pavarësisht se në shkresën e DRT Tiranë nuk është referuar data e pagesës së detyrimit tatimor që i takonte vitit 2016. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se Komisioni me të drejtë nuk e ka vlerësuar të ardhurën e krijuar nga qiraja për vitin 2016, si të ardhur të ligjshme në kuadër të standardit të përcaktuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, pasi sjellja e subjektit në lidhje me përmbushjen e detyrimit tatimor lidhur me këtë pagesë, duket të jetë diktuar nga qëllimi për legjitimimin e shumës së pretenduar prej 222.064 lekësh, e cila do të ndikonte në kompensimin e rezultatit negativ të analizës financiare të vitit 2016. Fakti që subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhurat nga qiraja për vitin 2017 dhe ka paguar rregullisht edhe tatimin përkatës sipas konfirmimit nga organi tatimor, hedh poshtë pretendimet e subjektit se pagesa e vonuar (në vitin 2020) vjen si pasojë e mungesës së qartësisë se kur dhe ku duhet të paguheshin tatimet për këtë lloj të ardhure, ndërkohë që rezultoi që për të ardhurat e krijuara në vitin 2017, rregullisht kishte përmbushur detyrimet në datën 14.05.2018.
90. Sa i takon kopjes së njësuar të konfirmës bankare të lëshuar nga Raiffeisen Bank që mban datën 11.05.2018, bashkëlidhur së cilës ndodhet urdhërpagesa për tatimin mbi të ardhurat individuale, e dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në Kolegj më datë 17.03.2023, bashkëlidhur materialit shkresor të titulluar "Parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe depozitim provash shtesë", trupi gjykues vërejt fillimisht se në kuadër të analizës sipas parashikimeve të nenit 47, në kombinim me nenin 51, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 49/2012, ky akt nuk plotëson kriteret për

t'u pranuar si provë e re në proces, sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk rezultoi të ketë pasur ndonjë pengesë për paraqitjen e tij që në fazën e hetimit administrativ në Komision apo qoftë edhe në momentin e depozitimit të ankimit, sa kohë akti pretendohet të jetë një mandat pagese bankare, e kryer nga vetë subjekti i rivlerësimit që në vitin 2018, bazuar në një urdhër pagese “1800 - Tatimi mbi të ardhurat individuale”, i cili gjenerohet nga vetë subjektet deklaruese në momentin kur rezultojnë me detyrim pagese për tatimin mbi të ardhurat personale në momentin e dorëzimit të DIVA-s. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së aktit, trupi gjykues konstatoi se sa referohej në mandatpagesë, konkretisht detyrimi për pagesë të tatimit mbi të ardhurat nga qiraja për periudhën janar – dhjetor 2017, në vlerën e 232.131 lekëve, binte në kundërshtim me përgjigjet e dhëna nga vetë subjekti i rivlerësimit në pyetësorin shtesë të dërguar në datën 27.02.2019, se: “Lidhur me të ardhurat e përfituara nga qiraja e sipërcituar gjatë vitit 2017, kam paguar tatimin pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë në vitin 2018, në shumën 159.141 (njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e dyzet e një) lekë në zërin: “Pagim i tatimit në burim për të ardhura të krijuara jashtë”²⁵ dhe me deklarimin në pyetësorin nr. 2 të Komisionit, të datës 11.05.2020 dhe përmbajtjes së vërtetimit me nr. {***} prot., datë 21.06.2018, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, të depozituar nga subjekti në mbështetje të deklarimeve të tij se: [...] në të cilin përshkruhet qartë se vlera e tatimit të paguar nga ana ime, është në shumën 159.141 (njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e dyzet e një) lekë, duke iu referuar pagesës së kryer nga subjekti i rivlerësimit mbi detyrimin e tatimit në burim për të ardhurat e krijuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (rubrika nr. 13 e DIVA-s) me vlerë principali 1.060.941 lekë, me datë veprimi bankar “Raiffeisen Bank 14.05.2018” dhe vlerë 159.141 lekë dhe jo 232.331 lekë.

91. Sa u takon pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në lidhje me përdorimin e shumës prej 1330 eurosh të garancisë së qiramarrësit, sipas kontratës së qirasë, trupi gjykues arriti në përfundimin se me të drejtë Komisioni nuk e ka marrë në konsideratë përdorimin e kësaj shume në vitin 2016, sa kohë ky fakt nuk u arrit të provohet nga ana e subjektit të rivlerësimit, i cili edhe pse mund ta përdorte këtë shumë parash (qoftë edhe në shkelje të parashikimeve kontraktuale) në kuadër të detyrimeve të subjektit deklarues sipas parashikimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, do duhej ta kishte deklaruar këtë fakt në formën e interesit privat të krijuar nga përdorimi i një shumë monetare të cilën e dispononte si pasojë e një marrëdhënieje juridiko-civile.
92. Lidhur me pasurinë e luajtshme të llojit automjet të tipit “Mercedes Benz”, vit prodhimi 1990, me targa {***}, të deklaruar në DIPPV-në e vitit 2004 si të dhuruar, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar dhe në kundërshtim me përcaktimet kushtetuese dhe ato ligjore konkluzionin e Komisionit për deklarim të pasaktë lidhur me krijimin e kësaj pasurie, me pretendimin se referuar legjislacionit të zbatueshëm për procesin e rivlerësimit kalimtar, ai nuk ka pasur detyrim të deklarojë automjetin me targa {***}, në kushtet kur ky automjet në momentin e plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, nuk ishte në pronësinë e tij, duke qenë se i ishte vjedhur më datë 17.02.2006. Subjekti pretendoi gjithashtu se edhe saktësia e deklarimit lidhet me plotësimin e deklaratës së dorëzuar nga ana e tij si subjekt, në referim të përcaktimeve kushtetuese dhe atyre të

²⁵ Shih paragrafin 83, më sipër në këtë vendim.

ligjit nr. 84/2016 dhe jo me saktësinë e deklaratave të dorëzuara si subjekt pranë ILDKPKI-së, në referim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar.

93. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues fillimisht konstatoi se ky shkak ankimi nuk është relevant për zgjidhjen e çështjes, duke qenë se Komisioni nuk e ka vlerësuar konkluzionin e arritur për deklarim të pasaktë të kësaj pasurie, si shkak për konkluzionin përfundimtar për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Pavarësisht kësaj, trupi gjykues çmoi se Komisioni duhet të kishte qenë më i qartë në konkluzionin e tij lidhur me këtë pasuri (e cila nuk ndodhet në pronësi të subjektit të rivlerësimit që nga viti 2006) dhe të shprehte në mënyrë të qartë se pasaktësia në deklarim lidhej me deklaratën periodike të vitit 2005, duke qartësuar se subjekti nuk ndodhej në kushtet e deklarimit të pasaktë të kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë *vetting*, e cila është objekt kontrolli në kuadër të këtij procesi dhe, si pasojë e saktësisë dhe plotësisë së deklaratimeve të kryera në të, do të vlerësohet nëse subjekti ka përmbushur ose jo detyrimin Kushtetues të përcaktuar në nenin D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës.
94. *Lidhur me shqyrtimin e shkakut të ankimit mbi shpenzimet e mobilimit për apartamentet e blera në Bremen, Gjermani*, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.
95. Në përfundim të procesit të rivlerësimit lidhur me çështjen e shpenzimeve të mobilimit të banesave të subjektit të rivlerësimit në Bremen, Gjermani, Komisioni është shprehur në vendim: *Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shpenzimet e kryera për mobilimin e këtyre dy apartamenteve, blerë në Bremen, Gjermani, duke u përpjekur të fshehtë këto shpenzime, të cilat duhet të ishin pjesë e kontrollit të pasurisë, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga pikat 1 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nga germat "a" dhe "ç" të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.*
96. Në ankimin e tij, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit lidhur me çështjen e mobilimit të apartamenteve të blera në Bremen dhe vlerës përkatëse, me pretendimin se nuk ka kryer ndonjë përpjekje për të fshehur ndonjë shpenzim lidhur me mobilimin e apartamenteve të ndodhura në Bremen dhe se ky përfundim nuk rezulton të jetë arritur si rezultat i rivlerësimit të fakteve, në përputhje me provat e paraqitura prej tij gjatë hetimit administrativ.
97. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se banesat kanë qenë të mobiluara. Sipas tij, pavarësisht detyrimit që kishte pala shitëse për ta dorëzuar banesën bosh, për shkak se kjo procedurë do të kishte shpenzime shtesë për shitësin, shtuar faktin që mobilimi ishte në gjendje të mirë dhe për më tepër që banesa ishte e dhënë me qira dhe heqja e mobilimit do të cenonte marrëdhënien e qirasë, palët kishin rënë dakord që të mos hiqej mobilimi. Subjekti prapësoi se fakti që ai ka deklaruar qëndrimin në banesën e blerë në datat 28.12.2016 - 03.01.2017, 01.05.2017 - 04.05.2017 dhe 25.11.2017 - 29.11.2017, nuk passjell përfundimin e Komisionit se banesa ishte bosh.
98. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues konstatoi se Komisioni ka arritur në përfundimin e mësipërm lidhur me ekzistencën e shpenzimeve të mobilimit, vetëm mbi bazën e analizimit të kontratave të shitblerjeve të dy apartamenteve, duke iu referuar shprehimisht përcaktimit në nenin II të secilës prej tyre (kontratat shihen të kenë të njëjtën strukturë dhe

parashikime të njëjta për rrethana faktike të njëjta), në të cilin është përcaktuar se: *Pjesë e shitjes nuk janë aksesorë apo sende të tjera të lëvizshme, sidomos ndonjë kuzhinë e instaluar apo mobilie të tjera* – si dhe duke e ballafaquar këtë përcaktim kontraktual me përcaktimin e kontratës së qirasë. Sipas kontratës së qirasë me z. H. A. për apartamentin e blerë në vitin 2015, në nenin 1, “Objekti i qirasë”, përcaktohet: *Qiradhënësi i jep me qira qiramarrësit për qëllime banimi, banesën (nr. 1), e ndodhur në {***} Bremen, në katin {***} (djathtas e përbërë nga 3 dhoma, kuzhinë, korridor, banjë/WC, tarracë, të mobiluar plotësisht (shiko listën bashkëngjitur) [...]. Gjithashtu, në nenin 17, “Marrëveshje individuale”, është përcaktuar: *Në banesën e marrë me qira, të gjitha mobiliet dhe pajisjet shtëpiake duhen trajtuar me kujdes. Kuzhina është e re, prandaj ajo ka një garanci dyvjeçare pranë {***}. Banesa është e restauruar dhe e sapolyer, kështu që qiramarrësi do ta dorëzojë atë në të njëjtën gjendje.**

99. Në kontratën e qirasë të lidhur me çiftin N., për apartamentin e blerë në vitin 2016, në nenin 1, “Objekti i qirasë”, përcaktohet: *Qiradhënësi i jep me qira qiramarrësit për qëllime banimi, apartamentin (nr. 6), të ndodhur në ndërtesën {***} në Bremen {***} (Adresa), në katin e {***}-të (majtas), i përbërë nga 3 dhoma, kuzhina, dhoma e ndenjjes, banjë/WC, (bodrum, ballkon, tarracë, 1 vend parkimi) [...]. Në nenin 17, “Marrëveshjet individuale”, përcaktohet se nuk ka asnjë marrëveshje të tillë me përjashtim të asaj nga fillimi i marrëdhënies së qirasë. Trupi gjykues konstatoi se në nenin 4, “Kohëzgjatja e qirasë”, ishte parashikuar se kjo kontratë qiraje, e cila ishte lidhur më datë 31.12.2017, fillonte efektet më datë 01.01.2018 dhe se gjithashtu ishte vazhdim i marrëdhënies së qirasë midis pronarëve të vjetër të apartamentit dhe qiramarrësve, dhe se do të vazhdonte për një periudhë kohe të pacaktuar. Ky fakt konfirmohet edhe nga parashikimi i nenit 4, “Posedimi, përdorimi, barrat”, të kontratës së shitblerjes së këtij apartamenti nga subjekti, në të cilin është parashikuar: *Objekti i blerjes është dhënë me qira pa bërë njoftim; [...] Ditën e transferimit të posedimit, shitësi ia transferon të gjitha të drejtat që burojnë nga kontrata, blerësit të shënuar në kontratë dhe çlirohet nga detyrimet e tij. [...] shitësi duhet të dorëzojë menjëherë një kopje, nga dita e referimit, të origjinalit të kontratës së qirasë, si dhe garancitë e dhëna nga qiramarrësi (kaucioni, garancia).**
100. Në analizë të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues vlerëson se me të drejtë, subjekti i rivlerësimit pretendon se apartamenti i blerë në vitin 2016, ka qenë i dhënë me qira dhe marrëdhënia e qirasë nuk është ndërprerë. Për rrjedhojë, në interpretim logjik të fakteve të sipërcituara, trupi gjykues e vlerëson të besueshëm pretendimin e subjektit të rivlerësimit se nuk ka qenë e nevojshme të kryejë mobilimin e këtij apartamenti, i cili provohet të ketë qenë në gjendje të banueshme, si pasojë e zbatimit të marrëdhënies së qirasë, qoftë me mobilim të kryer nga ish-pronarët e apartamentit apo me mobilim të kryer nga qiramarrësit.
101. Ndërsa, sa i takon apartamentit të blerë në vitin 2015 dhe të dhënë me qira z. A., trupi gjykues konstatoi se lidhur me këtë apartament, janë kryer punime restaurimi, si: vendosje profilesh gipsi, suvatime, vendosje laminati, lysterje etj., të cilat, referuar faturës së lëshuar nga kompania sipërmarrëse {***} për subjektin e rivlerësimit, rezultojnë të jenë kryer gjatë periudhës 27.03.2017 – 12.12.2017, ndërkohë që referuar parashikimit të nenit 17 të kontratës së qirasë së lidhur më datë 15.10.2016, mbi të cilën ka bazuar arsyetimin e tij Komisioni, banesa përshkruhet *e restauruar*

dhe e sapolyer. Në këtë kontekst, trupi gjykues i çmon faktet dhe rrethanat e sipërcituara të pamjaftueshme për t'u ngritur në nivelin e një dyshimi të arsyeshëm mbi ekzistencën e shpenzimeve të mobilimit për apartamentin e blerë në vitin 2015, të cilat nuk janë deklaruar në DIPPV-në e vitit 2016, me qëllim arritjen në konkluzionin se subjekti është përpjekur t'i fshehë shpenzimet e mobilimit, për sa kohë gjatë hetimit të kryer, nuk ka rezultuar asnjë e dhënë tjetër në formën e pagesave të kryera apo transfertave monetare me jashtë.

- 102.** Në arritjen e një konkluzioni të ndryshëm nga Komisioni lidhur me shpenzimet e mobilimit, trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe faktin se deklarimi i këtyre shpenzimeve përbën detyrim ligjor në kuadër të parashikimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, vetëm nëse kalohet vlera limit prej 300.000 lekësh, dhe kjo sa u takon deklarimeve periodike, ndërkohë që lidhur me deklaratën e pasurisë *vetting*, subjektet nuk mbartin detyrim ligjor për deklarimin e shpenzimeve të asnjë lloji. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjen të pabazuar në fakte konkluzionin e Komisionit se subjekti është përpjekur t'i fshehë shpenzimet e mobilimit të apartamenteve në Bremen, Gjermani, dhe se, edhe në eventualitetin e konstatimit të shpenzimeve të kësaj natyre, subjekti do të ngarkohej me përgjegjësinë e mosdeklarimit të tyre në deklaratën përkatëse periodike nëse vlera e tyre do të kalonte limitin e përcaktuar për shpenzimet e deklarueshme, ndërsa në kontekstin e procesit të rivlerësimit, efekti që do të passillte kjo situatë faktike, do të vlerësohej vetëm në kuptim të rezultatit të analizës financiare të vitit 2016 dhe vlerësimit të mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të mbuluar shpenzime shtesë të këtij lloji, pa u shtrirë ky vlerësim në vitet në vijim: 2017, 2018 dhe 2019, të cilat janë jashtë periudhës së vlerësimit dhe tejkalojnë objektin e procesit të rivlerësimit, i cili lidhet me verifikimin e saktësisë, vërtetësisë dhe plotësisë së deklaratës së pasurisë *vetting*, si dhe me kontrollin e ligjshmërisë së burimeve të krijimit të pasurive objekt kontrolli sipas kësaj deklarate.
- 103.** *Në lidhje me shpenzimet e jetesës*, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të padrejta dhe të pabazuara përlllogaritjet e kryera nga Komisioni lidhur me përcaktimin e tyre për njësinë ekonomiko-familjare të subjektit të rivlerësimit. Këtë shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit e mbështeti në pretendimin se vlerat e përcaktuara nga Komisioni si shpenzime jetese për vitet 2014, 2015 dhe 2016, nuk bazohen në të dhënat e INSTAT-it, pasi paraqiten të ndryshme me to, me efekt rëndimin e bilancit ekonomik të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të. Subjekti pretendoi gjithashtu se Komisioni nuk ka bërë transparencë lidhur me elementet përbërëse të shpenzimeve jetike dhe përqindjeve që zënë ato, si dhe nuk ka marrë parasysh pretendimet e subjektit të rivlerësimit për zbritje të disa kategorive të shpenzimeve, si: shpenzime telefonike, të mobilimit, të udhëtimit dhe fjetjes, si dhe shpenzime të ushqimit, të cilat ndonëse janë përlllogaritur veçmas, janë të përfshira edhe në shpenzimet e jetesës sipas INSTAT-it, duke rënduar në mënyrë të padrejtë analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të.
- 104.** Në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve të mësipërme të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, pasi verifikoi nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, vlerat e përlllogaritura nga ana e Komisionit lidhur me këtë zë të shpenzimeve të përfshirë në analizën financiare për vitet e kundërshtuara, konstatoi se përlllogaritjet e Komisionit janë të sakta dhe në përputhje me metodologjinë e ndjekur nga Kolegji (referuar të dhënave të konsumit për frymë dhe familjarë sipas INSTAT-it, të përcjellë

nga ILDKPKI-ja). Pretendimet e subjektit të rivlerësimit për vlera të shpenzimeve të jetesës në shumat: 69.442 lekë/muaj ose 833.304 lekë/vit për vitin 2014, 70.766 lekë/muaj ose 849.192 lekë/vit për vitin 2015 dhe 73.143 lekë/muaj ose 877.716 lekë/vit për vitin 2016, u gjetën të pabazuara në fakte, pasi rezultoi se këto vlera shpenzimesh jetese sipas Anketës së Buxhetit të Familjes për vitet e sipërcituara, referuar faqes zyrtare të INSTAT-it, u përkasin shpenzimeve mujore për konsum të një njësie ekonomike familjare me përbërje prej 3,8 personash. Ndërkohë që për një familje me përbërje familjare prej 4 personash (si në rastin e subjektit të rivlerësimit), shpenzimet e jetesës përlllogariten në vlerë mujore dhe vjetore, përkatësisht: 73.332 lekë/muaj dhe 879.984 lekë/vit për vitin 2014, 74.760 lekë/muaj dhe 897.104 lekë/vit për vitin 2015 dhe 78.864 lekë/muaj dhe 940.368 lekë/vit për vitin 2016. Këto shifra rezultuan të njëjta me vlerat e përlllogaritura si shpenzimeve jetese në këto vite nga Komisioni.

105. Sa i takon pretendimit të subjektit në drejtim të mungesës së transparencës së Komisionit lidhur me komponentët e shpenzimeve jetike dhe përqindjeve që zënë ato, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit, konstatoi se bashkëlidhur “Rezultateve të hetimit kryesisht”, Komisioni i ka përcjellë subjektit të rivlerësimit edhe Aneksin 02, “Metodika e analizës financiare”. Referuar përmbajtjes së këtij aneksi, konstatohet se në pjesën që trajtohen shpenzimet, Komisioni është shprehur: *Shpenzimet jetike janë përlllogaritur: (i) 66% e të ardhurave për 1994 – 1999; (ii) bazuar në shkresën e ILDKPKI-së me nr. {***}, datë 04.03.2019, për periudhën 2000-2016²⁶; dhe (iii) bazuar në faqen zyrtare online të INSTAT-it për vitet 2017 dhe 2018.* Referuar sa më sipër, trupi gjykues konstaton se sa i takon metodologjisë së përdorur, Komisioni ka zbatuar standardin tashmë të konsoliduar në kryerjen e analizës financiare për periudhën e vlerësimit 2003-2016 dhe se nëpërmjet zbatimit të vlerave të përcaktuara sipas shkresës së ILDKPKI-së, me nr. {***} prot., datë 04.03.2019, nuk mund të arrihet në konkluzionin se Komisioni ka treguar mungesë transparence, për më tepër kur kjo shkresë i është bërë me dije edhe subjektit të rivlerësimit, i cili kishte mundësi të kërkonte informacion më të detajuar pranë ILDKPKI-së, në përcaktimin e këtyre vlerave.
106. Në lidhje me pretendimin e subjektit se si pjesë përbërëse e shpenzimeve jetike, rezulton të jenë edhe zërat “shpenzimet e mobilimit, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje banese”, “ushqimi dhe pijet alkoolike”, “restorante dhe hotele”, “shpenzime komunikimi/telefonike”, të cilat, sipas tij, janë përlllogaritur nga ana e Komisionit si zëra më vete dhe, për rrjedhojë, këto shpenzime duhet t’i zbriten nga shpenzimet jetike të përlllogaritura nga Komisioni, trupi gjykues e gjeti të pabazuar këtë pretendim të subjektit dhe në kundërshtim me standardin e ndjekur nga institucionet e rivlerësimit, sipas të cilit, shpenzimet e përlllogaritura përfaqësojnë vlerën e një konsumi vjetor mesatar, të kryer nga familjet me nivele të ndryshme të ardhurash, dhe se pesha e shpenzimeve të shtuara në momente kohore të caktuara, nuk mund të shërbejë si mekanizëm për reduktimin/zvogëlimin e vlerës së shpenzimeve të pritshme për t’u kryer gjatë vitit, të

²⁶ Në mungesë të të dhënave për vitin 2001, u konsiderua vlera e vitit paraardhës (108.000 lekë/vit për person), ndërsa vlera për vitin 2007 është saktësuar sipas shkresës nr. {***}, datë 27.5.2008, të INSTAT-it, drejtuar ILDKPKI-së (174.072 lekë/vit për person).

përlllogaritura sipas metodave statistikore dhe ligjit të probabilitetit, por veçse të shtojë vlerën e shpenzimeve të kryera (duke ndikuar në standardin e jetesës së subjekteve).

107. Në përfundim të analizës së kryer mbi shqyrtimin e shkaqeve të ankimit mbi vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupit gjykues, në vijim të konkluzioneve të arritura më sipër në këtë vendim, lidhur me çështjet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit, pasi reflektoi këto konkluzione në zërat e analizës së Komisionit të kryer për periudhën e vlerësimit 2002 - 2016, mbi bazën e shkaqeve të ankimit, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të i rezultuan me mungesë të të ardhurave të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera në vitet 2011, 2013, 2015 dhe 2016, përkatësisht në shumën -420.648 lekë për vitin 2011, në shumën -548.500 lekë (ekuivalenti 3.993 euro) për vitin 2013, në shumën -672.213 lekë për vitin 2015 dhe në shumën -197.494 lekë (ekuivalenti 1.460 euro), si dhe -689.950 lekë për vitin 2016, pra në total, për gjithë periudhën e vlerësimit, në shumën -2.528.805 lekë.
108. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit, në kuptim të nenit 59, pika 1, shkronja “a”, vlerësohet se nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të, pasi ka kryer deklarim të pamjaftueshëm për pasurinë, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b”.

D. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

109. Lidhur me shkakun e ankimit për kundërshtimin si abuziv të konkluzionit të Komisionit sa i takon vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, trupi gjykues konstatoi si vijon.
110. Komisioni, në lidhje me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, është shprehur në vendim: *Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka demonstruar mangësi të theksuara në mënyrë të përsëritur në një numër të konsiderueshëm çështjesh në aftësitë e tij organizative, duke u gjendur në parashikimet e nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, i cili parashikon se: [...]. Këto konkluzione, duke qenë se lidhen me kriteret e vlerësimit të magjistratëve, sipas dispozitave të ligjit nr. 96/2016, kritere mbi të cilat bazohet Komisioni për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, sipas parashikimit të pikës 1 të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, të vlerësuara në harmoni me njëra-tjetrën, e çojnë Komisionin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, për shkak të këtyre mangësive në indikatorët e kriterit të aftësisë profesionale, sipas parashikimeve të pikës 4 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “c” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, gjatë ushtrimit të profesionit, ka sjellë shkelje të të drejtave të palëve në proceset gjyqësore të trajtuara prej tij, në nivel të tillë që shihen të pamundura të riparohen nëpërmjet programit trajnuar në Shkollën e Magjistraturës. Për të gjitha sa arsyetohet më lart, subjekti konsiderohet se është i papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës së gjyqtarit dhe se ndaj tij duhet të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, sipas parashikimit të pikës 4 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Në vlerësimin tërësor, në kuptim të nenit 4, paragrafi 2 i ligjit nr. 84/2016, të kriterit të kontrollit të pasurisë e kontrollit të aftësive profesionale, Komisioni arrin në përfundimin se problematikat e konstatuara në vlerësimin e pasurisë në lidhje me transaksione financiare shumë të diskutueshme dhe paaftësia profesionale për të kryer detyrat e tij brenda një*

standardi të pritshëm, krijojnë dyshimin e arsyeshëm te çdo qytetar se gjyqtari me sjelljet e tij, ka vendosur interesin personal mbi atë të shoqërisë/publikut dhe sundimit të paanshëm të ligjit, duke cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, dhe duke bërë që subjekti të ndodhet në kushtet e pamundësisë për të plotësuar këto mangësi nëpërmjet programit të trajnimit, i gjendur në kushte të parashikimeve të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

111. Subjekti i rivlerësimit, shkakun e ngritur në ankimin e tij për kundërshtimin si abuziv të konkluzionit të Komisionit lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, e mbështeti në pretendimin se ai nuk përputhet me vetë konstatimet e Komisionit, me parashikimet kushtetuese dhe ato ligjore, si dhe është një konkluzion i arritur në cenim të parimit të paanshësisë, objektivitetit dhe proporcionalitetit. Në zëbrthim të sa më sipër, subjekti parashitroi:

111.1. Konstatimi i Komisionit për zvarritje të proceseve gjyqësore dhe seanca joproductive, është një konstatim i përgjithshëm. Proceset në fjalë nuk janë analizuar me qëllim arritjen në përfundimin nëse shkakun i shtyrjeve rezulton të ketë ardhur për fajin e subjektit apo si pasojë e rrethanave objektive.

111.2. Afati 6-mujor i cituar nga ana e Komisionit, nuk është një afat prekluziv, por është thjesht një afat orientues i caktuar nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, si dhe se ky i fundit, në përcaktimin e këtyre afateve, ka pasur parasysh një ngarkesë normale në punë. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se konstatimet e Komisionit lidhur me afatin 6-mujor, janë ligjërish të pabazuara dhe rrjedhojë e pamjaftueshmërisë profesionale të anëtarëve të trupit gjykues në identifikimin e nocionit të afatit të arsyeshëm të referuar prej tij në vendimin objekt ankimi. Këtë pretendim, subjekti i rivlerësimit u shpreh se e mbështet edhe në parashikimin ligjor të nenit 399/2 të Kodit të Procedurës Civile.

111.3. Në arritjen e një përfundimi nëse konstatimet e Komisionit lidhur me çështjen e tejkallimit të afateve duhet të konsiderohen apo jo shkelje, subjekti shprehet se Komisioni duhet t'u ishte referuar përfundimeve të arritura nga ana e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimet nr. 5, datë 12.12.2013 dhe nr. 4, datë 13.10.2014. Subjekti pretendoi se referuar qëndrimit të Kolegjeve të Bashkuara në këto vendime, Komisioni nuk ka mbajtur në konsideratë shkaqe për të cilat vonesat e krijuara nuk vlerësohen të pajustificuara, të tilla si ngarkesa tej kufijve të arsyeshëm (subjekti referoi se vetë Komisioni në vendim referon se ngarkesa e subjektit të rivlerësimit për periudhën 2014-2016, ka qenë 1450 çështje për gjykim, nga të cilat ai ka përfunduar 1279 çështje), natyra komplekse e çështjeve, cilësia e vendimmarrjes (arsyetimit), vonesat për shkaqe të natyrës administrative, si dhe, sipas subjektit të rivlerësimit, nuk rezulton që Komisioni të ketë përcaktuar nëse ka ardhur apo jo ndonjë pasojë konkrete nga vonesa e arsyetimit të vendimeve, sikurse përcakton edhe vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

111.4. Në mungesë të parashikimeve ligjore lidhur me përkufizimin e nocionit të shkeljes që diskrediton rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni do duhet t'i ishte referuar përkufizimit të dhënë lidhur me sa më sipër nga Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 75, datë 19.04.2002.

111.5. Subjekti pretendoi gjithashtu se Komisioni ka kryer shkelje të rëndë të ligjit teksa ka shtrirë hetimin përtej periudhës 3-vjeçare lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale të përcaktuar në ligj, duke marrë në këtë mënyrë atributet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Për më tepër, subjekti argumentoi se Komisioni nuk ka analizuar faktin nëse çështja e vonesave në arsyetim përbën një fenomen individual apo kolektiv.

112. Në kuadër të shqyrtimit të shkakut të ankimit lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të çështjes, si dhe arsyetimin e Komisionit në vendim lidhur me vlerësimin e këtij kriteri të rivlerësimit, konstatoi se problematikat e evidentuara në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, kanë lidhje me kriterin e aftësive organizative, sipas përcaktimit të tij në nenin 74 të ligjit nr. 96/2016. Nga verifikimi i akteve të dosjeve gjyqësore lidhur me çështjet për të cilat subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, janë evidentuar nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe konfirmuar nga ana e Komisionit në dokumentin e rezultateve të hetimit administrativ, gjetjet në vijim.

112.1. Dokumenti²⁷ nr. 1 – Vendimi nr. {***}, datë 23.12.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lidhur me padinë me objekt: “Konstatimi i zgjidhjes së kontratës/marrëdhënies së punës me efekt të menjëhershëm, pa shkaqe të justifikuara dhe dëmshpërblimin për zgjidhjen e saj”. Çështja është gjykuar në seancë gjyqësore publike, me trup gjykues të përbërë vetëm nga subjekti i rivlerësimit. Seanca është zhvilluar më datë 23.12.2014 dhe vendimi është dhënë në datën 23.12.2014. Në përfundim, është vendosur rrëzimi i kërkesëpadisë. Nga aktet, evidentohet se vendimi nuk është ankimuar dhe ka marrë formë të prerë në datën 07.01.2015. Çështja është regjistruar për gjykim në datën 20.05.2014 dhe vendimi është dhënë në datën 23.12.2014. Gjykimi ka zgjatur për një periudhë prej 7 muajsh e 3 ditësh, e cila është jashtë afatit 6-mujor, të caktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

112.2. Dokumenti nr. 2 – Vendimi nr. {***}, datë 20.05.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lidhur me padinë me objekt: “Përmbushjen e detyrimit që rrjedh nga deklarata noteriale për kalimin në pronësi të apartamentit etj.”. Çështja është gjykuar në seancë gjyqësore publike, me trup gjykues të përbërë vetëm nga subjekti i rivlerësimit. Seanca është zhvilluar në datën 20.05.2015 dhe vendimi është dhënë në datën 20.05.2015. Në përfundim, është vendosur rrëzimi i kërkesëpadisë. Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit. Çështja është regjistruar për gjykim në datën 15.01.2015 dhe vendimi është dhënë në datën 20.05.2015. Gjykimi ka zgjatur për një periudhë prej 4 muajsh e 5 ditësh, e cila është brenda afatit 6-mujor të caktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

112.3. Dokumenti nr. 3 – Vendimi nr. {***}, datë 07.03.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lidhur me padinë me objekt: “Konstatimin absolutisht të pavlefshëm të kontratës së dhurimit të pasurisë së paluajtshme, duke e njohur bashkëpronare me 1/6 pjesë mbi pasurinë”.

²⁷ Me termin “Dokument”, u referohemi dokumenteve të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, sipas parashikimit të nenit 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

Çështja është gjykuar në seancë gjyqësore publike, me trup gjykues të përbërë vetëm nga subjekti i rivlerësimit. Seanca është zhvilluar në datën 07.03.2016 dhe vendimi është dhënë në datën 07.03.2016. Në përfundim, është vendosur rrëzimi i kërkesëpadsisë. Nga aktet, evidentohet se vendimi nuk është ankimuar dhe ka marrë formë të prerë në datën 06.04.2016. Çështja është regjistruar për gjykim në datën 20.11.2015 dhe vendimi është dhënë në datën 07.03.2016. Gjykimi ka zgjatur për një periudhë prej 3 muajsh e 15 ditësh, e cila është brenda afatit 6-mujor të caktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

112.4. Dosja²⁸ nr. 1 – Çështja civile nr. {***} regj., datë 05.10.2015, që i përket padsisë me objekt: “Detyrimin e të paditurit të paguajë shumën 30470 lekë, si detyrim i papaguar nga shërbimi telefonik fiks”, e përfunduar me vendimin nr. {***}, datë 09.06.2016. Çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë më datë 05.10.2015. Më datë 06.10.2015, i është caktuar subjektit të rivlerësimit Neritan Cena, i cili me vendimin e datës 19.10.2015 (pas 3 ditëve nga shorti), ka caktuar seancën përgatitore më 09.11.2015, ora 13:00, bazuar në nenin 158/a të KPrC. Gjykata, më datë 09.06.2016, ka vendosur pranimin e padsisë. Nga të dhënat, nuk rezulton të jetë paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit apo rekurs në Gjykatën e Lartë. Nga aktet e paraqitura nga gjykata, fletë regjistri nga numërori i vendimeve, rezulton se dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsyetuar, është dorëzuar në datën 14.06.2016 nga gjyqtari – pas 5 ditëve nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10-ditor të përcaktuar nga neni 308/2 i KPrC. Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Neritan Cena ka zgjatur gjithsej 8 muaj e 3 ditë, në intervalin kohor 06.10.2015 – 09.06.2016, i cili është jashtë afatit 6-mujor të caktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. [...] Janë caktuar 8 seanca (3 përgatitore dhe 5 gjyqësore), nga të cilat 6 seanca kanë qenë joproduktive. Shkak për dështimin e seancave ka qenë kërkesa për shtyrje e përfaqësuesit të palës paditëse, pasi ndodhej në gjykim tjetër (2 seanca), njoftimi me shpallje për shkak se nga shërbimi postar është bërë shënimi “larguar në Gjermani” (1 seancë), njoftimi me fletëthirrje pasi nga shërbimi postar është konfirmuar “refuzuar” (1 seancë), përsëritja e njoftimit me shpallje të të paditurit për shkak të mangësisë së konstatuar në afishimin e shpalljes dhe paraqitjen e pasaktë të palëve ndërgjyqëse (2 seanca). Çështja është vënë në lëvizje pa vonesë, 3 ditë nga shorti, dhe datat e seancave janë caktuar në intervale kohore të arsyeshme në raport me shkakun (njoftim me shpallje të palës së paditur), për të cilin janë shtyrë.

112.5. Dosja nr. 2 – Çështja civile nr. {***} regj., datë 17.02.2015, që i përket padsisë me objekt: “Pavlefshmëri e titullit ekzekutiv që u përket faturave të energjisë elektrike për periudhën dhjetor 2014 – janar 2015. Zgjidhje e pasojave ku OSHEE të zbresë të gjithë energjinë e mbifaturuar, të pakonsumuar nga paditësi, sipas faturave për të cilën kundërshtohet titulli ekzekutiv”, e përfunduar me vendimin nr. {***}, datë 05.10.2015. Çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë më 17.02.2015. Më datë 18.03.2015 i është caktuar subjektit të rivlerësimit Neritan Cena, i cili me vendimin e datës 23.03.2015 (pas 5 ditëve nga shorti), ka caktuar seancën përgatitore më datë 16.04.2015, ora 14:30, bazuar në nenin 158/a të KPrC. Gjykata, më datë 05.10.2015, ka vendosur pranimin e pjeshëm të padsisë. Vendimi është ankimuar dhe Gjykata e Apelit Tiranë ka

²⁸ Me termin “Dosja”, u referohemi dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, sipas parashikimit të nenit 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kundër këtij vendimi, është paraqitur rekurs nga pala e paditur dhe çështja ka qenë ende në gjykim në Gjykatën e Lartë në datën 14.01.2020, sipas raportit të KLGj-së. Nga aktet e paraqitura nga gjykata, rezulton se dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsyetuar, është dorëzuar në datën 23.10.2015 – pas 18 ditëve nga shpallja e vendimit, jashtë afatit 10-ditor të përcaktuar nga neni 308/2 i KPrC. Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Neritan Cena ka zgjatur gjithsej 6 muaj e 17 ditë, në intervalin kohor 18.03.2015 – 05.10.2015, i cili është jashtë afatit 6-mujor të caktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të sistemit të Vlerësimit. [...] Janë caktuar 9 seanca (1 përgatitore dhe 8 gjyqësore) nga të cilat 2 seanca kanë qenë joproductive. Shkak për dështimin e seancave kanë qenë kërkesat e palëve për shtyrje për t’u njohur me aktin e ekspertimit, si dhe për t’u njohur me aktin shtesë të ekspertimit (2 seanca). Çështja është vënë në lëvizje pa vonesë 5 ditë nga shorti dhe datat e seancave janë caktuar në intervale kohore të arsyeshme në raport me shkakun për të cilin janë shtyrë. Përrjashtim bën seanca 7 e cila është caktuar pas 2 muajve, pasi përfshihet dhe leja vjetore e muajit gusht. Seancat për konkluzionet përfundimtare të palëve e shpalljen e arsyetuar të vendimit janë caktuar brenda afatit 5 ditor referuar nenit 302 e 308/2 i KPrC.

112.6. Dosja nr. 3 – Çështja civile nr. {***} regj., datë 06.06.2013 regj., që i përket padisë me objekt: “Dëmshpërblim nga marrëdhëniet e punës”, e përfunduar me vendimin nr. {***}, datë 27.05.2014. Çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, më 06.06.2013. Më datë 07.06.2013, i është caktuar subjektit të rivlerësimit Neritan Cena, i cili me vendimin e datës 21.06.2013 (pas 14 ditëve nga shorti), ka caktuar seancën përgatitore më 23.07.2013, ora 14:00, bazuar në nenin 158/a të KPrC. Gjykata, më datë 27.05.2014, ka vendosur rrëzimin e padisë. Vendimi është ankimuar dhe Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kundër këtij vendimi, është paraqitur rekurs nga pala paditëse dhe çështja ka qenë ende në gjykim në Gjykatën e Lartë, në datën 17.01.2020, sipas raportit të KLGj-së. Nga aktet e paraqitura nga gjykata, rezulton se dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsyetuar, është dorëzuar në datën 30.05.2014 – pas 3 ditëve nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10-ditor të përcaktuar nga neni 308/2 i KPrC. Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Neritan Cena ka zgjatur gjithsej 11 muaj e 10 ditë, në intervalin kohor 07.06.2013 – 27.05.2014, i cili është jashtë afatit 6-mujor të caktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. [...] Janë caktuar 12 seanca (1 përgatitore dhe 11 gjyqësore), nga të cilat 5 seanca kanë qenë joproductive. Shkak për dështimin e seancave ka qenë kërkesa e palës së paditur për shtyrje për të paraqitur prapësimet e provat (1 seancë), mosparaqitja e provave në formën e duhur ligjore nga pala e paditur (1 seancë), kërkesa e përfaqësuesit të palës paditëse për t’u konsultuar me paditësin lidhur me provat e paraqitura (1 seancë), arsye shëndetësore e gjyqtarit (1 seancë), kërkesa për shtyrje e përfaqësuesve të palës së paditur, pasi ndodheshin në gjykime të tjera (1 seancë). Çështja është vënë në lëvizje 14 ditë nga shorti dhe 4 seancat e para janë caktuar në intervale të gjata kohore mbi 1 muaj (1 muaj e 2 ditë – 2 muaj e 21 ditë). Të gjitha seancat e tjera janë caktuar në intervale kohore të arsyeshme në raport me shkakun për të cilin janë shtyrë nga 7-29 ditë. Për seancën gjyqësore 2, e caktuar pas 2 muajve e 21 ditëve, duhet evidentuar se në këtë interval të gjatë, përfshihet dhe leja vjetore e gjyqtarëve, e muajit gusht. Seanca e shtyrë për konkluzionet përfundimtare të palëve, është caktuar brenda afatit 5-ditor, parashikuar nga neni 302 i KPrC-së,

ndërsa seanca për shpalljen e arsytuar të vendimit është caktuar jashtë afatit 5-ditor të parashikuar nga neni 308/2 i KPrC.

112.7. Dosja nr. 4 – Çështja civile nr. {***} regj., datë 17.06.2013, që i përket padisë me objekt: “Deklarimin e pavlefshmërisë pjesërisht të titullit ekzekutiv nr. {***} akti, datë 09.11.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kundërshtimin e veprimeve të përmbartimit dhe pezullimin e ekzekutimit të veprimeve përmbartimore”, e përfunduar me vendimin nr. {***}, datë 15.07.2014. Çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, më 17.06.2013. Më datë 18.06.2013, i është caktuar subjektit të rivlerësimit Neritan Cena, i cili me vendimin e datës 20.06.2013 (pas 2 ditëve nga shorti), ka caktuar seancën përgatitore më 27.07.2013, ora 14:15, bazuar në nenin 158/a të KPrC. Gjykata, më datë 15.07.2014, ka vendosur rrëzimin e padisë. Vendimi është ankimuar dhe Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kundër këtij vendimi, nuk rezulton të jetë paraqitur rekurs nga pala paditëse. Nga aktet e paraqitura nga gjykata, rezulton se dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsytuar, është dorëzuar në datën 22.07.2014 – pas 7 ditëve nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10-ditor të përcaktuar nga neni 308/2 i KPrC. Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Neritan Cena ka zgjatur gjithsej 1 vit e 27 ditë, në intervalin kohor 18.06.2013 – 15.07.2014, i cili është jashtë afatit 6-mujor të caktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit [...]. Janë caktuar 22 seanca (1 përgatitore dhe 21 gjyqësore), nga të cilat 13 seanca kanë qenë joproduktive. Shkak për dështimin e seancave kanë qenë kërkesat procedurale të palëve, si: kërkesë për shtyrje nga paditësi për të rregulluar ndërgjyqësinë, saktësimi i objektit të padisë (2 seanca), përfaqësuesit e palëve dhe ekspertit kërkojnë shtyrjen për shkak se ndodhen në gjykim tjetër (3 seanca), qenia e gjyqtarit në seminar (1 seancë), për shkak të detyrimit për të bërë parapagesën për aktin e ekspertimit nga paditësi (2 seanca), paditësi nuk mund të paraqitet për shkak të arsyeshëm e kërkon të jetë prezent, kërkon të njihet me aktin e ekspertimit (2 seanca), mosmarrja dijeni e përfaqësuesit të paditësit dhe ekspertit duke përsëritur njoftimet (2 seanca), si dhe ekspertja ka kërkuar kohë shtesë për të përgatitur aktin e ekspertimit (1 seancë). Seancat gjyqësore janë caktuar përgjithësisht në intervale kohore të arsyeshme në raport me shkakun për të cilin janë shtyrë, nga 6-28 ditë, me përjashtim të seancës gjyqësore 4, e caktuar pas 1 muaji e 20 ditësh, për të cilën duhet evidentuar se në këtë periudhë, përfshihet dhe leja vjetore e muajit gusht. Seanca e shtyrë për konkluzionet përfundimtare të palëve, është caktuar jashtë afatit 5-ditor, parashikuar nga neni 302 i KPrC-së²⁹. Gjithashtu, edhe seanca për shpalljen e arsytuar të vendimit, është caktuar jashtë afatit 5-ditor të parashikuar nga neni 308/2 i KPrC³⁰.

112.8. Dosja nr. 5 – Çështja penale (masë sigurimi) nr. {***}, datë 22.01.2016, që i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt: “Vleftësim arresti në flagrancë dhe caktim mase sigurimi ndaj të dyshuarit K.T. për veprën penale të vjedhjes së energjisë elektrike ose

²⁹ Në seancën e datës 02.07.2014, subjekti i rivlerësimit ka shtyrë seancën gjyqësore për në datën 08.07.2014, me qëllim për t'u dhënë kohë palëve të përgatisin konkluzionet me shkrim. Afati i caktuar tejkalon me 1 ditë afatin ligjor prej 5 ditësh, të përcaktuar nga neni 302 i KPrC-së.

³⁰ Në seancën e datës 08.07.2014, gjykata, pasi ka deklaruar të mbyllur shqyrtimin gjyqësor, për shkak të kompleksitetit të çështjes, ka vendosur të shpallë të arsytuar vendimin gjyqësor në datën 15.07.2014. Afati i caktuar tejkalon me 2 ditë afatin ligjor prej 5 ditësh, të përcaktuar nga neni 308 i KPrC-së.

impulseve telefonike, parashikuar nga neni 137/2 i Kodit Penal”, e përfunduar me vendimin nr. s’ka, datë 22.01.2016. Çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë më 21.01.2016 dhe i është caktuar subjektit të rivlerësimit Neritan Cena. Nga aktet e paraqitura, nuk rezulton vendim për caktimin e seancës gjyqësore, siç parashikon neni 258/2 i Kodit të Procedurës Penale, si dhe as akte të njoftimit të palëve. Gjykata, më datë 22.01.2016, ka vendosur vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë dhe caktimin si masë sigurimi atë të [...]. Nga aktet, nuk rezulton që vendimi të jetë ankimuar. Nga aktet e paraqitura nga gjykata, rezulton se dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsyetuar, është dorëzuar nga gjyqtari në datën 22.01.2016 – ditën e shpalljes së vendimit, brenda afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale. Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Neritan Cena ka zgjatur gjithsej 1 ditë, në intervalin kohor 21.01.2016 – 22.01.2016, bazuar në nenin 259/5 të Kodit të Procedurës Penale. Kohëzgjatja e gjykimit mund të identifikohet me orë, siç kërkon neni 259/5 i Kodit të Procedurës Penale, pasi në procesverbal është shënuar ora e përfundimit të seancës, 11:40, si dhe nga aktet rezulton se çështja është regjistruar në datën 21.01.2016, ora 10:35. Evidentohet se gjykimi i çështjes ka përfunduar brenda 25 orëve, pra është shpallur brenda 48 orëve të ardhshme nga çasti në të cilin kërkesa e prokurorit është paraqitur në gjykatë, brenda afatit ligjor.

113. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, referuar gjetjeve të mësipërme nga verifikimi i çështjeve mbi bazën e të cilave duhet të vlerësohet subjekti i rivlerësimit për kriterin e aftësive profesionale, në përputhje kjo me parashikimet e nenit 42 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit gjyqtarët vlerësohen bazuar në burimet e parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve, trupi gjykues konstatoi se nga 8 çështje të vëzhguara, gjykimi nga subjekti i rivlerësimit për 5 prej tyre, ka tejkaluar standardin orientues të miratuar nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në lidhje me aspektin kohor për gjykimet e mosmarrëveshjeve civile të karakterit të përgjithshëm, të përcaktuar prej 6 muajsh. Ky afat vihet re të jetë tejkaluar me: (i) 1 muaj e 3 ditë në rastin e Dokumentit 1; (ii) 2 muaj e 3 ditë në rastin e Dosjes nr. 1; (iii) 17 ditë në rastin e Dosjes nr. 2; (iv) 5 muaj e 10 ditë në rastin e Dosjes nr. 3; dhe (v) 6 muaj e 27 ditë në rastin e Dosjes nr. 4. Gjatë periudhave të gjykimit të çështjes në lidhje me Dokumentin 1, Dosjen nr. 2, Dosjen nr. 3 dhe Dosjen nr. 4, është evidentuar edhe fakti se në këto periudha ka përkuar edhe periudha e lejes vjetore të gjyqtarëve, prej 1 muaji, duke bërë që praktikisht vetëm 3 çështje të jenë efektive në tejkalim të standardit orientues prej 6 muajsh (konkretisht Dosja nr. 1, Dosja nr. 3 dhe Dosja nr. 4). Referuar gjetjeve në drejtim të shkaqeve të shtyrjes se seancave gjyqësore për të gjitha çështjet e vëzhguara, rezultoi se në përgjithësi, seancat janë shtyrë për shkaqe të kërkesave procedurale të palëve ndërgjyqëse, ekspertëve dhe vetëm dy seanca kanë dështuar për shkaqe objektive që lidhen me subjektin e rivlerësimit (konkretisht, një rast për shkak të paafhtësisë për punë për shkak sëmundjeje, një rast si pasojë e pjesëmarrjes në seminar të subjektit të rivlerësimit – Dosja nr. 3 dhe Dosja nr. 4). Nga të dhënat e çështjeve të vëzhguara, nuk rezultoi asnjë vendim i zbardhur në vonesë. Gjithashtu, u konstatua se afatet ligjore në lidhje me seancat e shtyra për dhënien kohë palëve për përgatitjen e konkluzioneve me shkrim, janë respektuar, përveç një rasti ku vihet re që afati i përcaktuar në nenin 302 të Kodit të Procedurës Civile është shkelur me 1 ditë (shih Dosjen nr. 4). I njëjti konstatim vlen dhe në drejtim të respektimit të afatit ligjor për shpalljen e vendimit të arsyetuar, sipas përcaktimit në nenin 308/2 të Kodit të Procedurës Civile, përveç 2

rasteve ku këto afate janë shkelur respektivisht me 3 dhe 2 ditë (referoju gjetjeve lidhur me Dosjen nr. 3 dhe Dosjen nr. 4). Në asnjë rast nuk u konstatua që vonesat e evidentuara si më sipër, të kishin sjellë cenim të të drejtave të individëve të përfshirë si palë në gjykimet e marra në shqyrtim.

114. Në kuadër të analizës së gjetjeve të konstatuara nga vëzhgimi i çështjeve për efekt të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues çmoi se me të drejtë, subjekti i rivlerësimit pretendoi se afati 6-mujor i përcaktuar si një standard kohor në zgjatjen e gjykimeve civile, është një afat orientues dhe jo një afat ligjor. Referuar vendimit nr. 261/2, datë 14.04.2010, të (ish) Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Për sistemin e vlerësimit të Gjyqtarëve”, ky këshill, nëpërmjet këtij akti rregullator, për efekt të vlerësimit të gjyqtarëve, ka përcaktuar në nenin 5 të tij se në kuadër të vlerësimit të efektivitetit dhe produktivitetit të një gjyqtari, do të vlerësohet aftësia e këtij të fundit për të qenë efektiv në zgjidhjen e çështjeve që i janë caktuar për gjykim, në aspektin cilësor dhe atë sasior, vlerësuar kjo në raport me kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore, të përcaktuara nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, si dhe aftësia për të qenë produktiv në arsyetimin e dorëzimit të vendimeve, brenda afateve ligjore. Në këtë kuptim, në Aneksin 1 bashkëlidhur vendimit të sipërcituar, Këshilli ka përcaktuar kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore, ku gjendet me vlerë të evidentohet se:

- Në pikat 1, 3, 4, 5 dhe 6 të këtij aneksi, është përcaktuar përkatësisht:
 1. *Efektiviteti i gjyqtarit përftohet edhe nga vlerësimi i përmbushjes së standardeve orientuese në aspektin sasior, cilësor dhe kohor të veprimtarisë gjyqësore, standarde të cilat janë të rivlerësueshme.*
[...]
 3. *Standardi sasior i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari, brenda një viti kalendarik, të një ngarkese pune minimale si më poshtë: [...] e. Gjyqtari i shkallës së parë i dhomës civile, si relator, i seksionit të përgjithshëm, jo më pak se 120 gjykime çështjesh që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje mes palëve kundërshtare.*
 4. *Standardi cilësor i punës nënkupton cilësinë e gjykimeve të një gjyqtari, të dhëna brenda një viti kalendarik në raport me kontrollin gjyqësor të tyre, të realizuara nga gjykatat më të larta, ku numri i vendimeve të cenuara nuk duhet të kalojë masën e 30% të vendimeve të ankimuar.*
 5. *Standardi kohor i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari të gjykimeve brenda një afati kohor maksimal nga data e caktimit të gjyqtarit të çështjes si më poshtë: [...] e. Gjykimet e mosmarrëveshjeve civile të karakterit të përgjithshëm, jo më tej se 6 muaj.*
 6. *Për efekt të standardit kohor të punës, numri i çështjeve të gjykuara tej afateve maksimale, nuk duhet të kalojë 40% të numrit total të çështjeve të gjykuara nga gjyqtari gjatë vitit kalendarik.*

115. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se indikatorët e sipërcituar mund të çojnë në një vendimmarrje të drejtë sa i takon vlerësimit të efektivitetit dhe produktivitetit të një gjyqtari, vetëm nëse ato vlerësohen në kompleks, jo vetëm sa i takon aspektit kohor, por edhe atyre sasiorë dhe cilësorë. Gjithashtu, kuptohet se të dhënat në lidhje me standardin kohor, duhen interpretuar e vlerësuar edhe në raport me numrin e çështjeve të gjykuara në total gjatë vitit kalendarik të vlerësimit, si dhe se numri i çështjeve për të cilat nuk është përmbushur standardi kohor i gjatësisë

së gjykimit duhet të çmohet sipas raportit të përcaktuar në pikën 6 të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve, në lidhje me numrin total të çështjeve të gjykuara. Në këtë kuptim, trupi gjykues evidenton se gjetjet në drejtim të tejkalimit të afatit prej 6 muajsh, sipas përcaktimit në pikën 5, germa “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve, i cili përbën një afat orientues, nuk mund të prodhojnë efekt në drejtim të vlerësimit të efektivitetit dhe produktivitetit të një gjyqtari, nëse ato nuk merren në shqyrtim dhe vlerësohen në kompleks, në raport edhe me indikatorët e tjerë të përcaktuar sipas këtij sistemi vlerësimi. Në kuptim të sa më sipër, Komisioni, ndonëse ka evidentuar në vendim të dhëna lidhur me treguesin sasior – *Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, subjekti i rivlerësimit ka gjykuar gjithsej 1279 çështje gjyqësore, nga të cilat 1080 çështje civile (577 civile të përgjithshme, 2 tregtare dhe 501 civile të veçanta), si dhe 199 masa sigurimi. Bazuar në germën “e” të pikës 3 të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë, që është organizuar në dhomën civile, seksioni i përgjithshëm, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 120 gjykime çështjesh civile që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje me palë kundërshtare, pra, për 3 vjet jo më pak se 360 çështje. Sipas të dhënave statistikore, rezulton se gjyqtari Neritan Cena, për periudhën e rivlerësimit, ka gjykuar 577 çështje civile të përgjithshme me palë kundërshtare, 2 çështje tregtare. Rrjedhimisht, ngarkesa e tij sasimore ka qenë dukshëm mbi standardin minimal – sikundër në parashtrimin e gjetjeve nga vlerësimi i dokumenteve të përzgjedhura nga subjekti dhe atyre të përcaktuara sipas procedurës së shortit, ka konstatuar edhe të dhëna lidhur me standardin cilësor, në kuptim të rezultateve të kontrollit gjyqësor nga gjykatat më të larta të vendimeve të marra nga subjekti, nuk rezulton të ketë bërë ndonjë vlerësim të integruar të indikatorëve të vlerësimit të efektivitetit në drejtim të sa më sipër.*

116. Në vlerësim të pretendimit tjetër të subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka kryer shkelje të rëndë të ligjit teksa ka shtrirë hetimin lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale përtej periudhës 3-vjeçare të përcaktuar në ligj, duke marrë në këtë mënyrë atributet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit dhe procedurat e ndjekura nga Komisioni lidhur me vlerësimin e këtij kriteri, konstatoi si më poshtë.
117. Komisioni është shprehur në vendim: *Referuar në parashikimet e pikës 1 të nenit 42 të ligjit nr. 84/2016, për të kryer një vlerësim të plotë dhe të gjithanshëm, Komisioni administroi dhe analizoi të gjitha burimet e parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve. Komisioni kërkoi informacion pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor në lidhje me ankesat e paraqitura ndaj subjektit të rivlerësimit dhe masat disiplinore të marra ndaj tij, nga periudha 2006 e deri më sot). Në kuadër të sa më sipër referuar, rezultoi se Komisioni i është drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Ministrisë së Drejtësisë³¹, duke kërkuar: *Me qëllim realizimin e një procesi të plotë lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Neritan Cena, lutemi të na informoni nëse ka në dosjen personale të tij të dhëna statistikore, dokumente ligjore, vlerësime të eprorëve, të dhëna mbi ankesa ndaj këtij subjekti nga**

³¹ Me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 05.06.2020.

palë të treta për shkak të detyrës, apo vlerësime për masa disiplinore ndaj tij, që nga janari 2006 e deri më sot.

118. Në përgjigje të kësaj kërkesë, Ministria e Drejtësisë³² ka përcjellë informacion ku, ndër të tjera, është shprehur: [...] *Ju bëjmë me dije se për këtë subjekt, pranë Ministrisë së Drejtësisë, janë evidentuar të dhëna lidhur me raporte inspektimi dhe ankesa të depozituara nga palë të treta, e konkretisht: 1. Shkresa nr. {***} prot., datë 27.12.2013, e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me lëndë “Relacioni dhe dokumentacioni shoqërues lidhur me veprimtarinë e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Neritan Cena, për të gjykuar mbi mundësinë e iniciimit të procedimit disiplinor (bashkëlidhur materialet e inspektimit). 2. Njoftimi i gjyqtarit me shkresën nr. {***} prot., datë 15.03.2013, me lëndë “Mbi njoftimin e vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”. 3. Njoftimi i gjyqtarit nga Ministria e Drejtësisë me shkresën nr. {***} prot., datë 14.01.2014, me lëndë “Njoftim mbi konstatimet e verifikuara nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë”. 4. Observacioni i gjyqtarit Neritan Cena, protokolluar pranë nesh me nr. {***} prot., datë 23.01.2014 (bashkëlidhur aktet provuese). 5. Kërkesa e Ministrisë së Drejtësisë për procedim disiplinor të gjyqtarit Neritan Cena me nr. {***} prot., datë 21.10.2014. Në vijim, në këtë shkresë, janë evidentuar edhe 7 ankesa qytetarësh të depozituara pranë Ministrisë së Drejtësisë, të cilat, referuar datës së protokollimit të tyre, i takojnë periudhës 01.03.2017 - 16.09.2019, si dhe shkresat e Ministrisë së Drejtësisë për kthim përgjigjeje ankuesve lidhur me to.*
119. Në përgjigje të kërkesës së sipërcituar të Komisionit, Këshilli i Lartë Gjyqësor³³, ndër të tjera, është shprehur: *Lidhur me ankesat e paraqitura ndaj gjyqtarit Neritan Cena në periudhën 01.01.2006 deri më sot, bëjmë me dije se nga kërkimi në databazën e arkivit dhe nga kontrolli fizik i dosjeve, rezultojnë praktikat e mëposhtme: [...] (janë referuar gjithsej 24 ankesa të depozituara në intervalin kohor 21.08.2006 – 09.10.2017). Lidhur me vlerësimet për masa disiplinore për subjektin e rivlerësimit, ju bëjmë me dije se për gjyqtarin Neritan Cena, nga regjistri statistikor me të dhëna mbi procedimet disiplinore, rezulton që Ministria e Drejtësisë ka sjellë pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, një kërkesë për procedim disiplinor me nr. {***} prot., datë 21.10.2014 (protokolluar në KLD {***} prot., datë 21.10.2014) “Vërejtje me paralajmërim”. Kërkesa është shqyrtuar dhe është rrëzuar në mbledhjen e ish-këshillit të datës 04.02.2015 (për referim vendimi i ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 18, datë 04.20.2015).*
120. Gjithashtu, rezultoi se me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 30.06.2020, Komisioni i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke i kërkuar: [...] *kërkojmë që, në një kohë sa më të shpejtë, të na vini në dispozicion të gjitha vendimet e zbardhura me vonesë, dhënë nga subjekti i rivlerësimit Neritan Cena, ndërmjet tyre edhe kopjen e regjistrit themeltar [...]. Në vijim, me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 06.07.2020, Komisioni i është drejtuar sërish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke i kërkuar: i. Listën e të gjitha vendimeve gjyqësore, të dorëzuar në tejkalim të afateve të parashikuara nga legjislacioni procedural civil nga subjekti i rivlerësimit Neritan Cena, për të gjithë periudhën që ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në gjykatën tuaj. ii. Ngarkesën në*

³² Me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 23.06.2020.

³³ Me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 14.08.2020.

punë të gjyqtarit Neritan Cena për të gjithë periudhën që ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në gjykatën tuaj.

121. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresën nr. {***} prot., datë 13.07.2020, ka përcjellë tabelat për vendimmarrjet e dhëna (civile themeli) ku janë pasqyruar, përveç të tjerave, data e dorëzimit dhe afati i tij, për periudhën gjatë së cilës gjyqtari Neritan Cena ka ushtruar funksionin pranë kësaj gjykate, dhe konkretisht viti 2010 deri më 02.07.2020. Po ashtu bashkëlidhur janë përcjellë edhe tabelat e përgatitura për ngarkesën në punë të gjyqtarit për periudhën e ushtrimit të detyrës pranë kësaj gjykate, 2010-2020, të ndara për secilin vit dhe secilën kategori çështjesh, duke përfshirë përkatësisht çështjet e përfunduara dhe ato të papërfunduara, në përfundim të çdo viti kalendarik.
122. Në kuadër të vlerësimit të hapave të ndjekur nga Komisioni gjatë hetimit të kryer lidhur me këtë kriter si më sipër konstatuar, trupi gjykues çmoi të nevojshme marrjen në analizë edhe të kuadrit të zbatueshëm ligjor në drejtim të verifikimit të periudhës së vlerësimit dhe burimeve të përcaktuara nga ky legjislacion, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale të subjekteve të procesit të rivlerësimit kalimtar. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.
123. Në nenin 41 të ligjit nr. 84/2016, në pikën 3 të tij përcaktohet shprehimisht se periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, do të jetë 3 vitet e fundit të ushtrimit të detyrës nga hyrja në fuqi e ligjit. Pavarësisht këtij rregulli të përgjithshëm, legjislatori ka parashikuar edhe rastin përjashtimor, sipas së cilit: *Vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga 1 janari 2006 e në vazhdim, sipas informacionit që disponohet për etikën dhe aftësitë profesionale. Komisioni ose Kolegji i Apelimeve merr parasysh këto informacione nëse relatori i çështjes ose vëzhguesi ndërkombëtar i çmon si të domosdoshme për procesin e rivlerësimit.*
124. Gjykata Kushtetuese, në vendimin e saj nr. 2, datë 18.01.2017, lidhur me kontrollin e kushtetutshmërisë së dispozitave të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me parashikimin ligjor të pikës 4 të nenit 41, si më sipër cituar, ka arsyetuar: *Gjykata vëren se, sipas nenit 41/4 të ligjit: “Vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga 1 janari 2006 e në vazhdim, sipas informacionit që disponohet për etikën dhe aftësitë profesionale. Komisioni ose Kolegji i Apelimeve merr parasysh këto informacione nëse relatori i çështjes ose vëzhguesi ndërkombëtar i çmon si të domosdoshme për procesin e rivlerësimit”. Gjykata vlerëson se, si rregull, bazuar në pikën 3 të nenit 41 të ligjit, periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale do të jetë 3 vjetët e fundit të ushtrimit të detyrës. Megjithatë, edhe pse ky nen, në pikën 4 ka parashikuar shtrirjen e këtij vlerësimi për një periudhë më të gjatë kohore, e cila potencialisht mund të jetë edhe mbi 10 vjet, kjo dispozitë duhet të zbatohet vetëm në raste përjashtimore dhe në bazë të një vendimi të marrë gjithashtu nga organet e reja kushtetuese të rivlerësimit. Po ashtu, sipas kësaj dispozite, edhe në raste të tilla informacionet merren parasysh nëse relatori i çështjes ose vëzhguesi ndërkombëtar i çmon si të domosdoshme për procesin e rivlerësimit. Duke zbatuar edhe në këtë rast interpretimin pajtues të normës, gjykata vlerëson se kjo është mënyra se si duhet të interpretohet pika 4 e nenit 41 të ligjit nr. 84/2016 nën dritën e standardeve kushtetuese dhe se një interpretim i ndryshëm i saj mund të bëhet shkak edhe për trajtimin e pabarabartë të subjekteve të rivlerësimit.*

125. Komisioni në këtë rast, në hetimin e kryer lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, duket të ketë zbatuar parashikimin e pikës 4 të nenit 41 të ligjit nr. 84/2016, si më sipër cituar, ndonëse referuar akteve të fashikullit, trupi gjykues nuk konstatoi ekzistencën e asnjë vendimmarrjeje të Komisionit (trupit gjykues të çështjes) në këtë drejtim, sikundër as ndonjë akt sipas të cilit të konstatohej vlerësimi i domosdoshmërisë për shtrirjen e periudhës së vlerësimit nga relatori i çështjes apo vëzhguesi ndërkombëtar që ka monitoruar procedurën e rivlerësimit të subjektit Neritan Cena, përtej periudhës së përcaktuar në pikën 3 të nenit 41 të të njëjtit ligj.
126. Gjithashtu, referuar mënyrës së kryerjes së hetimit nga Komisioni, si më sipër evidentuar, referuar në mënyrë të veçantë kërkesës drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, konstatohet se periudha e vlerësimit është shtrirë nga viti 2006, deri në momentin e vlerësimit nga Komisioni, korrik 2020, edhe përtej kufirit të sipërm të periudhës së vlerësimit, e cila është 3 vitet e fundit të ushtrimit të detyrës nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 84/2016, e cila shtrihet deri në fund të vitit 2016, dhe ky hetim është kryer në kërkim të informacionit për raste të arsyetimeve me vonesë të vendimeve nga ana e subjektit të rivlerësimit, mënyrë kjo e cila bie ndesh me interpretimin e Gjykatës Kushtetuese për zbatimin e rastit përjashtimor të shtrirjes së periudhës së vlerësimit të aftësive profesionale dhe garantimin e parimit të barazisë së subjekteve përpara ligjit.
127. Sa i takon çështjes së burimeve të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, referuar pikës 1 të nenit 42 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vëren se të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët vlerësohen bazuar në burimet e parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e tyre. Në kuptim të sa më sipër, burimet e vlerësimit janë sipas përcaktimit të tyre në nenin 77 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe shprehimisht:
- a) *dosja personale e magjistratit;*
 - b) *të dhënat statistikore, sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 90 të këtij ligji;*
 - c) *dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim, sipas nenit 91 të këtij ligji, duke përfshirë edhe regjistrimet e seancave me mjete audio ose video, në lidhje me dosjet gjyqësore, të cilat duhet të mbulojnë plotësisht të gjitha llojet e çështjeve të gjykuara dhe të hetuara;*
 - ç) *vlerësimi i kryer nga magjistrati dhe vendimet gjyqësore ose aktet e hartuara prej prokurorit dhe të përzgjedhura prej tij. Në çdo rast, numri i vendimeve/akteve të hartuara dhe të përzgjedhura prej prokurorit, nuk duhet të jetë më shumë se 2 në vit;*
 - d) *mendimi i kryetarit;*
 - dh) *të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj magjistratit gjatë periudhës së vlerësimit;*
 - e) *informacioni me shkrim që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera, i cili vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e magjistratit në veprimtaritë trajnuese;*
 - ë) *vendimet përfundimtare për masat disiplinore ndaj magjistratit që janë dhënë gjatë periudhës së vlerësimit, në mënyrë të pavarur, nëse masa disiplinore është shuar ose jo;*
 - f) *raportet e kërkuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ose institucione të tjera audituese ose kontrolluese;*
 - g) *kundërshtimet e magjistratit dhe çdo procesverbal ose dokument i seancës dëgjimore gjatë procesit të vlerësimit;*
 - gj) *çdo e dhënë tjetër, që tregon ngritjen profesionale të magjistratit.*

128. Në analizë të kuadrit të sipërcituar ligjor, trupi gjykues konstatoi se Komisioni, ndryshe nga sa parashikuar në nenin 77 të ligjit nr. 96/2016, nuk ka marrë në vlerësim të dhënat e nxjerra për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj magjistratit gjatë periudhës së vlerësimit (tetor 2013-tetor 2016), por si më sipër konstatuar, ka evidentuar në vendim çdo ankesë të regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit që nga viti 2006 deri në vitin 2020. Gjithashtu, ndërkohë që ligji përcakton si burim për efekt të vlerësimit të aftësive profesionale, vendimet përfundimtare për masat disiplinore ndaj magjistratit që janë dhënë gjatë periudhës së vlerësimit, Komisioni duket që në vlerësimin e tij, ka përvetësuar raportin e ministrit të Drejtësisë për nisjen e procedimit disiplinor, duke risjellë gjetjet e këtij raporti në rezultatet e hetimit të Komisionit, duke anashkaluar faktin që për këtë raport, në vijim edhe të observacioneve të subjektit të rivlerësimit, nuk është nisur asnjë procedim disiplinor dhe kërkesa e ministrit të Drejtësisë është rrëzuar nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.
129. Në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues arriti në përfundimin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për tejkalim të kompetencave nga ana e Komisionit në drejtim të hetimit të kryer lidhur me këtë kriter, gjendet i drejtë dhe i bazuar në fakte dhe në ligj.
130. Sa i takon vlerësimit përfundimtar lidhur me kriterin e aftësive organizative sipas përcaktimit të tij në nenin 74 të ligjit nr. 96/2016, në drejtim të aftësisë për të përballuar ngarkesën në punë, trupi gjykues çmoi se gjetjet nga vëzhgimi i tri dokumenteve të përzgjedhura nga subjekti dhe 5 dosjeve të përzgjedhura në mënyrë rastësore sipas procedurës së shortit (si më sipër konstatuar në mënyrë të detajuar), si dhe të dhënat nga burimet arkivore të ish-KLD-së për periudhën e vlerësimit, sipas të cilave për 1 ankesë të vitit 2013 dhe një ankesë të vitit 2015 për zvarritje të gjykimit nga ana e gjyqtarit, është vlerësuar evidentimi për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit, në vijim të analizës së mësipërme të fakteve dhe interpretimit të ligjit të zbatueshëm, çmohen të pamjaftueshme për të konfirmuar vendimmarrjen e Komisionit lidhur me këtë kriter, sipas së cilës subjektit të rivlerësimit i është dhënë masa disiplinore e shkarkimit nga detyra. Trupi gjykues në arritjen e këtij përfundimi, mbajti në konsideratë edhe vendimmarrjen e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në çështjen Tabaku kundër Këshillit të Lartë të Drejtësisë me nr. 5 vendimi, datë 12.12.2013, në të cilën, ndër të tjera, është arsyetuar: *Procesi gjyqësor në vetvete mund të ndahet në dy segmente kohore: (1) atë/ato segmente kohore që kanë të bëjnë me veprimet procedurale që duhet të ndërmarrin palët në proces; dhe (2) atë/ato segmente kohore që kanë të bëjnë me veprimtarinë e gjyqtarit, duke zbritur nga e gjithë kohëzgjatja reale e procesit gjyqësor afatin kohor “që i atribuohet gjyqtarit” dhe aparatit gjyqësor për mbylljen përfundimtare të procesit. Jo e gjithë periudha kohore që i atribuohet gjyqtarit brenda një procesi gjyqësor (si pjesë e punës së tij), në kuptimin e përmendur më sipër, mund të konsiderohet automatikisht si tej afatit të arsyeshëm. Në fakt, çdo proces gjyqësor, edhe ai proces që kryhet dhe përfundon “shpejt” ka kohëzgjatjen e tij normale që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë si me kryerjen e disa fazave procedurale, ashtu dhe me gjykimet e çështjeve në disa nivele gjykatash (sipas rastit). Në mënyrë që afatet kohore të konsiderohen të paarsyeshme, nuk mjafton vetëm të merret për bazë e gjithë kohëzgjatja reale e procesit, por duhen verifikuar rast pas rasti veprimet konkrete që janë*

ndërmarrë në kuadër të këtij procesi dhe nëse këto veprime justifikojnë apo jo vonesën dhe neglizhencën e gjyqtarit³⁴.

85. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vazhdim të analizës së mësipërme, vlerësojnë të theksojnë dhe një herë se jo në çdo rast, mosrespektimi i afateve procedurale të përmendura më lart, e çon gjyqtarin përpara procedimit disiplinor. Jo në çdo rast shkeljet që konstatohen në veprimtarinë e gjyqtarit dhe në mënyrë të veçantë në veprimtarinë e tij për të dorëzuar brenda një afati të arsyeshëm vendimet e arsyetuara, do të konsiderohen si shkelje që kanë çuar në humbjen e besimit dhe kredibilitetit ndaj gjyqtarit apo akte që kanë diskretitur rëndë figurën dhe sjelljen e tij. Që këto shkelje të konsiderohen si të tilla, duhet të ketë një mungesë kujdesi dhe operativiteti, neglizhencë, të tilla që kalojnë “kufirin e së arsyeshmes”, dhe që një sjellje e tillë nuk mund të justifikohet, duke çuar në cenimin e prestigjit të gjyqtarit dhe humbjen e besimit ndaj tij.

86. Vonesa në arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve përbën shkelje disiplinore, kur përbën rast përsëritës, të rëndë, dhe të pajustificuar. “Në çdo rast, kufiri i të justifikueshmes do të konsiderohet i tejkaluar, për sa kohë vonesa cenon të drejtën e palëve për të pasur një proces që zhvillohet brenda afateve të arsyeshme, sipas nenit 6, parag.1 të KDENJ”. Për sa i takon pretendimit për numrin e çështjeve dhe përmasave të vonesës në këto çështje, kufiri i të justifikueshmes do të konsiderohet i tejkaluar, në momentin që sjellja e gjyqtarit (pra, faji i tij) ka të bëjë me paaftësinë e tij organizatore për të kryer në mënyrën e kërkuar, detyrën e gjyqtarit.

131. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues, ndryshe nga Komisioni, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Neritan Cena ka arritur nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.
132. Trupi gjykues, bazuar në konkluzionet e arritura nga vlerësimi i kriterit të pasurisë, si dhe konkluzioni i mësipërm lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, çmon se konkluzioni i Komisionit, se – *problematikat e konstatuara në vlerësimin e pasurisë në lidhje me transaksione financiare shumë të diskutueshme dhe paaftësia profesionale për të kryer detyrat e tij brenda një standardi të pritshëm, krijojnë dyshimin e arsyeshëm te çdo qytetar se gjyqtari me sjelljet e tij, ka vendosur interesin personal mbi atë të shoqërisë/publikut dhe sundimit të paanshëm të ligjit, duke cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, dhe duke bërë që subjekti të ndodhet në kushtet e pamundësisë për të plotësuar këto mangësi nëpërmjet programit të trajnimit, i gjendur në kushte e parashikimeve të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr.84/2016 – gjendet i padrejtë dhe i pabazuar. Për pasojë, trupi gjykues, ndryshe nga Komisioni, nuk vlerëson se sjellja e subjektit të rivlerësimit në rastin objekt gjykimi, ka diskretitur rëndë figurën e gjyqtarit duke justifikuar kualifikimin ligjor sipas parashikimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.*
133. Në këto kushte, trupi gjykues, pavarësisht se gjeti të bazuara një pjesë të shkaqeve të ngritura në ankim nga subjekti i rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, si dhe shkaqet lidhur me kundërshtimin e konkluzionit të Komisionit për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, përsëri ato u vlerësuan të pamjaftueshme për të cenuar vendimin e Komisionit. Si rrjedhojë e konkluzioneve të mësipërme, bazuar në nenin D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet

³⁴ Vendimi nr.1921, datë 03.02.2004, i Gjykatës së Kasacionit të Republikës së Italisë.

33, pika 5, germa “b” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerësoi se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, është i bazuar në fakte dhe në ligj dhe, për rrjedhojë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 304, datë 06.10.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit Neritan Cena.

2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 13.04.2023, në Tiranë.

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi